



RAPORTI I REGJISTRIMIT TESTUES

Shkurt 2007



Përmbajtja

Hyrje	4
1. Procesi i Regjistrimit testues	6
1.1 Historiku	6
1.2 Fushata e informimit	10
1.3 Trajnimi i stafit për punë në terren	11
1.4 Operacionet në terren	12
1.5 Futja e të të dhënave	14
2. Rezultatet kryesore dhe rekomandimet	18



Lista e shkurtesave

KQR	Komisioni Qendror i Regjistrimit
KKR	Komisioni Komunal i Regjistrimit
CIRPS	Qendra Hulumtuese Ndëruniversitare për Zhvillim të Qëndrueshëm – Universiteti i Romës “La Sapienza”
KE	Këshilli i Evropës
QR	Qarku Regjistruar
AER	Agjencioni Evropian për Rindërtim
KE	Komisioni Evropian
Eurostat	Zyra e Statistikës së Komuniteteve Evropiane
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave –Shqipëri
ISTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave - Itali
TI	Teknologjia Informative
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
NSO	Zyra Kombëtare e Statistikave
RPEF	Regjistrimi i Popullsisë dhe i Ekonomive Familjare
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
UP	Udhëheqësi i Projektit
KD	Këshilli Drejtues
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
KD	Këshilli Drejtues
UE	Udhëheqësi i Ekipit
KP	Kushtet e Përgjithshme
UN-ECE	Komisioni për Ekonomi të Evropës i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSD	Divizioni i Kombeve të Bashkuara për Statistikë



Hyrje

Ky raport është raport i përbashkët nga ESK dhe Koncorsiumi i asistencës teknike i cili paraqet rezultatet e një analize gjithëpërfshirëse mbi aspektet kryesore teknike të Regjistrimit testues nga viti 2006 për përgatitjen e Regjistrimit të Popullsisë dhe të Ekonomive Familjare në Kosovë.

Kjo analizë ka për qëllim vlerësimin e gjithë kësaj veprimtarie, d.m.th. pyetësorët, doracakët, formularët tjerë të regjistrimit dhe përkthimet e tyre, hartat dhe mjetet SIG, trajnimin e stafit për punë në terren, aktivitetet në terren, pranimin e të dhënave dhe komponentët e përpunimit, tabelimi i të dhënave, fushata e informimit.

Vlerësimi u organizua dhe u zbatua në përputhje me qëllimin kryesor të Regjistrimit testues: u testuan të gjitha procedurat e regjistrimit, me qëllim të parandalimit të problemeve gjatë regjistrimit të përgjithshëm, ose për të kuptuar se ku duhet të bëhen korrigjimet, në mënyrë që të sigurohet një kualitet i lartë i rezultateve të Regjistrimit.

Në Kreun e parë të këtij raporti përshkruhen dhe analizohen fazat kryesore të procesit të Regjistrimit testues.

Kreu i dytë përmban arritjet kryesore të kësaj detyre testuese sipas ekspertëve të projektit, si dhe një përvijim të rekomandimeve kryesore të parapara për aktivitetet e ardhshme. Natyrisht, ekzistojnë edhe shumë faktorë edhe të natyrës jo teknike, që mund të kenë ndikim në vendimet e ardhshme lidhur me zbatimin e regjistrimit të plotë mirëpo, këtu analiza është kufizuar në veprimtaritë që ishin përgatitur, zbatuar ose bashkërenduar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ekspertët e projektit në përkrahje të ESK-së.

Shtojca 1 përmban një përshkrim të thellë të ndarjes së territorit për regjistrim, hartografinë dhe veprimtaritë e SIG-ut që ishin disejnuar dhe përfunduar për përgatitjen e Regjistrimit të përgjithshëm dhe atij testues, ndërsa Shtojca 2 përmban një analizë të plotë dhe të hollësishme demografike të të dhënave të mbledhura.

Këtu duhet theksuar se, të gjitha analizat e paraqitura janë zhvilluar në bazë të veprimtarive të cilat ishin të gatshme për regjistrimin testues; ndonëse, nga njëra anë, ishin bërë të gjitha përpjekjet, si nga ESK-ja ashtu edhe nga ekspertët e projektit për përgatitjen e regjistrimit testues, disa kufizime kohore dhe pengesa tjera praktike e mjedisore kanë penguar përfundimin e disa veprimtarive për paraqitjen e hollësive maksimale dhe kjo mund të ketë shkaktuar disa mungesa, të cilat do të përmenden më pas në këtë raport.

Veç kësaj, do theksuar se, në asnjë mënyrë analiza e të dhënave nuk mund të përdoret si pasqyrë e realitetit të përgjithshëm në Kosovë, kurse analiza ishte kryer në bazë të përgjigjeve të vlefshme të dhëna në pyetësorë, të cilat janë mbledhur gjatë Regjistrimit testues. Për arsye të mënyrës së disejnimit të mostrës dhe për shkak të mospjesëmarrjes së disa segmenteve të popullsisë në Regjistrimin testues, nuk ka mundësi që të dhënat të merren si një pasqyrim i popullatës së Kosovës dhe kjo duhet të merret parasysh gjatë studimit të të dhënave. Sidoqoftë, duke ditur se dhe siç u përmend edhe më herët, një Regjistrim testues organizohet me qëllim të kontrollimit të gjithë aparatit për regjistrim, analizën e të dhënave nga pyetësorët



dhe në veçanti të gabimeve dhe mospërputhjeve, që janë me rëndësi për identifikimin e problemeve gjatë disejnit të pyetësorëve por, gjithashtu edhe për veprimtaritë tjera të ngjashme, d.m.th. trajnimet, rekrutimin e stafit për punë në terren, etj.

Përfundimisht, çështjes së mospjesëmarrjes së një pjese të popullatës mostër, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë – pavarësisht nga vetë rezultatet e Regjistrimit testues dhe të testimit të aparatit të regjistrimit – gjatë vlerësimit të kushteve të përgjithshme që shpijnë deri te mundësia për të bërë planifikimin dhe organizimin e Regjistrimit të përgjithshëm, në pajtim me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare.



1. Procesi i Regjistrimit testues

1.1 Historiku

Ky raport është raport i përbashkët nga ESK dhe Konkorsiumi i asistencës teknike i cili është pasqyrë e veprimtarive të përvijuara në këtë kaptinë është të konkluduarit për një proces të përcjellur nga puna e zellshme, efektive dhe bashkëpunuese, e filluar në fillim të vitit 2006 dhe e drejtuar kah realizimi i një testi kualitativ të regjistrimit. Veprimtaritë përgatitore ishin planifikuar dhe zbatuar në mënyrë të përbashkët nga Enti Statistikor i Kosovës dhe Projekti për asistencë teknike me përkrahje nga Misioni Monitorues Ndërkombëtar i Regjistrimit, i cili qe themeluar në baza *ad hoc*. Asistenca substanciale ishte ofruar edhe nga MSHP dhe AER-i.

Në fillim të procesit, në disa fusha të natyrës teknike dhe operacionale kishte nevojë për përmirësime të rëndësishme që kërkonin edhe kohë dhe këto u vërejtën dhe u analizuan me qëllim të identifikimit të madhësisë, karakteristikave dhe shkaktarëve. Qëllimi ishte që veprimtaritë të disejnohen dhe zbatohen në mënyrë efektive dhe kualitative për përgatitjen e Regjistrimit testues. Të gjitha aktivitetet e disejuara ishin të lidhura me disa kushtëzime, supozime dhe rreziqe të cilat monitoroheshin dhe vlerësoheshin vazhdimisht.

Më të rëndësishmet ishin: i) mundësia e mungesës së një sasive të konsiderueshme të buxhetit; ii) pjesëmarrja e pakicave; iii) mungesa e aftësive dhe shkathtësive të përshtatshme menagjuese në zyrën e regjistrimit në ESK, për shkak të mungesës së përvojës paraprake për organizimin e regjistrimit; iv) Shkalla e tensioneve ndërmjet shqiptarëve dhe pakicave që do të mund të pengonte veprimet në terren.

Në bazë të punës së përditshme në mes të stafit të ESK-së dhe ekspertëve të projektit dhe gjithashtu duke marrë parasysh draftet ekzistuese të materialit regjistruar, dokumentet e përgatitura nga Eurostat-i dhe UNFPA-s dhe konsultimet e zhvilluara me palët tjera me interes, sferat e shqetësimeve u përcaktuan dhe u grupuan në pesë grupe kryesore me aktivitete përkatëse. Këto ishin:

- Aftësitë menagjuese të ESK-së për planifikim dhe organizim të Regjistrimit
- Aspektet metodologjike lidhur me përgatitjen e materialeve për Regjistrim në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it dhe standardet ndërkombëtare
- Përpunimi i të dhënave
- Informimi dhe fushata e vetëdijesimit

Për dallim nga këto, puna përgatitore e hartografisë kishte përparuar mjaft mirë. Disa nga mungesat ishin identifikuar në sistemin e kodifikimit të entiteteve gjeografike, caktimin e kufijve të QR në vendet e përzgjedhura dhe në përgatitjen e planeve për hartat e regjistrimit.

Me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të përgjithshme menagjuese të planifikimit dhe ndërmarrjes me kohë të aktiviteteve të caktuara, zyra e Regjistrimit në ESK dhe Konkorsiumi u pajtuan në muajin mars 2006, që të bëjnë përcaktimin e një strukture



organizative me nga një Grup teknik ad hoc, për fushën e demografisë , logjistikës, TI, hartografisë/SIG-ut dhe fushatën e informimit.

Të gjitha grupet punuese të formuara kishin nga një bashkërendues dhe ato menagjoheshin me qëllim të përcaktimit dhe zbatimit të suksesshëm të aktiviteteve me kohë dhe në mënyrë kualitative. Mungesa e përvojës së stafit të ESK-së u vërejt vetëm në rrafshin e logjistikës dhe fushatën për informim që shkaktoi një kufizim të arritjeve të parapara. Një situatë specifike kishim në Grupin punues për TI, meqenëse stafi i ESK-së për përpunimin e të të dhënave ishte caktuar në muajin korrik 2006.

Puna e përbashkët ndërmjet stafit të ESK-së dhe ekspertëve të projektit solli disa të arritura në fusha të ndryshme, duke përfshirë pranimin e vazhdueshëm brenda ESK-së "të kulturës së regjistrimit", fitimin e njohurive specifike dhe fuqizimin e fazave të ndryshme lidhur me përgatitjen e Regjistrimit të popullsisë. U përgatitën disa versione të pyetësorëve, doracakëve, formularëve përkatës, materialeve për logjistikë, u zhvilluan aplikacione për futjen e të të dhënave si dhe u shtypën edhe materialet për informim; i gjithë ky material i është paraqitur dhe është diskutuar me ekspertët e Misionit Monitorues Ndërkombëtar. U organizuan edhe takime të ndryshme me Ministren e MSHP, UNMIK-un, përfaqësuesit e UNFPA-s dhe palët tjera me interes, me qëllim të shkëmbimit të mendimeve lidhur me punën përgatitore për regjistrim.

Pas planit të përgjithshëm të aktiviteteve për Regjistrimin testues, të përgatitur bashkërisht nga Konsorciumi dhe ESK-ja, në bazë të vendimeve nga takimi i dytë i Këshillit drejtues për këtë projekt me datën 7 korrik, ndërsa KQR-ja më 24 korrik miratoi datën e fillimit të Regjistrimit testues, e cila edhe u konfirmua në takimin e tretë të Këshillit drejtues të Misionit Monitorues Ndërkombëtar, të mbajtur më 28 dhe 29 gusht 2006.

Më datën 12 tetor, Këshilli drejtues i projektit shqyrtoi aktivitetet përgatitore për zbatimin e Regjistrimit testues dhe u pajtua që raporti teknik për vlerësimin e Regjistrimit testues të përgatitet nga ESK-ja së bashku me Konsorciumin dhe i njëjti të paraqitet në fund të muajit janar.

Më 18 tetor KQR miratoi formularët e propozuar për Regjistrimin testues, si dhe Urdhëresën administrative për definicionin e banorëve të zakonshëm, të cilët do të përfshihen në Regjistrimin testues. Ky tekst ishte rezultat i punës së përbashkët ndërmjet ESK-së, MPSH-së, KD të Misionit ndërkombëtar, AER-it, Konsorciumit dhe zyrës së UNMIK-ut për Çështje ligjore.

U krijua një mostër e përbërë prej dy fazave duke zgjedhur tri komunat e përmendura (10% të numrit të përgjithshëm të komunave) dhe tetë qarqe regjistruese (QR) për secilën, katër për mjediset urbane dhe katër të tjera për mjediset rurale. Kjo që arritur duke pasur parasysh numrin e paraparë të ekonomive familjare për secilin qark regjistruar, prej 40 deri 60 në mjediset rurale dhe prej 80 deri në 120 për mjediset urbane. Objektivi ishte që të sigurohej një mostër me afërsisht 2000 ekonomi familjare. Komunat dhe qarqet e regjistrimit ishin zgjedhur kryesisht në bazë të përbërjes së brendshme etnike, me qëllim të sigurimit të prezencës së qëndrueshme të pakicave në ekonomitë familjare që do të regjistroheshin. Në komunën e Kamenicës është paraparë që 7 QR të përzgjedhura do të jenë të banuara kryesisht me shqiptarë dhe 1 QR do të jetë i banuar nga shqiptarë, serbë dhe romë. Në komunën e Pejës, 8 QR të përzgjedhura janë paraparë si të banuara nga shqiptarët,



ndërsa në komunën e Shtërpçës, 2 QR janë paraparë që të kenë banorë shqiptarë, ndërsa 6 QR tjera të jenë me ekonomi familjare të banorëve serbë.

Nata ndërmjet 29 dhe 30 tetorit, mesnata është përdorur si moment referues për të dhënat e mbledhura gjatë operacionit të Regjistrimit testues.

Ishte paraparë që të regjistrohen 1,971 ekonomi familjare, 685 në Kamenicë, 684 në Pejë dhe 602 në Shtërpçë. Për numrin e personave nuk ka pasur ndonjë vlerësim, ndërsa për sa i përket banesave ishte një vlerësim prej afërsisht 2,898 njësi banesore. Mirëpo, në bazë të punës përgatitore hartografike ishte paraparë që në terren të vizitohen 1,851 objekte që përdoren për banim dhe që nuk përdoren për banim.

Gjatë Regjistrimit testues stafi në terren kishte përdorur këto materiale:

- Formularët e regjistrimit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Regjistrimi i ndërtesave, banesave, ekonomive familjare dhe i personave ishte bërë me anë të katër formularëve të regjistrimit.

Formulari i parë që plotësohej nga regjistruerit ishte Formulari R1, formulari i banesave, që përdorej për mbledhjen e informatave për banesat dhe ndërtesat e zakonshme.

Formulari R2 përdorej si pyetësor për ekonominë familjare dhe banim për secilin ekonomi familjare me vendbanim të zakonshëm në banesë, sipas definicionit ndërkombëtar që parasheh banimin gjatë 12 muajve të fundit. Ky formular ishte sajuar për mbledhjen e informatave për përbërjen e ekonomisë familjare (d.m.th. marrëdhëniet ndërmjet personave me vendbanim të zakonshëm në një banesë), personat që janë përkohësisht të pranishëm në banesë por, që janë me vendbanim të zakonshëm diku tjetër, llojin e pronës banesore, qasjen në rrjetin e internetit dhe rrjetin e telefonisë fikse dhe pronës bujqësore të ekonomisë familjare.

Informatat mbi përbërjen e ekonomisë familjare janë regjistruar në Listën 1, në faqen e parë të Formularit R2, ku janë paraqitur shënimet për secilin anëtar të ekonomisë familjare duke përfshirë të dhënat mbi gjininë, emrin e babës, marrëdhënien me personin referues, numrin rendor të familjeve bërthamë dhe statusin familjar.

Për secilin prej këtyre personave është plotësuar Formulari individual (R3), pas plotësimit të Formularit R2.

Lista nr 2, në faqen e dytë të Formularit R2 ishte sajuar për të regjistruar informatat për personat që ishin përkohësisht prezent gjatë Regjistrimit por, që nuk jetojnë ose që nuk pritet të jetojnë aty për më shumë se 12 muaj. Për secilin prej këtyre personave janë marrë informatat si: emri e mbiemri/at, gjinia, datëlindja, vendbanimi i zakonshëm dhe arsyeja e prezencës së tyre të përkohshme në banesë gjatë Regjistrimit.

Në faqen e tretë të Formularit R2 ishin përfshirë edhe disa pyetje lidhur me ekonominë familjare si njësi për t'u regjistruar.

Një formular i posaçëm, i quajtur Formulari S1, përbëhej prej tabelës shtesë për shënimin e anëtarëve të ekonomisë familjare me vendbanim në botën e



jashtme. Ky formular u shtua për shënimin e ish anëtarëve të ekonomisë familjare, të cilët kanë banuar në banesë, por që më pas kanë emigruar në botën e jashtme. Sipas kërkesës së shumë palëve me interes, ky formular i është bashkëngjitur formularëve ekzistues të regjistrimit për të llogaritur numrin e personave që kanë emigruar nga Kosova. Për më tepër, kjo ishte edhe një mënyrë për përmirësimin e regjistrimit dhe thjeshtimin e detyrave për regjistruesit. Në të vërtetë, tabela shtesë ka mundësuar që regjistruesit të regjistrojnë çdo anëtarë të ekonomisë familjare (në kuptim të gjerë) duke regjistruar në të vërtetë vetëm personat me vendbanim të zakonshëm, të cilët përmbushnin kriteret ndërkombëtare (d.m.th. personat që jetojnë në një vendbanim të zakonshëm për jo më pak se 12 muaj ose për më pak se 12 muaj por, që kanë ndërmend të qëndrojnë aty së paku për 12 muaj). Nga ana tjetër, është e qartë se informatat për emigrantët që jetojnë në botën e jashtme, të cilat janë marrë nga banorët aktual me vendbanim të zakonshëm nuk janë as përfundimtare e as të sakta, prandaj edhe nuk mund të konsiderohen si të sigurt.

Pas plotësimit të Formularit R1 (Formulari i banesës), R2 (Formulari i ekonomisë familjare) dhe – aty ku është e aplikueshme – Formularin S1, regjistruesit ishin udhëzuar që të plotësojnë Formularin R3 (pyetësori individual) për secilën nga komponentët e ekonomisë familjare me banorë që janë me vendbanim të zakonshëm në një banesë. Formulari R3 përmban 43 pyetje dhe disa variante të plotësimit, varësisht nga mosha dhe gjinia e respondentit.

- Formularët shtesë në gj. shqipe, serbe dhe angleze. Ishte përgatitur edhe një numër i formularëve për raportim dhe monitorim, si: i) formularët e regjistrimit dhe formularët përmbledhës për regjistruesit (RS1), Formulari (RS2) për kontrolluesit, Formulari (RS3) për mbikëqyrësit, Formulari (RS4) për bashkërenduesit komunalë të regjistrimit ii) Formularët e përmbledhjes ditore (DS1), Formulari për kontrolluesit (DS2), për mbikëqyrësit (DS3), për bashkërenduesin komunal të regjistrimit (DS4); iii) Formulari për listat (BL) që përdorej nga regjistruesit para regjistrimit për të bërë identifikimin dhe klasifikimin e ndërtesave, në mënyrë që të sigurohej një shkallë e lartë e mbulimit gjatë aktiviteteve në terren.
- Udhëzuesit në gj. shqipe, serbe dhe angleze. Janë përgatitur versionet e udhëzuesve për regjistruesit, kontrolluesit dhe mbikëqyrësit.
- Hartat e regjistrimit. Regjistruesit, kontrolluesit, mbikëqyrësit dhe bashkërenduesit komunalë kanë qenë të pajisur me harta për QR përkatës, të cilat janë nxjerrë nga baza SIG e të dhënave për regjistrim.
- Letra njoftuese e regjistrimit dedikuar ekonomive familjare. Kjo letër ishte nënshkruar nga zyra e Regjistrimit e ESK-së dhe qëllimi i sajë ishte komunikimi i drejtpërdrejtë i ESK-së me respondentët.



1.2 Fushata e informimit

Duke pasur parasysh se suksesi i Regjistrimit mbështetet plotësisht në vullnetin dhe informimin e respondentëve, koncepti udhëheqës për organizimin e fushatës për informim bazohej në vetëdijesimin e individëve mbi qëllimin dhe rëndësinë e Regjistrimit testues dhe sqarimin e arsyeve të pjesëmarrjes.

Ideja kryesore kreative e fushatës për informim nga ESK-ja ishte përcjellja e mesazhit për pjesëmarrje në Regjistrim përmes sloganit “Si e din Kosova, se për çfarë ka nevojë Kosova” - REKOS 2007”, që u përdor si slogan dhe logo.

Fletëpalosjet, fletushkat dhe letrat njoftuese nëpër ekonomitë familjare janë përgatitur duke përdorur sloganin dhe logon me qëllim të komunikimit me publik – në masën sa më të madhe të mundshme, duke pasur parasysh kushtet e Regjistrimit testues – në mënyrë efektive dhe mënyrë të integruar dhe duke paraqitur konceptet themelore dhe mesazhet kryesore mbi Regjistrimin. Këto materiale janë dorëzuar nga regjistruerit nëpër të gjitha ekonomitë familjare dhe banesa, ndërsa përmes KKR-së edhe në institucionet publike të nivelit lokal.

Testimi i tyre gjatë Regjistrimit testues kishte për qëllim vërtetimin e efektshmërisë në kuptim të ndikimit potencial, ndjeshmërisë, e të kuptuarit dhe fuqisë për motivimin e respondentëve për të dhënë përgjigjet. Mirëpo, duhet përmendur se, aspekti kohor dhe synimi i komunikimit duhet të rritet shumë më tepër sesa nga ajo që është testuar gjatë Regjistrimit testues; gjithashtu, për shkak të kufizimeve kohore dhe arsyeve të tjera, të përmendura më lart, vetëm fletëpalosjet dhe fletushkat u përdorën si mjet komunikimi dhe nuk ka pasur përdorim të posterëve, spoteve në TV ose radio ose të panove.

Mesazhi kryesor që është përcjellur tek të gjitha segmentet e popullatës përmes sloganit dhe logos “Si e din Kosova, se për çfarë ka nevojë Kosova” - REKOS 2007” kishte për qëllim theksimin e lidhjes ndërmjet regjistrimit të suksesshëm dhe fitimit të njohurive mbi gjithë popullatën: d.m.th. shërbime më të mira sociale, shkolla, rrugë, mundësi për rritje të punësimit, përmirësim të kushteve ekonomike, etj.

Në këtë kuptim, logoja me një gjuhë grafike doli e thjeshtë dhe e kuptueshme. Ajo tek respondentët ngjalli një perceptim mbi regjistrimin dhe komunikoi vlerat e bashkëpunimit të tyre dhe gjithëpërfshirjen për një qëllim të përbashkët. Kjo ishte edhe një përkrahje për punën e regjistruerëve gjatë sqarimit të qëllimit të vizitave nëpër ekonomitë familjare.

Përdorimi i kapelave të dallueshme që mbanin sloganin dhe logon ishin ndihmesë dhe mundësuan identifikimin e shpejtë të stafit të regjistrimit testues nga ana e respondentëve.

Një plan i detajuar që punuar nga ESK-ja dhe ekspertët e projektit, i cili u realizua dhe kishte për qëllim dërgimin e mesazheve gjatë fushatës për informim nëpër mediat publike dhe për të siguruar publicitet për Regjistrimin testues. Drejtori i zyrës së ESK-së për Regjistrim të popullsisë ishte përgjegjës për media, të cilat ishin shumë të interesuara për këtë test dhe kishin shkruar një sërë artikujsh nëpër gazeta.

Janë dhënë 20 intervista nga drejtori i zyrës së Regjistrimit dhe ato ishin transmetuar nga televizionet kombëtare dhe radio-stacionet, ose ishin botuar edhe në gazetat



lokale. Gazeta e Prishtinës kishte publikuar 15 artikuj që ishin shkruar nga ekspertët kosovar të demografisë dhe nga gazetarët e ndryshëm; shumica e këtyre artikujve kishin qasje pozitive për Regjistrimin testues dhe inkurajonin pjesëmarrjen, përjashtim përbenin dy shkrime ku shprehej skepticizëm rreth pjesëmarrjes dhe ishin me plot kritika për ekspertizën e ESK-së për organizimin e Regjistrimit testues në mënyrë të suksesshme. Përveç këtyre ngjarjeve, Ministrja e MSHP-së gjatë paraqitjes së sajë disa herë në TV ka folur në mënyrë pozitive për Regjistrimin testues, duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së gjithë popullatës.

Për fund, kryesuesi i Grupit menagjues dhe kryesuesi i Këshillit drejtues i Misionit Monitorues Ndërkombëtar mbajtën një konferencë për shtyp në Prishtinë, ku u kumtua fillimi i Regjistrimit testues, duke sqaruar se një regjistrim i tillë, i udhëhequr në pajtim me rekomandimet dhe standardet e pranura ndërkombëtare dhe se operacionet testuese do të përcilleshin nga afër prej vëzhguesve ndërkombëtarë, që kishin për detyrë të mbikëqyrnin pajtueshmërinë e operacioneve me standardet ndërkombëtare, në veçanti pjesëmarrjen e popullatës duke përfshirë këtu edhe pakicat.

1.3 Trajnimi i stafit për punë në terren

Aktivitetet e trajnimit u organizuan në selinë e ESK-së në Prishtinë. Ato u zhvilluan në dy faza, njëra përfshinte mbikëqyrësit dhe kontrollorët, ndërsa tjetra regjistruerit në të cilën po ashtu kishin marrë pjesë mbikëqyrësit dhe kontrollorët. Në të dyja fazat gjuhët e përdorura ishin shqipja, serbishtja dhe anglishtja. Trajnimi dy ditor për mbikëqyrësit filloi një javë para fillimit të Regjistrimit, ndërsa faza e dytë ka zgjatuar tre ditë dhe përfundoi një ditë para fillimit të aktivitetëve në terren, më 27 tetor. Aktivitetet trajnuese u ndërpre në ditën e diel, më 22 dhe 23 tetor, kur edhe ishte Festa e Bajramit (Eid al-Fitr).

Caktimi i kohës për mbajtjen e trajnimeve ishte planifikuar sipas një rregulle të përgjithshme, që të jetë sa më afër datës së fillimit të operacioneve në terren.

Ndonëse struktura e planifikimit për organizimin e trajnimit bëhej sipas skemës së kaskadave (stafi i ESK-së me përvojë në regjistrim merrej me trajnimin e mbikëqyrësve, kurse mbikëqyrësit trajnonin kontrolluesit dhe regjistruerit). Gjatë fazës së parë të trajnimit është konstatuar se mbikëqyrësit nuk kanë ofruar trajnim kualitativ për regjistruerit. Ishte fituar përshtypja se për mbikëqyrësit sesionet e trajnimit do të duhej të ishin më të gjata dhe të përmbajnë shkathtësi specifike mbi metodat e trajnimit. Kjo situatë çoi deri te vendimi që trajnimi i paraparë për mbikëqyrësit t'u ofrohet edhe regjistruerëve nga ana e stafit të lartë të ESK-së dhe me përkrahjen e ekspertëve të projektit. Sidoqoftë, është e qartë se një strukturë e tillë nuk është e mjaftueshme për një Regjistrim të përgjithshëm, duke marrë parasysh shkallën e operacionit, ndërsa trajnerët duhet të plotësohen me staf tjetër, kurse trajnimi duhet të organizohet ndryshe dhe në një periudhë më të gjatë kohore.



Trajnimit e vijuan 31 regjistruess, 7 kontrolluess dhe 3 mbikëqyrës si dhe përfaqësuesit e KKR-së nga tri komunat e përzgjedhura.

Rezultat i disa kontakteve të bashkëpunimit ndërmjet ESK-së dhe komunës së Shtërpcës ishte sigurimi i pjesëmarrjes në trajnim i stafit për punë në terren nga radhët e komunitetit serb, dhe atë 7 regjistruess dhe 1 kontrolluess. Gjatë sesioneve trajnuess nga komuna e Kamenicës merrnin pjesë 1 regjistruess rom dhe 1 serb.

Trajnimit mbahej në gjuhën shqipe dhe serbe me anë të përkthimit simultan. Një përkthyes tjetër ishte angazhuar për përkthim në gjuhën angleze, në mënyrë që ekspertët të mund të përcillnin dhe të intervenonin sipas nevojës. Secili modul përcillej me slajde në gjuhën shqipe dhe serbe dhe moduli përfundonte me pyetje dhe përgjigje dhe ushtrime praktike.

Trajnimit për mbikëqyrësit ishte organizuar në dy komponente. I pari përqendrohej në rolin e tyre, se si duhet të kryejnë detyrën e vet dhe të përvetësojnë teknikat për kontrollimin e kualitetit. Komponenta e dytë siguronte udhëzime dhe rekomandime për operacionet në terren që duhet të zbatohen nga regjistruessit, duke përfshirë këtu edhe aftësimin për plotësimin e pyetësorëve në mënyrë të drejtë.

Modulët trajnuess për regjistruessit kryesisht përqendroheshin në konceptet e regjistrimit, detyrat para kontaktimit të ekonomive familjare për intervistim, detyrat dhe rekomandimet gjatë dhe pas intervistimit.

Gjatë trajnimit, rëndësi e veçantë i është kushtuar sjelljes sipas rregullave të qarta lidhur me besueshmërinë e të dhënave.

1.4 Operacionet në terren

Prej datës 30 tetor deri më 14 nëntor, Regjistrimit testues ishte organizuar në qarqet e përzgjedhura të komunave të përmendura më lart.

Periudhës së regjistrimit i ka parapri një aktivitet tre ditor i regjistruessve në terren që kishte për qëllim identifikimin në terren dhe klasifikimin e të gjitha ndërtesave ekzistuese në QR përkatës. Ishte hartuar edhe një listë e kodifikuar e ndërtesave, e cila përdorej si mjet mbështetës për përmirësimin e mbulimit në përgjithësi.

Regjistrimit u realizua plotësisht në 17 QR prej gjithsej 24 QR të përzgjedhura dhe pjesërisht në një QR të komunës së Kamenicës, ku ishin regjistruar vetëm ekonomitë familjare shqiptare. Në komunën e Shtërpcës, regjistruessit serbë të trajnuar paraprakisht refuzuan që të marrin pjesë në mbledhjen e të dhënave, duke deklaruar në fillim të punës në terren se, këtë e kishte kërkuar nga ata pushteti lokal serb. Në komunën e Kamenicës, regjistruessi serb dhe ai rom po ashtu refuzuan të fillojnë punën në terren, duke deklaruar se përfaqësuesit e serbëve dhe të romëve lokal nuk kishin lejuar pjesëmarrjen e komuniteteve të tyre në Regjistrimit testues.

Rekrutimit i stafit për punë në terren është bërë nëpër komuna, me përkrahjen e zyrave rajonale të ESK-së.

Në bazë të punës përgatitore që është ndërmarrë në rrafshin e logjistikës, për secilin QR është caktuar një regjistruess dhe ishte arritur pajtimi që 7 QR të kishin një



kontrollues, ndërsa 10 kontrollues të kishin një mbikëqyrës. Në QR me përbërje të përzier etnike ishte caktuar më shumë se një regjistruer, të cilët flisnin gjuhët e folura në ato QR.

Para fillimit të operacionit, materialet e regjistrimit në gj. angleze, shqipe dhe serbe ishin shtypur, paketuar dhe transportuar në ZKR të komunave të përzgjedhura për Regjistrimin testues. Ndërsa, pyetësorët, formularët shtesë, udhëzuesit, hartat dhe materiali tjetër përkatës ishin dorëzuar tek mbikëqyrësit, kontrolluesit dhe regjistruerit. Stafi i ESK-së nga zyrat rajonale dhe përfaqësuesit e KKR u përkujdesën për sigurinë e materialit të vendosur në zyrat komunale të regjistrimit.

Disa probleme u paraqitën gjatë shpërndarjes së materialit për regjistruerit nëpër zyrat komunale të regjistrimit. Në një rast, versionet e pyetësorëve në gjuhën shqipe mungonin për QR ku kishte ekonomi familjare shqiptare dhe e kundërta, versionet e pyetësorit në gjuhën serbe mungonin për QR të banuara me serbë. Kjo me siguri ka ngjarë për shkak të mungesës së përvojës të zyrtarit të ESK-së i cili qe emëruar më 1 tetor.

Mbledhja e të të dhënave filloi më 30 tetor dhe vazhdoi pa probleme të dukshme edhe pse një numër pengesash ishin identifikuar nga ESK-ja dhe kjo e fundit u ballafaqua me to duke pasur edhe përkrahjen e ekspertëve të projektit të Konsorciumit. Ato më kryesoret ishin:

- Në komunën e Pejës QR kishte pasur më shumë ekonomi familjare sesa që ishte pritur. Ky QR më pas u nda në dy QR për mbledhjen e të të dhënave dhe në QR e ri u caktua një regjistruer.
- Vështirësitë e komunikimit ndërmjet regjistruerëve dhe kontrolluesve dhe ndërmjet kontrolluesve dhe mbikëqyrësve ngadalësonin punën në terren, në veçanti në mjediset rurale. Për përballimin e këtij problemi, mbikëqyrësit, kontrolluesit dhe shoferët u pajisën me kartela rimbushëse për telefonat e tyre mobil.
- Kushtet e vështira klimatike e përcollën javën e dytë të operacionit, të cilat po ashtu ndikuan në punën e regjistruerëve, veçanërisht në terrenet malore ku pati reshje dëbore.

Stafi i zyrës së ESK-së për regjistrim ka përcjellur punën në terren në baza ditore dhe ishte i vendosur në ZKR dhe sipas rastësisë merrte pjesë edhe në intervista. Objektivi ishte që të mblidhen reagimet dhe sugjerimet për përgatitjen e Regjistrimit të përgjithshëm. Ky aktivitet ka mundur mbledhjen e informatave të vlefshme, duke ditur për mungesën e përvojës së Institutit për marrjen e të të dhënave gjatë regjistrimit, ndonëse një gjë e tillë nuk është edhe aq e përshtatshme gjatë Regjistrimit të përgjithshëm.

Ekspertët e Konsorciumit siguruan mbështetjen teknike në terren deri më 1 nëntor. Pas kësaj date, ata merreshin me aktivitete operacionale në selinë e ESK-së. Veç kësaj, çdo ditë në orën 19:00 në selinë e ESK-së mbahej takimi operativ-teknik me pjesëmarrje të ekspertëve për asistencë teknike dhe stafit të ESK-së, ku diskutoheshin për tejkalimin e vështirësive operacionale të hasura gjatë ditës.

Operacionet e përgjithshme në terren monitoroheshin prej tri ekipeve me vëzhgues ndërkombëtarë të angazhuar nga KD i Misionit Monitorues Ndërkombëtar.



Më 14 nëntor, përfundoi periudha e regjistrimit, ndërsa më 15 nëntor, në Prishtinë u mbajt një takim i përbashkët informues ndërmjet ESK-së, KD të Misionit Monitorues Ndërkombëtar dhe Konsorciumit.

Sipas orarit të paraparë, që ishte caktuar më herët, nga data 14 e deri më 17 nëntor, regjistruesit kontrolluan materialin dhe plotësuan Formularin RS1. Prej datës 18 e deri më 21 nëntor, kontrolluesit plotësuan Formularët RS2 dhe prej datës 22 e deri më 24 nëntor, mbikëqyrësit plotësuan Formularët RS3. Materialet e regjistrimit janë kthyer në ESK në Prishtinë më datën 24 nëntor.

1.5 Futja e të të dhënave

Para realizimit të Regjistrimit testues, ekspertët e TI nga ESK-ja dhe ekspertët e Konsorciumit kanë punuar afër 5 muaj për zhvillimin e Sistemit për Futjen e të Dhënave me qëllim të futjes dhe kontrollimit të të dhënave nga Regjistrimi testues.

Një sistem i tillë i futjes së të të dhënave është aplikacion klient/server që njëkohësisht mundëson regjistrimin e pyetësorit në bazën e të të dhënave MySQL. Duke përfituar nga teknologjia klient/server, ky sistem rritë sigurinë e të të dhënave dhe siguron kontroll më të madh gjatë përpunimit të pyetësorëve.

Ky sistem është disajnuar të zbulojë sa më shumë kontrollime të përputhjeve elektronike, duke e paralajmëruar operatorin e futjes së të të dhënave për ndonjë gabim të pa zbuluar. Mirëpo, në këtë aplikacion vendimi i përket operatorit nëse mospërputhjen duhet ose nuk duhet përmirësuar. Për më tepër, ky sistem në mënyrë automatike ekzekuton kalime (skips) të kushtëzuara dhe të pa kushtëzuara, duke ia lënë operatorit mundësinë e refuzimit (override) të çdo kalimi, kur një gjë e tillë konsiderohet e nevojshme.

Në rast të mospërputhjeve të cilat nuk janë riparuar ose në rast të kalimeve të refuzuara, sistemi në mënyrë automatike i ruan këto gabime në një tabelë specifike të bazës të të dhënave, e cila gjithashtu tregon kodin identifikues që korrespondon me pyetësorin dhe fushën në të cilën është paraqitur gabimi. Sistemi gjithashtu lejon kontrollimin e editimit të gjithë sasisë (*batch*); duke përdorur si input të dhënat e ruajtura, sistemi siguron raport të organizuar për të gjitha mospërputhjet, kalimet e refuzuara ose vlerat që mungojnë, e të cilat ndonjëse janë vërejtur gjatë hyrjes së të të dhënave, nuk janë përfillur nga operatori.

Sistemi përmban kopjen e të të dhënës, ashtu si ka hyrë gjatë operacionit të futjes së të të dhënave dhe meqë rezultojnë me editim të sasisë (*batch*) dhe kontrollim të të dhënave. Çfarëdo ndryshimesh të kryera në të të dhënat origjinale regjistrohen – ndryshim pas ndryshimi – në një tabelë specifike të bazës së të të dhënave MySQL, me qëllim të sigurimit të transparencës së gjithë operacionit për përpunimin e të të dhënave.

Përveç kësaj, sistemi ofronte një sërë përdorimesh të ndryshme: i) eksportin e të të dhënave në SPSS, SAS dhe STATA; ii) kryen riformatizimin e të të dhënave.

Plani i aktiviteteve të zbatuara për futjen e të të dhënave nga Regjistrimi testues ishte me sa vijon:



- Testimi përfundimtar i sistemit
- Trajnimi i kontrolluesve dhe koduesve
- Kontrollimi dhe kodifikimi i pyetësorëve
- Trajnimi i operatorëve për futjen e të të dhënave të RS1 dhe BL1
- Futja e të të dhënave nga formularët RS1 dhe BL1
- Trajnimi i operatorëve për futjen e të të dhënave nga formularët R1, R2, R3
- Futja e të të dhënave nga pyetësorët R1, R2, R3
- Editimi (batch) nga pyetësorët R1, R2, R3
- Kontrollimi përfundimtar i të të dhënave

Kodifikimi dhe korigjimi i pyetësorëve

Identifikimi i saktë i secilit pyetësor është një veprim qenësor për gjithë procedurën e futjes së të të dhënave për dy qëllime, sigurimin që të gjithë pyetësorët të jenë të përpunuar dhe për nxjerrjen e pyetësorëve individual për kontrollimin e të të dhënave. Për procedurën e futjes së të të dhënave është jashtëzakonisht me rëndësi që pyetësorët për secilën ekonomi familjare të jenë të rregulluar sipas renditjes.

Kur pyetësorët përkatës të një QR janë pranuar nga terreni, një grup prej 6 personash (korigjues dhe kodifikues) kanë kryer këto aktivitete paraprake në zyrë me qëllim të:

- Kontrollimit të tërësisë dhe strukturës së pyetësorëve të një banese/ekonomie familjare/familjes dhe nëse pyetësorët janë identifikuar me saktësi.
- Kontrollimit që secili anëtarë i ekonomisë familjare ka përmbushur kriteret për intervistim.

Grupi i korigjuesve dhe kodifikuesve është trajnuar për dy ditë, për sigurimin e klasifikimit të saktë të përgatitjes shkollore (ISCHED), aktivitetit ekonomik (NACE) dhe profesionit (ISCO).

Zyra për operacionin e futjes së të të dhënave

Zyra për operacionin e futjes së të të dhënave ishte pajisur me 10 kompjuterë, 1 server, disa dollapë për arkivim të pyetësorëve origjinal (letër), tavolina dhe priza elektrike. Për t'u mbrojtur nga humbja e të të dhënave në rast të ndërprerjeve të rrymës elektrike, secili kompjuter ka qenë i furnizuar me rrymë në mënyrë të vazhdueshme (UPS). Veç kësaj, duke pasur parasysh ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike është siguruar edhe gjeneratori.

Futja e të të dhënave nga formularët BL dhe RS1

Para se të futeshin të dhënat nga pyetësorët, operatorët kanë futur të dhënat e pyetësorëve BL dhe RS1 që ishin përpiluar nga regjistruerit. Ky hap ishte i rëndësishëm për sigurimin e kontrollimit të saktë të operacionit të futjes së të të dhënave pasuese. Në të vërtetë, regjistrimi i secilës banesë dhe i secilës ekonomi familjare të raportuar në Formularin RS1 në nivel të QR, ka mundur një kontrollim preciz të të gjitha shifrave gjatë operacioneve të mëtejme; faktikisht, stafi i TI ka pasur mundësinë që të kontrollojë numrin e përgjithshëm të personave, ekonomive familjare dhe banesave gjatë futjes së të të dhënave nga formularët R1, R2 dhe R3:



kur vëreheshin dallime, ishte e lehtë që këto të identifikoheshin, nëse ishte fjala se operatori kishte harruar të fus të dhënat nga pyetëtori, ose nëse pyetëtori kurrë nuk ka arritur deri te faza e futjes së të të dhënave ose nëse regjistruesi kishte bërë gabim gjatë plotësimit të formularit RS1.

Futja e të të dhënave nga formularët R1, R2, R3

Me përfundimin e kontrollimit në zyrë, QR i caktohej operatorit për futjen e të të dhënave. Numri, emri i operatorit të caktuar për futjen e të të dhënave të QR, si dhe data regjistroheshin në formularin për QR të aplikacionit për futjen e të të dhënave.

Të dhënat nga pyetëtorët futeshin sipas radhës së mbledhjes, d.m.th. të dhënat e banesës që vinin nga formulari i ekonomisë familjare dhe në fund vinte formulari individual. Me futjen e të gjitha të dhënave për një banesë, operatori mund të vazhdonte me banesën tjetër.

Në këtë fazë, me qëllim të zvogëlimit sa më të madh të gabimeve gjatë futjes së të të dhënave dhe meqë të dhënat nga pyetëtorët ishin futur, programi automatikisht kryente kontrollime të renditjes, kalimit dhe të përputhjes. Në rast të mospërputhjeve të kalimeve të refuzuara, sistemi automatikisht i regjistronte këto gabime në një tabelë specifike së bashku me kodet identifikuese të pyetësorëve dhe fushën ku kishte ndodhur gabimi. Një listë e mospërputhjeve gjatë futjes së të të dhënave është paraqitur në shtojcën 2.

Editimi i Bar kodit

Pas futjes së të gjitha QR, operatorët për futjen e të të dhënave kryenin editimin e Bar kodit. Aplikacioni për editim të Bar kodit siguron një raport për të gjitha mospërputhjet, kalimet e refuzuara ose vlerat që mungojnë të cilat – ndonëse janë hetuar gjatë futjes së të të dhënave – nuk ishin përfillur nga operatori. Ky raport ishte organizuar në QR.

Operacioni i ardhshëm përbëhej nga kontrollimi i secilit gabim të paraqitur në raportin mbi editimin e Bar kodit kundër vlerës së shënuar në pyetëtorët origjinal: kur gjendeshin gabime, kryhej korrigjimi i të të dhënave të regjistruara. Duke pasur parasysh se gjatë analizës testuese të të dhënave është me rëndësi të kuptohet se cilat gabime janë bërë më së shumti nga regjistruesit. Rregulla e miratuar ishte se korrigjimet e të të dhënave mund të kryhen vetëm nëse gjendet dallimi ndërmjet vlerës në letër dhe vlerës së regjistruar.

Do theksuar se, të gjitha ndryshimet e kryera në këtë fazë janë regjistruar në një tabelë së bashku me numrin identifikues të pyetësorit, fushën ku ishte bërë korrigjimi, vlera origjinale dhe vlera e re.

Kontrollimi përfundimtar i të të dhënave

Një mori tabelash të frekuencës janë krijuar për të raportuar të gjitha gabimet që ende ekzistojnë nëpër pyetësorë të ndryshëm si bie fjala, mospërputhje, vlera që mungojnë ose përgjigje që nuk janë kërkuar. Gjithashtu është krijuar një listë e pyetësorëve me më shumë se 8 gabime: përsëri, të gjitha vlerat e regjistruara të



këtyre pyetësorëve janë kontrolluar duke i krahasuar me vlerat ekzistuese në pyetësorët origjinal (në letër).

Në këtë fazë të punës, ishte e sigurt se gabimet e mbetura ishin shkaktuar prej problemeve të natyrës së ndryshme, kryesisht të paraqitura gjatë intervistimeve.

Një analizë e hollësishme e gabimeve të mbijetuara është kryer dhe konkludimet do të paraqiten më hollësisht në Shtojcën 2.



2. Rezultatet kryesore dhe rekomandimet

Duke ndjekur vlerësimin e tërë regjistrimit testues e në veçanti, në bazë të rezultateve të analizave të të dhënave të mbledhura gjatë aktiviteteve të terrenit, në vijim përmbledhet një numër i rezultateve. Objektivi është të paraqiten aspektet e forta dhe të dobëta të ndërmarra në regjistrimin testues me qëllim që të sigurohet një kontribut i dobishëm operacional dhe teknik për të rikrijuar në fakt pikënisjen e aktiviteteve që duhet zbatuar për realizimin e regjistrimit të përgjithshëm.

Për çdo aspekt vlerësimi i ushtrimit të regjistrimit testues është raportuar një përshkrimi shkurtë i rezultateve se bashku me tregues-ku është e nevojshme- të një apo me shumë mënyrave se si të përmirësohen komponentë përkatës. Për më tepër shpjegime analizave të hollësishme të të dhënave të grumbulluara i janë bashkangjitur këtij raporti në shtojca.

➤ **Pjesëmarrja e popullsisë në testim të cilët jetojnë në qarqet e zgjedhura**

Me vetëm pak përjashtime, pjesëmarrja e popullsisë në qarqet e regjistrimit ku aktivitetet është dashur të realizohen janë realizuar pa probleme. Popullata i mirëpritën regjistruesit dhe gjithmonë me qëndrim bashkëpunues siguruan informatat e kërkuara.

Në të kundërtën siç u raportua në kapitullin 1, në qarqet e zgjedhura të banuara me pakicën serbe dhe rome, popullata nuk mori pjesë në regjistrimin testues, edhe pse nuk ishte e mundur të verifikohet nëse kjo ishte për shkak të kundërshtimit ndaj Pushtetit Lokal ose gjithashtu ishte qëndrim i përgjithshëm i banorëve.

Sidoqoftë, ngjarjet të cilat kanë shpjer në mbulesën jo të plotë të qarqeve të zgjedhura për regjistrimin testues janë domethënëse pasi që ato po ashtu mund të paraqesin problemet e përfshirjes (mbulimit) për regjistrimin testues; prapëseprapë kjo mund të shpjegohet nga aspekti jo-teknik pasi që shkaqet varen nga natyra politik i cili është duke ndryshuar dhe është në vazhdim.

Zhvillimi i ngjarjeve në komunat e Shtërpçës dhe Kamenicës demonstuan disa vështirësi të Entit të Statistikave të Kosovës për t'i përfshirë pakicën në procesin e regjistrimit. Duket se është e rëndësishme që faktorët tjerë në bashkëpunim ose në emër të ESK-së- dhe me mandat zyrtar- që janë në pozitë të bëjnë progres të përparuar në këtë drejtim.

➤ **Menaxhimi dhe monitorimi i operacioneve në terren**

Edhe pse nuk ishte e mundur të vlerësohen operacionet e punëve në terren duke iu referuar aktiviteteve në teren në zonat e banuara me grupe të popullsisë serbe dhe rome, organizimi i punës së tërësishme në terren në përgjithësi ka dhënë rezultate të mira. Grumbullimi i të dhënave ka filluar dhe mbaruar sipas planit dhe vazhdimisht është monitoruar nga zyra e regjistrimit të ESK-së; megjithatë kjo ka ndodhur me një angazhim të tepërt të punëtorëve të ESK-së i cili nuk mund të përsëritet gjatë regjistrimit të përgjithshëm për shkak të numrit të



kufizuar të ekspertëve të ESK-së në krahasim me vëllimin dhe kohëzgjatjen e tërë operacionit. Të gjitha vështirësitë e hasura nga regjistruesit, kontrollorët dhe mbikëqyrësit janë raportuar me kohë tek përfaqësuesit e zyrave rajonale të ESK-së në secilën Komunë të cilat menjëherë informonin zyrën e drejtorisë së regjistrimit në Kryeqendrën e ESK-së. Shtojmë se takimi ditor në orën 19.00 me pjesëmarrësit e ekspertëve nga konsorciumi ishte moment i përshtatshëm për të diskutuar rreth operacioneve.

Po ashtu të dhënat e regjistruara për banesa, ekonomi familjare dhe persona janë transmetuar çdo ditë nga secila komunë në kryeqendrën e ESK-së në Prishtinë duke siguruar mjet efikas për monitorimin e operacioneve të terrenit për çdo qark.

Nga aspekti operacional, për regjistrimin e përgjithshëm sugjerohet të parashikohet sigurimi i një shume të parave në ESK për të mundësuar zgjidhjen e menjëhershme të shpenzimeve të paparashikuara dhe urgjente, siç dhe ka ndodhur për shembull në fillimin të operacioneve testuese në terren kur ka qenë nevoja emergjente për mbushje të telefonave celularë që të mund të mbahej kontakti i vlefshëm për atë kohë me punëtorët e terrenit.

➤ **Madhësia e qarqeve të regjistrimit, hartat e regjistrimit dhe SIG (Shtojca 1)**

Edhe pse ndarja e QR-ve ka treguar rezultate të mira në përgjithësi, duket se është e nevojshme rishikimi i numrit të vlerësuar të ekonomive familjare në zonat urbane ku një numër i banesave është gjetur i pabanuar dhe në qarqet e zgjedhura rurale ku ndërtimi i ndërtesave të reja mund të rris në mënyrë të konsiderueshme numrin e popullsisë rezidente në krahasim me popullsinë e vlerësuar..

Hartat po ashtu kanë demonstruar të jenë të përshtatshme për operacionet e terrenit, por azhurnimi i tyre konsiderohet të jetë i nevojshëm e posaçërisht për zonat urbane, kryesisht për ti zbuluar ndërtesat e reja.

Përmirësime të vogla në faqosjen dhe punë shtesë për azhurnimin e bazës së të dhënave të SIG-ut duket të jenë të favorshme.

➤ **Pyetësorët (Shtojca 2)**

Rezultatet e analizave të dhënave kanë spikatur nevojën për përmirësime në formulimin dhe organizimin e pyetjeve si dhe në paraqitjen e tyre. Po ashtu mund të merret parasysh edhe mospërfshirja e disa pyetjeve të caktuara. Sasia dhe karakteristikat e këtyre përmirësimeve ndryshojnë ndër pyetësorë.

Sa për formularin e banesave nuk ka probleme specifike për të cilat duhet raportuar lidhur me formulimin e pyetjeve apo strukturës së pyetësorit. Megjithatë, përqindja e lartë e përgjigjeve që mungojnë të shënuara në pyetjet e hapura mbi numrin dhe sipërfaqen e dhomave të shfrytëzuara për biznes apo qëllime profesionale sugjerojnë nevojën që t'u tërhiqet vërejtja regjistruesve se është jashtëzakonisht e rëndësishme të mos i lënë përgjigjet e zbrazëta kur



kërkohet përgjigja e qartë sipas pyetësorit (edhe nëse përgjigjja do të ishte “jo” ose vlera e cila duhet të shkruhet do të ishte “0”).

Formulari i ekonomive familjare, definimi i ekonomisë familjare dhe bërthamës (nukleusit) familjare duhet të bëhet më i qartë së bashku me dallimet mes raporteve mes konceptit të personit referues dhe atij të statusit familjarë. Gabimet lidhur me sektorin e bujqësisë mund të ndalohen duke ndryshuar formulimin e pyetjes kryesore filtër (A ka ekonomia familjare tokë në pronësi apo në shfrytëzim?) për të sqaruar qëllimin e saj dhe prapë vërejtja e përgjithshme që me saktësi të ndjeken rrugët e pyetësorit.

Sa i përket formuarit individual, sektori i arsimit ka nevojë të madhe të rishikohet që të merren parasysh ndryshimet e bëra në sistemin arsimor e që nëse nuk mundet të drejtohet si duhet natyrisht se mund të mbledh të dhënat e duhura. Formulimi i disa pyetjeve në sektorin ekonomik po ashtu duhet të thjeshtësohen dhe të reduktohet një numër i pyetjeve që mund jetë i favorshëm që të në zvogëlimin e ngarkesës së përgjegjësit dhe të rris cilësinë e rezultateve. Prapë për në fund, qëndron se regjistruerit duhet të udhëzohen t'i ndjekin me saktësi rrugët e pyetësorit të cilat drejtpërdrejt i drejtohen pyetjes lidhur me përgjegjësin edhe kur mund të duket se është e panevojshme (psh. Pyetjet për statusin martesor sa i përket fëmijëve edhe pse pritet që ata të mos jenë të martuar), kështu të shmanget përqindja e lartë e mungesës së informatave për variabla strukturore (siç është rasti tek statusi martesor).

➤ **Udhëzimet dhe formularët e tjerë të regjistrimit**

Duke marrë parasysh vlerësimin e materialeve, gabimet e zbuluara me përpunimin e të dhënave të grumbulluara nga raportet ditore të zyrave rajonale të ESK-së, formularëve vlerësues të plotësuar nga regjistruerit, raportet në fund të aktivitetit të përgatitura nga kontrollorët dhe mbikëqyrësit dhe vëzhgimit të drejtpërdrejt të aktiviteteve në terren duket se është se mundshme të përfundojmë se doracakët e udhëzimeve të përgatitura në tri gjuhët zyrtare dhe në tri variante të ndryshme, për regjistruer, kontrollorë dhe mbikëqyrës nuk janë përdorur si udhëzime fundamentale për operacionet e terrenit. Kjo kryesisht është për shkak të faktit se shumë nga regjistruerit nuk kanë pasur kohë të lexojnë udhëzimin para dhe gjatë periudhës së regjistrimit. Si duket një ose dy ditë duhet kushtuar këtij aktiviteti, ndoshta mes programit të trajnimit ose të ndahet trajnimi në dy pjesë që të mundësohet kohë e mjaftueshme për të lexuar dhe kuptuar materialet mbështetëse. Janë spikatur se disa pika në udhëzues nuk ishin mjaft të qarta ose ka pasur nevojë për më shumë shpjegime, ose shembuj.

Formularët tjerë të regjistrimit janë parë si të përshtatshëm në përgjithësi për raportim dhe monitorimin e operacioneve të terrenit. Analiza më të detajzuara janë raportuara në Shtojcën 2, kapitulli 3, “Përfshirja dhe krahasueshmëria mes formularëve shtesë dhe pyetësorëve”. Ndryshimet e pakta duhet të bëhen sipas modifikimeve të ardhshme në pyetësorë.



➤ **Trajnimi dhe angazhimi i punëtorëve të terrenit**

Në bazë të analizave të numrit dhe llojit të gabimeve të bërë në plotësimin e pyetësorëve dhe formularëve të tjerë të regjistrimit, numrit të mospërputhjeve dhe duke marrë parasysh poashtu edhe vëzhgimin e drejtpërdrejtë nga ekspertët e projektit dhe punëtorëve të ESK-së gjatë regjistrimit duket se është e rëndësishme të përmirësohet organizimi programit trajnues dhe të rishikohen materialet e trajnimit për mbikëqyrës, kontrollorë dhe regjistruar. Me siguri për shkak të mungesës së përvojës në realizimin e regjistrimit në Kosovë, sugjerohet që punëtorët e terrenit kërkojnë një trajnim më të gjatë dhe më intensiv dhe se parimi i kaskadës (nga lartë-poshtë) duhet të merret parasysh. Një alternative mund të jetë të krijohet një njësi e trajnuesve për të trajnuar të gjithë mbikëqyrësit dhe/ose regjistruarët sipas grupeve të komunave. Për çdo rast, zyrat rajonale të ESK-së duhet të përfshihen drejtpërdrejtë në proces.

Kjo çështje po ashtu është e lidhur me angazhimin e punëtorëve të terrenit. Propozohet riorganizimi i mekanizmit dhe procedurave për angazhimin e mbikëqyrësve, kontrollorëve dhe regjistruarëve me një përfshirje të drejtpërdrejtë të Entit Statistikor.

➤ **Logjistika e regjistrimit**

Shpërndarja dhe kthimi i materialeve tek dhe nga operacionet e terrenit në përgjithësi ishte i organizuar mirë edhe pse ka nevojë të bëhen disa përmirësime. Ngjarjet që kanë ndodhur rralë gjatë regjistrimit testues, siç janë raportuar në kapitullin e parë, duhet të shmangen me siguri duke zbaruar një riorganizim të punës së grupit të logjistikës dhe përgjegjësitë përkatëse në ESK dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së zyrave rajonale në aktivitetet përgatitore.

Një sugjerim shtesë është të rforcohen sinergjitë mes ekipeve të logjistikës dhe hartografisë.

Për t'u vendosur një sistem i cilësisë së mirë dhe i saktë për operacionet e terrenit sugjerohet të jepen përgjegjësi të qarta mbikëqyrësve dhe kontrollorëve dhe të udhëzohen ata se si të themelojnë dhe të rforcojnë një shpirt ekipor ndër punëtorët e terrenit.

Mundësia që u cek si rrezik në fillim të procesit të regjistrimit, tensioni mes Shqiptarëve dhe pakicave duket se mund të pengojë operacionet e punës në terren ku tani është e vështirë të vlerësohet më përpara dhe saktë, siç u provuam gjatë regjistrimit testues.

➤ **Përpunimi i të dhënave**

Vlerësimi i komponentëve të ndërmarrja për përpunimin e të dhënave është përcjellë në faza të ndryshme të punës së realizuar pas operacioneve të terrenit:

- Gjatë operacioneve për pranimin e të dhënave një numër i kontrolleve është zbatuar për të siguruar saktësinë e pyetësorëve të plotësuar. Kjo ishte e mundshme për shkak se Sistemi për Pranimin e të Dhënave përmban një seksion të zhvilluar për ruajtjen e gabimeve të ndryshme



(mospërputhjeve, vlerave që mungojnë, përgjigjet e pa-kaluara të cilat rrjedhin nga pyetësorët. Për çdo ndryshim të bërë në të dhënat origjinale mbahen në seksion tjetër të Sistemit, veçanërisht të zhvilluar për përcjelljen e këtyre lloj ndryshimeve.

- o Për kontrollimin e plotësimit të pyetësorëve të regjistruar në çdo QR, u bë një krahaso, mes të dhënave nga formulari RS1 dhe formularët R1/R2/R3. Ky lloj i ndryshimeve u zbatua gjysmë-manual me ndihmën e disa kërkesave (tabela) të disejnuara qëllimisht në bazën e të dhënave. Problemi i kësaj qasjeje ishte shpenzimi i shumtë i kohës.

Këto aktivitete duhet të përmirësohen duke integruar Sistemin aktual me sektorin e Menaxhimit Interaktiv të Regjistrimit i cili ndihmon monitorimin e procesit pranues të të dhënave në secilën fazë. Kjo mund të jetë qasje më e përshtatshme dhe efikase por po ashtu dhe më komplekse. Një përparësi mund të jetë mundësia e integritit në sistem po ashtu mjetin e logjistikës për monitorimin e operacioneve të terrenit dhe fazat e përpunimit. Çdo fazë në nivel të QR-ve atëherë do të monitorohej (duke filluar nga pranimi i pyetësorëve e deri tek përmirësimi i të dhënave) duke marrë raporte menaxhimi si për produktivitet dhe raporte për fazat e përfunduara. Në këtë mënyrë do të ishte e mundur të kërkohej çdo kohë raporte të cilat përmbajnë informata për statusin e çdo faze të përpunimit.

Si një benefit shtesë, ky seksion i ri i sistemit do të mund të sigurojë mekanizëm për të vërtetuar identifikimin gjeografik për të dhënat e përfshira, të shmang dyfishimet ose lënien jashtë të QR-ve dhe identifikimin e QR-ve kur numërimet e RS1 dhe R1/R2/R3 nuk janë brena nivelit të tolerancës së pranueshme. Po ashtu mund të mundësojë të grumbullojë të dhënat e regjistrimit në nivel më të lartë gjeografik për të prodhuar më lehtë rezultatet paraprake të regjistrimit.

Duke marrë parasysh sasinë e madhe të punës së kërkuara gjatë pranimit të të dhënave testuese, nuk ka qenë e mundur të realizohet përfshirja e dyfishtë e pyetësorëve. Duke shikuar rezultatet dhe kontrollet e zbatuara duke i krahasuar të dhënat e përfshira me pyetësorët në formatin e letrës, sidoqoftë k nxitur nevojën për të realizuar përfshirjen e dyfishtë të pyetësorëve duke zgjedhur sipas rastit pyetësorët e banesave të përfshirë nga çdo operatorë. Me të vërtetë përfshirja e dyfishtë në mënyrë drastike mund të reduktojë kohën e kërkuar për të bërë batch përmirësimet dhe kontrollet e fundit dhe mund të mundësojë analiza më të mira të cilësisë së aktiviteteve të përfshirjes së të dhënave.

➤ **Fushata informative**

Rezultatet e vlerësimit të fushatës informative bazohen në informatat e marra nga regjistruerit dhe të raportuara në ESK nga mbikëqyrësit. Si duket shpërndarja e materialeve publicitare në përgjithësi ka qenë efikase në zonat urbane, përderisa ishte më e vështirë në zonat rurale. Është raportuar se një pjesë e përgjegjësve nuk ishin të informuar e as nuk kanë qenë të njoftuar për regjistrimin testues. Kjo me siguri ishte për shkak të zgjidhjes së kufizimit të



materialeve publicitare vetëm në fletushka dhe afishe për regjistrimin testuese duke i mbajtur mjetet për fushatë më substanciale para regjistrimit të përgjithshëm. Pengesat kohore në shpërndarjen e materialeve të përgatitura në tri gjuhët zyrtare kanë ndikuar në arritjen e informimit dhe bërjen me dije për regjistrimin testues. Përdorimi i posterëve me siguri se do të kishte informuar më gjerë popullatën.

Për regjistrimin e përgjithshëm sugjerohet – natyrshëm- të fillohet me realizimin e përgatitjeve të materialeve publicitare disa muaj më herët para fillimit të operacioneve, me strategji ad-hok për popullatën rurale si dhe me aktivitete specifike që trajtojnë pakicat, pjesëmarrja e të cilave do të inkurajohej edhe përmes fushatës informative të regjistrimit. Po ashtu sugjerohet riorganizimi i grupit teknik përgjegjës në ESK.



RAPORTI I REGJISTRIMIT TESTUES - SHTOJCA 1 HARTOGRAFIA DHE SIGJ



NDARJA TERITORIALE, HARTOGRAFIA DHE SIGJ

Sfondi

Puna përgatitore e hartografisë për Regjistrimin e popullsisë, banesave dhe ekonomive familjare në Kosovë u bazua në orto-fotot digjitale të bëra në vitin 2004 që e mbulojnë tërë territorin e Kosovës përveç 200 km² sipërfaqe e zonave kufitare. Duke marrë ortofotot si harta bazë, QR u ndanë sipas kufijve aktual të ndarjes administrative të Kosovës, dhe objektet ndërtimore u identifikuan kryesisht përmes hulumtimit të fotove ajrore dhe digjitalizimin e kufijve të tyre në Sistemin Informativ Gjeografik (SIG/GIS). Në mungesë të kufijve administrativ të vendbanimeve këmi qenë të detyruara të bazohemi në kufijtë e zonave kadastrale. Për qëllime të gjeokodeve, kodet identifikuese u janë përcaktuar çdo njësie administrative e gjeografike, përfshirë dhe objektet ndërtimore. Një numër i pikave markante (shkolla, xhami, kisha, objekte industriale, varreza, etj) dhe emrat e rrugëve kryesore poashtu janë përfshirë në sistem. Nuk ka listë adresash në dispozicion për t'u përfshirë në sistem.

Ndarja e QR u realizua në bazë të vlerësimeve të popullsisë të marra nga informatat e siguruar nga Autoritetet Lokale dhe nga Përfaqësuesit e komuniteteve lokale duke marrë parasysh madhësinë dhe lartësinë e objekteve ndërtimore, numrin mesatar të anëtarëve për ekonomi familjare 6.2, të kalkuluar në anketat e mëparshme dhe mbajtjen e kufijve të QR-ve që përputhen sa më shumë që është e mundur me karakteristikat e identikuara fizike të terrenit. Si rezultat u vlerësua se numri i ekonomive familjare për QR mund të ndryshon nga 40 deri 60 në qarqe rurale dhe nga 80 deri 120 në qarqe urbane. Gjithsej janë ndarë 4,952 QR prej të cilave 1,534 mbulojnë zonat urbane të Kosovës.

Hartat digjitale të QR, hartat të cilat tregojnë zonat e përcaktuara për Kontrollorë dhe Mbikëqyrës janë nxjerrë nga SIG dhe shtypur në formatin A3, A2, A1 ose A0.

Objektivat

Ky seksion i raportit synon analizimin e katër aspekteve kryesore:

- A.** Ndarja e duhur e QR për të siguruar përafërsisht në mënyrë të barabartë, i përshatshëm për tu mbuluar nga një regjistruer gjatë periudhës së grumbullimit të të dhënave duke maksimizuar ngarkesë të njëjtë së punës për regjistruerit
- B.** Numrin dhe llojin e ndryshimeve fizike të ngjara në nivelin e objekteve ndërtimore që kur janë bërë ortofotot ajrore më 2004
- C.** Përshtatshmëria e letrës së hartave për të mbështetur organizimin dhe realizimin e operacioneve në teren
- D.** Kapaciteti i SIG për të prodhuar harta në nivel të QR-ve dhe të mbikqyrësve dhe për udhëhequr, analizuar dhe prezantuar të dhënat e regjistrimit në nivele të zonave të ndryshme



Metodat dhe rezultatet

Objektivat **A** dhe **B** u realizuan duke analizuar të dhënat e grumbulluara përmes formularëve R1, R2 dhe BL1 të regjistrimit dhe hartat e azhurnuara për terren gjatë regjistrimit testues. Të dhënat e shfrytëzuara në nivel të QR-ve janë:

- Numri i regjistruar i ekonomive familjare, individëve dhe njësive banesore
- Numri i vlerësuar i ekonomive familjare dhe objekteve ndërtimore
- Numri i regjistruar i objekteve ndërtimore me një apo më shumë ekonomi private familjare
- Numri i objekteve ndërtimore të klasifikuara për banim dhe jo për banim
- Numri i ndërtesave të klasifikuara gjatë operacioneve të terrenit në gjendje gjysmë të rrënuara
- Numri i objekteve ndërtimore të cilat nuk ekzistojnë më në datën e regjistrimit por raportohen në ortofotot e vitit 2004
- Numri i objekteve ndërtimore të ndërtuara që nga viti 2004
- Numri i objekteve ndërtimore në ndërtim e sipër

Tabelat vijuese tregojnë të dhënat kryesore të përdorura për analiza sipas QR. janë marr parasysh gjithsej 17 QR nga 24 siç janë planifikuar në fillim në përbërje të kornizës së mostrës për Regjistrimin Testues. Për 7 QR e tjera nuk janë grumbulluar të dhëna ose janë mbledhur pjesërisht. Burimi i të dhënave është raportuar në rreshtin kryesorë, në kllapa.


Një pako të hartave të zgjedhura tematike janë raportuar për të shpjeguar rezultatet dhe për të testuar mundësitë e bazës së të dhënave të SIG për shpërndarjen e të dhënave.

Ekonomitë familjare, individët, njësitë banesore dhe objektet ndërtimore sipas QR

Komuna	Kodi i QR - R, rural U, urban	Nr. i vlersuar i ekonomive familjare	Nr. i ekonomive të regjistruara familjare (R2)	Ndryshimet mes ekonomive familjare te regjistruara dhe të vlerësuara	Ndryshimet mes ekonomive familjare të regjistruara dhe të vlerësuara në %	Nr i individëve të regjistruar (R3)	Nr. i njësite të regjistruara banesore (R1)	Nr i njësite të regjistruara banesore të pabanuara(R1)	Nr i vlersuar i obj. ndërtimore	Nr. i obj. ndërtimore të regjistruara (BL)	Nr i obj. Ndërtimore për banim dhe jo për banim të regjistruar me ekonomi familjare-	Nr i obj. të tjera ndërtimore jo për banim (BL)	Nr. i obj. të reja ndërtimore (BL)	Nr i ndërteave që nuk egzistojnë më (BL)	Nr. i obj. ndërtimore gjysem të rrënuara (BL)	Nr. i obj. në ndërtim e sipër (hartat)
Kamenicë	019R	59	55	-4	-6.8	329	61	5	129	131	61	71	2	1	1	0
Kamenicë	070U	123	63	-60	-48.8	264	92	28	53	54	7	49	1	8	8	1
Kamenicë	073U	130	79	-51	-39.2	348	106	25	118	118	77	34	0	1	2	2
Kamenicë	074U	94	57	-37	-39.4	271	78	21	103	103	70	33	0	0	2	3
Kamenicë	092R	40	42	2	5.0	236	51	9	89	89	49	40	0	2	2	1
Kamenicë	141R	67	71	4	6.0	407	82	9	148	153	81	72	5	3	3	2
Kamenicë	155R	47	44	-3	-6.4	267	52	8	104	108	52	55	4	2	2	0
Pejë	062R	40	44	4	10.0	296	59	15	87	90	58	32	3	0	0	0
Pejë	085R	58	86	28	48.3	497	111	25	127	137	107	29	10	0	0	0
Pejë	126U	78	61	-17	-21.8	227	88	27	7	7	7	0	0	0	0	0
Pejë	139U	130	135	5	3.8	688	168	33	143	163	152	13	20	0	0	2
Pejë	173U	116	76	-40	-34.5	368	125	49	80	90	69	21	11	0	0	0
Pejë	194U	108	98	-10	-9.3	459	118	20	119	124	105	19	5	0	0	0
Pejë	202R	81	97	16	19.8	576	134	37	179	184	133	52	5	4	4	1
Pejë	231R	73	79	6	8.2	368	123	44	160	171	116	54	11	4	4	2
Shtërpcë	013R	54	57	3	5.6	361	77	20	118	126	74	51	8	2	3	0
Shtërpcë	016R	40	59	19	47.5	354	68	9	87	100	61	47	12	4	4	4
Total		1338	1203	-135	-10.1	6316	1593	384	1851	1948	1279	672	97	31	35	18


Fig. 1

Regjistrimi i Ekonomive familjare sipas QR



Ditancat, pozitat e madhësive të qarqeve janë rregulluar për përshtatje të faqesjes


Fig 2 **Ndryshimi ndërmjet Regjistrimit dhe Vlersimit të ekonomive familjare sipas QR**




Ditancat, pozitat e madhësive të qarqeve janë rregulluar për përshtatje të faqesjes

Fig. 3

Regjistrimi i Personave sipas QR



Ditancat, pozitat e madhësive të qarqeve janë rregulluar për përshtatje të faqesjes



Në Fig. 1, klasat janë ndërtuar duke i ndjekur nivelin e vlerësuar të ekonomive familjare në qarqet rurale (nga 40 deri 60) dhe në qarqet urbane (nga 80 deri 120). Gjashtë QR rurale nga 10 bien në klasat e përkatëse, përderisa 4 të tjerat përmbajnë numër të madh të ekonomive familjare. Në veçanti, 2 nga to, në komunën e Pejës, numri i ekonomive familjare ishte i lartë, madje edhe më i lartë se në viset tjera rurale. Në këto raste duhet angazhuar një regjistrues shtesë për QR për të grumbulluar të dhëna. Kjo ka ngjarë në fillim të operacioneve në terren vetëm për QR të Radavcitet, me 97 ekonomi familjare, por jo dhe me QR të Novoselës ku gjithsej janë regjistruar 79 ekonomi familjare. Në këtë rast specifik, numri mesatar i anëtarëve të ekonomive familjare ishte më i ulët në krahasim me vendet tjera rurale, por një regjistrues shtesë duket se është e nevojshme të shtohet sa herë që me shumë se 70 ekonomi familjare jetojnë në të njëjtin QR.

Në të kundërtën, në qarqet urbane shumica e QR përfshijnë numër të vogël të ekonomive familjare. Vetëm një ka rënë në klasën e duhur. Një QR në komunën e




Pejës ka përmbajtur 135 ekonomi familjare dhe 688 individë. Në këtë QR ka mundur të angazhohen dy regjistruar.

Fig. 2 vërteton se në QR rurale numri i ekonomive të regjistruara familjare në përgjithësi është më i lartë se sa është pritur përderisa në zonat urbane në përgjithësi janë regjistruar numër më i vogël i ekonomive familjare nga ai që është vlerësuar.

Mesatarisht vlerësimi ishte i përafërt me 8 ekonomi familjare për QR rurale dhe për qarqet urbane i përafërt me 30 ekonomi familjare. Përkundrazi në qarqet rurale numri i ekonomive familjare për QR ishte nën njësinë e vlerësuar, mesatarja 7.5 njësi. Një rishikim i ndarjes së QR-ve synon në përmirësimin e vlerësimeve të numrit të ekonomive familjare që me siguri do të jetë e nevojshme, së paku në qarqet e zgjedhura.

Fig. 3 megjithatë paraqet se nëse individët do të ishin marrë parasysh në vend të ekonomive familjare, kufijtë e QR me sa duket mundësojnë shpërndarje më të mirë të popullsisë. Me përjashtim të QR-ve veç të përmendura, 1 urbane dhe 1 rurale në komunën e Pejës, numri i individëve për QR gjithmonë është nën 500 individë, e që do të konsiderohej si numri maksimal i pyetësorëve individual të regjistrohen nga një regjistruar. Mesatarja e individëve të regjistruar për QR është pothuajse 400, është i barabartë për qarqet urbane dhe rurale. Duke pasur si referencë numrin mesatar të ekonomive familjare për qarqet urbane dhe rurale, 4.6 dhe 5.8 respektivisht të përcaktuar sipas të dhënave të regjistrimit testues, një rishikim që trajton ndarjen e QR-ve do të mund të merrej parasysh si përvlerësimet e ekonomive familjare dhe të individëve.

Fig. 4 paraqet një numër të rëndësishëm të njësive banesore pothuajse në të gjitha qarqet urbane. Megjithatë në shumicën e rasteve, stoqet e tyre nuk janë proporcionale me numrin e ekonomive familjare. Siç është raportuar kjo është për shkak të numrit të lartë të njësive banesore të gjetura të pabanuara gjatë mbledhjes së të dhënave të regjistrimit, 24% nga totali.



Siç u ilustrua në Fig. 5, ndryshimet kryesore në objektet ndërtimore në zonat e zgjedhura për regjistrimin testues kanë ngjarë posaçërisht në zonat urbane edhe pse në një përqindje të dukshme poashtu edhe në zonat rurale. Komponenti kryesor i ndryshimeve kryesisht ishte për shkak të ndërtimeve të objekteve të reja ndërtimore të cilat potencialisht mund të sjellin regjistruesve më shumë probleme se sa ndërtesat të cilat nuk ekzistojnë më në ditën e regjistrimit në krahasim me objektet ndërtimore të identifikuar me ortofotot e vitit 2004. Në të vërtetë, objektet ndërtimore të cilat nuk egzistojnë më dhe ndërtesat të cilat janë gjysmë të rrënuara duket se janë në numër të vogël (hangarë ose dyqane të vogla), që madje nuk mirren parasysh gjatë punës përgatitore të hartografisë.

Si pasojë, kjo ngarkesë e papritur shtesë për regjistruesit për shkak se ndërtesat e reja nuk do të kompensohen me komponentin e objektit ndërtimor i cili nuk ekziston



më. Në qarqet e zgjedhura për regjistrimin testues, komponenti i ndërtesave të reja i klasifikuar si "në ndërtim" si duket nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë duke marrë aluduar se ato nuk do të jenë objekte ndërtimore shumë-katëshe.

Objektivi C është arritur duke marrë parasysh raportet dhe formularët vlerësues të plotësuar nga regjistruerit, kontrollorët dhe mbikëqyrësit dhe si rezultat i hulumtimeve të drejtpërdrejta të realizuara nga punëtorët e ESK-së dhe ekspertët e projektit gjatë aktiviteteve të punës në terren.

Hartat e regjistrimit në përgjithësi janë konsideruar si të përshtatshme për aktivitetet e punës në terren. Hartat i kanë siguruar regjistruerit orientimin e duhur në terren dhe i kanë ndihmuar ata të gjejnë ndërtesat e përfshira në qarqet e tyre të regjistrimit. Të gjitha ndërtesat ishin identifikuar gjatë aktiviteteve në terren para periudhës së regjistrimit dhe u vizituan gjatë periudhës së grumbullimit të të dhënave.

Megjithatë, edhe pse hartat ishin të sakta dhe të kompletuara mirë, në një rast ka munguar kodi i disa ndërtesave dhe madhësia e hartave është parë se nuk ishte gjithmonë e përshtatshme gjatë aktiviteteve operative. Në disa raste, vija me ngjyrë i ka caktuar kufijtë e qarkut regjistruer ose kufijtë e ndërtesave ishin jo të karta nga ngjyra e tepërt e përdorur në paraqitjen e ortofotove. Në disa raste, kodet e ndërtesave nuk ishin mjaft të lexueshme, dhe janë përdorur shumë shkallë të ndryshme të hartave.

Objektivi D është arritur duke marrë në konsiderim procesin e përgatitjeve dhe të printimit të hartave të regjistrimit, modalitetet integruese të bazës së të dhënave të SIG-ut me të dhënat e marra nga të dhënat e përpunuara dhe duke testuar mundësitë e analizave dhe të shpërndarjes në nivele të ndryshme territoriale.

Hartat për regjistruerit, kontrollorët, mbikëqyrësit dhe për KKR në nivel komunal për qarqet e përzgjedhura për regjistrimin testues janë printuar me lehtësi në sektorin hartografik të ESK-së me kohë për regjistrimin testues. Ato janë marrë nga programi i SIG dhe janë ruajtur në fajllat e Jpg të gatshme për printim. Kjo ka siguruar madhësi më të vogël të dosjeve së bashku me shpejtësi më të madhe të shtypjes dhe rishtypjes të menjëhershëm nëse ka qenë i nevojshëm. Në të vërtetë kjo ka ndodhur gjatë regjistrimit testues në një QR të Kamenicës.

Rezultatet e prodhuara me aktivitetin e përpunimit të dhënave janë importuar në bazën e të dhënave të SIG-ut dhe janë lidhur përmes kodeve me të dhënat gjeografike për të verifikuar përputhjet në nivele të ndryshme të qarqeve për analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave. Ky aktivitet është realizuar në pajtim me kohën duke asociuar çdo tabelë të nxjerrë nga përpunimi i të dhënave për nivelin korrespondues (komuna, vendbanimi, QR). Në të kundërtën një strukturë e organizuar mirë në bazën e të dhënave të SIG-ut me një pako raportesh të lidhje me të dhënave gjeografike dhe variabla mund të shpejtojnë këtë procedurë dhe mund të sigurojnë mjete shtesë për kontroll të tërthortë (kryqzimi) të të dhënave me dimensione hapësinore.

Mundësia e shpërndarjes së të dhënave u testua duke bërë një pako të hartave tematike. Disa nga ato janë raportuar më lartë.



Mësimet e mësuara dhe propozimet

Edhe pse aktivitetet që kanë të bëjnë me hartografinë dhe SIG-un në përgjithësi kanë funksionuar mirë, ato kanë treguar nevojën për të planifikuar detyra shtesë dhe përmirësime të vogla për regjistrimin e përgjithshëm. Këto aktivitete janë konsideruar me rëndësi të veçantë pasi që mund të përmirësojnë shkallën e mbulesës dhe janë elementë qenësorë për tërë aktivitetin e punës në terren.

Po ashtu sugjerohet se këto aktivitete pretendojnë profil më të lartë të realizimit të tërë dhe udhëheqje e regjistrimit të ardhshëm dhe të bëhet me i integruar në aktivitetet e realizuara brenda grupeve punuese të ESK-së, kryesisht për grupin e logjistikës dhe demografisë.

Kriteri i përdorur për të ndarë QR duket që në përgjithësi ka dhënë rezultatet të përshtatshme duke marrë parasysh se në Kosovë më herët nuk ka pasur të dhëna të besueshme mbi njësitë e ekonomive familjare dhe banesave.

Megjithatë një rishikim i numrit të vlerësuar të ekonomive familjare sipas QR duket të jetë i nevojshëm së paku në qarqet e zgjedhura urbane, ku numri i njësive të pabanuara banesore ka rezultuar posaçërisht i lartë si në zonat urbane po ashtu dhe në ato rurale ku supozohet se një rritje e vazhdueshme e ekonomive familjare dhe individëve mund të regjistrohet gjatë regjistrimit të përgjithshëm në krahasim me vlerësimet origjinale.

Nevoja për të azhurnuar hartat duket të jetë e nevojshme për qarqet urbane dhe në disa qarqe të zgjedhura rurale, ku numri i ndërtesave të reja pritet të rritet vazhdimisht deri në kohën e realizimit të regjistrimit të përgjithshëm. Ky propozim po ashtu përkrahët posaçërisht nga fakti që në zonat rishtazi të urbanizuara në periferi të qyteteve kryesore të Kosovës dhe në veçanti në Prishtinë, vëllimi i ndërtimeve të reja është shumë i lartë se sa në qarqet e zgjedhura për regjistrimin testues.

Propozohet se aktivitetet e punës në terren për azhurnimin e hartave po ashtu mund të jetë e dobishme për rishikimin e ndarjes së QR-ve regjistruar në të njëjtën kohë numrin e njësive banesore dhe mundësisht ekonomitë në ndërtesa ose në nivel të qarkut.

Në këtë rast, ky aktivitet gjithsej do të kërkoj 4 muaj duke përfshir rreth 100 punëtorë të koordinuar nga ESK në nivelin qendrorë dhe rajonal.

Si rezultat i kësaj madhësia e QR duhet të kontrollohet duke hulumtuar numrin e njësive banesore, të vlerësohet numri mesatar i tyre për çdo ekonomi familjare dhe të përcaktohet popullsia duke përdorur numrin mesatar të anëtarëve të ekonomive familjare.

Disa përmirësime teknike po ashtu janë sugjeruar për përgatitjet e hartave të regjistrimit dhe për programin e SIG. Kjo përfshinë: i) tentimin për t'u standardizuar madhësia dhe shkalla e hartave; ii) reduktimi i madhësisë së hartave për regjistruar në zonat urbane; iii) përshtatje në faqesje; iv) përmirësime në dizajnimin e lidhjeve në bazën e të dhënave të SIG.



RAPORTI I REGJISTRIMIT TESTUES - SHTOJCA 2 ANALIZAT E TË DHËNAVE

**Frekuenca e Shpërndarjeve dhe
vlerësimi i kualitetit të të dhënave të mbledhura**



Përmbajtja

1.	Analiza e frekuencës së shpërndarjeve	3
2.	Analiza e gabimeve	29
2.1	Analiza e raporteve sipas llojit	29
2.2	Analiza e gabimeve sipas numrit dhe komunës/vendbanimit	34
2.3	Analiza e frekuencës së shpërndarjeve	40
3.	Analiza e gabimeve	43
3.1	Analiza e raporteve sipas llojit	43
3.2	Analiza e gabimeve sipas numrit dhe komunës/vendbanimit Propozime për përmirësime të mundshme të formularëve të regjistrimit	44



1. Analiza e frekuencës së shpërndarjeve

Analiza e të dhënave është kryer për të dhënat që janë mbledhur gjatë Regjistrimit testues, të mbajtur prej prej datës 30 tetor deri më 14 nëntor 2006.

Duhet përmendur se, komunat Pejë, Kamenicë, Shtërpçë janë përzgjedhur sepse përbmbajnë proporcione të ndryshme dhe popullatë të përzier. Kjo mostër në aspektin statistikor nuk përfaqëson Kosovën si tërësi, duke pasur parasysh mospjesëmarrjen e disa segmenteve të popullatës në këtë testim, të dhënat nuk duhet të konsiderohen se përfaqësojnë popullësinë e Kosovës.

Megjithatë, analizat e të dhënave dhe përgjigjet e fituara kanë ndriçuar edhe më shumë mënyrën e krijimit të pyetësorëve, e që është shumë me rëndësi për identifikimin e gabimeve, vështirësive për të kuptuar disa pyetje dhe të problemeve të strukturës së pyetësorëve, etj., të cilat janë një input i rëndësishëm për përmirësimet që mund të bëhen për një Regjistrim të përgjithshëm.

Numri i përgjithshëm i individëve (personat me vendbanim të zakonshëm) të regjistruar në 18 QR (8 në Pejë, 8 në Kamenicë, 2 në Shtërpçë) ishte 6,370 dhe numri i përgjithshëm i ekonomive familjare ishte 1,216 (tabela 1).

Tabela 1 – Individët dhe ekonomitë familjare sipas komunave

Komuna	Mesh.	Fem.	Gjithsej	%	Gjinia %	Ek.familjare	%
Pejë	1,692	1,787	3,479	54.6	94.7	676	55.6
Kamenicë	1,118	1,058	2,176	34.2	105.7	424	34.9
Shtërpçë	372	343	715	11.2	108.5	116	9.5
Gjithsej	3,182	3,188	6,370	100.0	99.8	1,216	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Ekonomitë familjare dhe familjet

Ekonomitë familjare që bashkëjetojnë nuk janë regjistruar¹. Lidhur me madhësinë e ekonomisë familjare (Tabela 2), më e madhja që ishte regjistruar kishte 19 persona, por numri mesatar i anëtarëve të ekonomisë familjare është 5.2, ndërsa modeli është ekonomia familjare 5 anëtarëshe (18.9% nga të gjitha ekonomitë familjare). Grupi i dytë për nga madhësia i ekonomive familjare është ekonomia familjare me 4 anëtarë (16.9%), përqindje të afërt me këtë përbëjnë ekonomitë familjare me 6 anëtarë (16.3%). Në fund, më shumë se një e dhjeta e ekonomive familjare (11.0%) kanë 7 anëtarë dhe gati çdo e shtata ka më shumë se 7 anëtarë.

¹ Sipas të ashtuquajturit koncept të "Mbajtjes së shtëpisë" (mbi të cilin edhe është bazuar Regjistrimi testues), numri i Ek. familjare private nuk është domosdoshmërisht i barabart me numrin e njësisive banesore. Në një banesë mund të regjistrohen një ose më shumë Ek. familjare. Mirëpo, brenda QR të përmendura, nuk ka pasur banesa me më shumë se një Ek. familjare. Të dyja shifrat për (njësitë banesore të banuara dhe Ek. familjare) përbëjnë numrin 1,216.



Numri mesatar i anëtarëve të ekonomisë familjare ndryshon sipas komunave: numri më i lartë mesatar i anëtarëve të ekonomisë familjare është regjistruar në Shtërpçë, me 6.2 anëtarë për një ekonomi, pason Kamenica, me 5.1, dhe Peja me 4.5.

Tabela 2 – Ek. familjare sipas numrit të anëtarëve

Numri i anëtarëve të Ek. familjare	Gjithsej	%
1 anëtar	39	3.2
2 anëtarë	100	8.2
3 anëtarë	141	11.6
4 anëtarë	206	16.9
5 anëtarë	230	18.9
6 anëtarë	198	16.3
7 anëtarë	134	11.0
Më shumë se 7 anëtarë	168	13.8
Gjithsej	1,216	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Lidhur me llojin e Ek. Familjare dhe përbërjen e gjeneratave, të cilat duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të realizueshmërisë së ndërtimit të familjes bërthamë nga ana e regjistruarëve por, mund të ndodhë që ka edhe Ek. Familjare që përbëhen prej shumë gjeneratave² dhe vlerësimi i një ekonomie të tillë familjare bëhet llogaritur numrin e familjeve dhe të dhënat për përbërjen e Ek. Familjare (llogaritjen e individëve sipas marrëdhënieve familjare që kanë me personin referues dhe sipas statusit në familje).

Përkitazi me marrëdhëniet familjare në raport me personin referues (*Tabela 3*), shpërndarja tregon se, përveç personave referues (që përbëjnë 19.0% e totalit), 15.7% e anëtarëve të ekonomisë familjare përbëhen prej burrit/gruas të personit referues, 44.0% prej djalit/vajzës, 10.0% prej nipave/mbesave, 4.9% prej dhëndurëve/rejave dhe 2.8% prej babëve/nënave. Shifrat përkitazi me marrëdhëniet tjera të personave me personat referues janë shumë të ulëta, duke përfshirë burrin/gruan pa kurorë (janë regjistruar vetëm tri raste)

Tabela 3 – Individët në marrëdhënie me personin referues

Marrëdhënia me personin referues		%
Person referues i ekonomisë familjare	1,216	19.1
burrë/grua	1,001	15.7
djalë/vajzë	2,804	44.0
babë/nënë	179	2.8
Gjysh/gjyshe	8	0.1
Nip/mbesë	639	10.0
djali/reja	312	4.9

² Frekuenca e një modeli të tillë të ekonomisë familjare në fakt duhet të mirret parasysh gjatë vlerësimit të realizueshmërisë rikonstruktimit në terren të familjes bërthamë që i është besuar regjistruarëve. Këta të fundit, në mënyrë që të jenë në gjendje për të plotësuar shtyllën 5 – numrin rëndor të bërthamës të cilës i takon personi – dhe 6 – statusi familjar i personit brenda familjes bërthamë – nga lista 1, është dashur që të gjindet numri i familjeve bërthamë brenda Ek. familjare dhe pas caktimit të kodit për secilën dhe pas vlerësimit të secilit anëtarë të Ek. familjare se cilës bërthamë i takon dhe më pas i ka caktuar çdo anëtarë të Ek. familjare kodin e “familjes bërthamë” dhe kodin mbi “statusin e personit brenda familjes bërthamë”.



Axha-daja/halla-tezja	3	0.0
burri/gruaja pa kunorë	14	0.2
Gruaja e dytë (pa certifikatë të kurorëzimit)	5	0.1
vëlla/motër	121	1.9
Vjehrra/vjehrrri	9	0.1
kunati/kunata	39	0.6
Nuk janë në lidhje	16	0.3
Jo i lexueshëm	4	0.1
Gjithsej	6,370	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Nuk është dhënë ndonjë rregull e caktuar për regjistruarit përkitazi me zgjedhjen e personit referues. Ky person zgjedhet lirshëm nga anëtarët e ekonomisë familjare me qëllim të identifikimit të marrëdhënieve në mes të anëtarëve të ekonomisë familjare. Siç edhe shihet nga shpërndarja e moshës së anëtarëve të ekonomisë familjare, të shumtën e rasteve personi më i vjetër në ekonominë familjare caktohet si person referues: në 3 prej 4 Ek. familjare me shumë persona (75.9%), nuk ka pasur anëtarë më të vjetër se personi referues, dhe ky i fundit në të shumtën e rasteve ishte një burrë (87.4%) me moshë mesatare prej 1.1.

Zgjedhja e personit më të vjetër për person referues duket se vështirë mund të shmanget, duke pasur parasysh kulturën e respektit të lartë për njerëzit e vjetër në Kosovë. Megjithatë, siç është sugjeruar nga rekomandimet ndërkombëtare të UNECE, për rastet e ekonomive familjare me anëtarë të gjeneratave të ndryshme, preferohet që të zgjedhet një person i moshës së mesme (në mënyrë që të regjistrohet shkalla më e gjerë e marrëdhënieve farefisnore).

Në bazë të madhësisë së ekonomisë familjare, numri mesatar i familjeve në një ekonomi familjare është më i madh se 1 (1.3). Çdo e pesta ekonomi familjare (20.2%) ka dy familje bërthamë dhe 4.2% e të gjitha ekonomive familjare kanë nga 3 familje bërthamë; nuk ka pasur Ek. familjare me më shumë se 4 familje bërthamë (Tabela 4). Ekonomi familjare pa familje janë vetëm 4.2% nga numri i përgjithshëm i ekonomive familjare (dhe Ek. familjare me vetëm një person ishin vetëm 3.0% nga numri i përgjithshëm), ndërsa Ek. familjare me vetëm një familje ishin pak më shumë se 70% kurse Ek. familjare me dy ose më shumë familje konsiderohen gati si një e katërta e numrit të përgjithshëm (kryesisht E. Familjare me dy familje) (Tabela 5).

Tabela 4 – Ek. familjare për nga numri i familjeve bërthamë

Numri i familjeve bërthamë		%
0	51	4.2
1	864	71.1
2	246	20.2
3	51	4.2
4	4	0.3
Gjithsej	1,216	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë



Tabela 5 – Ek. familjare për nga lloji

Lloji i Ek. familjare		%
Ek. familjare pa familje	51	4.2
<i>Ek. familjare me një person</i>	37	3.0
<i>Ek. familjare me shumë persona</i>	14	1.2
Ek. familjare me një familje	864	71.1
Ek. familjare me dy ose më shumë familje	301	24.8
Gjithsej	1,216	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Për sa i përket statusit të familjes, (Tabela 6), 45% e popullatës së përgjithshme të regjistruar jetojnë në familje bërthamë si fëmijë të të dy prindërve, ndërsa gati 43% janë gra ose burra që jetojnë me partner. Partnerët që bashkëjetojnë dhe fëmijët prej vetëm njërit partner janë regjistruar në një numër shumë të vogël. E njëjta vlenë për babat e vetëm dhe fëmijët e babave të vetëm, ndërsa nënat e vetme përbëjnë 2.4% dhe fëmijët e nënave të vetme përbëjnë 4% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të ekonomisë familjare. Në fund, anëtarët e ekonomive familjare që nuk i takojnë familjes përbëjnë vetëm 4.4%.

Tabela 6 – Individët me status familjar

Statusi familjar		%
Burri	1,353	21.2
Gruaja	1,333	20.9
Partneri mashkull në bashkëjetesë	24	0.4
Partneri femër në bashkëjetesë	23	0.4
Baba i vetëm me një fëmijë/fëmijët	20	0.3
Nënë e vetme me një fëmijë/fëmijët	150	2.4
Fëmij i të dy partnerëve	2,867	45.0
Fëmijë i partnerit mashkull	19	0.3
Fëmijë i partnerit femër	3	0.0
Fëmijë i babait të vetëm	40	0.6
Fëmijë i nënës së vetme	256	4.0
Jo anëtar i familjes	278	4.4
Mungon pr.	4	0.1
Gjithsej	6,370	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Për fund, zgjidhjet e testuara gjatë procesit të Regjistrimit testues për ndërtimin e familjeve bërthamë në mënyrë të arsyeshme do të mund të aplikoheshin edhe gjatë Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, meqë të dhënat tregojnë për mjaft ekonomi familjare të thjeshta dhe struktura familjare të thjeshta³ dhe pavarësisht nga përqindja mjaft e lartë e ekonomive familjare me më shumë familje (kjo do të ishte e vërtetë, nëse përzgjedhja e QR në të tria komunat do të mund të konsiderohej pasqyrim i realitetit demografik të Kosovës). Mirëpo, nga vëzhgimi në terren, dallimi në mes të variabileve "marrëdhënia me personin referues" dhe "statusi familjar" ishin

³ Mirëpo, para marrjes së vendimit përfundimtar, duhet të bëhet një analizë më e thellë, p.sh. shpërndarja marrëdhënies me personin referues duhet të analizohet në mënyrë të ndarë për Ek. familjare me një familje dhe ato me dy familje.



të vështira që të kuptohen dhe kërkonin një mentorim intenziv në terren nga ana e bashkërenduesve, prandaj sugjerohet nevoja për trajnim duke përdorur shembuj dhe studim të rasteve.

Karakteristikat demografike

Tek variabilet individuale, ishin regjistruar pothuajse numra të barabartë për Mesh. and Fem. në të tria komunat, që janë marrë si tërësi (shih *Tabela 1*). Ndonëse, përqindjet për gjininë ishin llogaritur në mënyrë të ndarë, në këto tri komuna vërehen disa dallime. Vlera e regjistruar në Shtërpçë ishte 108.5, Kamenicë 105.7 dhe në Pejë 94.7.

Struktura e popullatës për nga mosha është shumë e re dhe përqindjet e llogaritura janë paraqitur në (*Tabelën 7*), me (28.3%) të popullatës që janë nën moshën 15 vjeç dhe vetëm 7.6% për moshën mbi 65 vjet. Popullata më e re gjendet në dy QR të komunës së Shtërpçës, ku më shumë se 30% e popullatës është nën moshën 15 vjeç (krahasuar me Pejë me 28.7% dhe Kamenicë me 26.8%), ndërsa pjesa më e madhe e popullatës së aftë për punë ishte në Kamenicë (Kamenica 66.1%, Peja 63.5% dhe Shtërpça me 61.5%).

Tabela 7 – Individët e kategorizuar sipas grup moshës dhe komunës

Grup moshë	Peja/Peć		Kamenicë/Kamenica		Štrpce/Shtërpçë		Gjithsej	
0-14	998	28.7	584	26.8	219	30.6	1,801	28.3
15-64	2,209	63.5	1,439	66.1	440	61.5	4,088	64.2
65 e tutje	272	7.8	153	7.0	56	7.8	481	7.6
Gjithsej	3,479	100.0	2,176	100.0	715	100.0	6,370	100

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Analiza e llogarisë sipas gjinisë (*Tabela 8*), vlenë të përmendet se në disa grup moshë të mesme (veçanërisht prej 30-34 dhe 35-39 por, gjithashtu edhe për grup moshën që përfshinë personat e moshës prej 45 deri 54), shkalla për gjininë është ndjeshëm e ulët. E njëjta gjë vlenë edhe për grup moshën e vjetër, meqë kjo edhe pritej për shkak të diferencës në mortalitet në bazë të gjinisë.

Tabela 8 – Individët e kategorizuar sipas moshës dhe gjinisë. Shkalla e moshës në bazë të specifikës së gjinisë

Kat. e moshës	Mesh.	Fem.	Gjithsej	%	Shkalla - Gjinia
0-4	267	259	526	8.3	103.1
5-9	331	307	638	10.0	107.8
10-14	341	296	637	10.0	115.2
15-19	331	314	645	10.1	105.4
20-24	275	251	526	8.3	109.6
25-29	266	238	504	7.9	111.8
30-34	205	253	458	7.2	81.0
35-39	202	236	438	6.9	85.6
40-44	210	207	417	6.5	101.4
45-49	162	180	342	5.4	90.0
50-54	145	159	304	4.8	91.2
55-59	118	120	238	3.7	98.3



60-64	108	108	216	3.4	100.0
65-69	91	95	186	2.9	95.8
70-74	65	85	150	2.4	76.5
75-79	41	55	96	1.5	74.5
80-84	14	16	30	0.5	87.5
85-89	7	5	12	0.2	140.0
90-94	2	3	5	0.1	66.7
95 e tutje	1	1	2	0.0	100.0
Gjithsej	3,182	3,188	6,370	100.0	99.8

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Lidhur me vendin e lindjes (i konceptuar si vendbanim i zakonshëm i nënës në kohën kur ka lindë), 30.5% e popullatës së regjistruar ka lindur nëpër vende të ndryshme nga vendbanimi i zakonshëm aktual (Tabela 9). Vetëm 5.7% janë lindur jashtë Kosovës, ndërsa 10% janë lindur nëpër komuna të ndryshme dhe 14.6% janë lindur në komunë të njëjtë por, në vendbanim tjetër.

Tabela 9 – Individët e kategorizuar për nga vendbanimi i zakonshëm i nënës në kohën kur ka lindë

Vendi i lindjes	A. V.	%
Në Kosovë, komuna dhe vendbanimi i njëjt	4,429	69.5
Në Kosovë, komuna e njëjt por vendbanimi tjetër	930	14.6
Në Kosovë, komuna tjetër	639	10.0
Jashtë Kosovës	362	5.7
Mungon pr.	10	0.2
Gjithsej	6,370	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Më shumë se një e treta (35.8%) e personave të lindur jashtë Kosovës (5.7% e popullatës së përgjithshme) ishte lindur në Mal të Zi, ndërsa pothuajse një e treta (31.1%) ishte lindur në Serbi. Me përjashtim të vendeve të ish Jugosllavisë, e cila më parë ishte unike (përfshirë Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë dhe Maqedoninë, përveç Serbisë dhe Malit të Zi që u përmendën më heret) përbëjnë një vlerësim prej gati tri të katërtave (73.8%) të popullatës së përgjithshme të lindur jashtë Kosovës; shtetet tjera në të cilat janë lindur personat janë: Gjermania (14.0%), Zvicërra (5.2%) dhe Belgjika (1.1%); ndërsa vetëm në një rast personi ka shtetësi të huaj.

Për sa i përket statusit martesor të ligjshëm (Tabela 10), gjysma e popullatës (50.5%) nuk ka qenë e martuar kurrë, ndërsa aktualisht (42.4%) janë të martuar. Përqindja e përgjigjeve që mungojnë është mjaft e lartë (1.8%), ndërsa në masën (82%) është për shkak të fëmijëve të moshës nën 10 vjeç (sugjerimi për regjistruarit është se, në pyetje duhet të përgjigjen të gjithë personat duke përfshirë edhe fëmijët). Lidhur me shifrat e paraqitura për statusin martesor të ligjshëm, pothuajse tri të katërtat e personave të pa martuar janë më të ri se 25 vjet, kurse më shumë se një e katërta e personave të martuar (26.9%) janë më të ri se 34 vjet.



Tabela 10 – Individët sipas moshës dhe gjendjes martesore

Gjendja martesore	V.A.	%
I/e pa martuar	3,218	50.5
I/e martuar	2,703	42.4
I ve/vejushë	315	4.9
I/e shkurorëzuar	21	0.3
Mungon pr.	113	1.8
Gjithsej	6,370	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Në disa raste (1.4%), gjendja martesore e të cilëve është regjistruar si i/e pa martuar janë klasifikuar si burrë/grua sipas statusit familjar (në vend të partner mashkull e femër që bashkëjetojnë). Nëse statusi familjar merret si i sakt, mund të dilet me një teori se tendenca ka qenë që individët të klasifikohen vetëm sipas kategorisë së parë të statusit familjar dhe marrëdhënien me personin referues. Kjo edhe mund të sqarojë numrin e ulët të rasteve të burrit/grave pa certifikatë të kurorëzimit (sipas shpërndarjes së marrëdhënies me personin referues) dhe numrin e vogël të partnerëve që bashkëjetojnë (sipas shpërndarjes në bazë të statusit familjar), që është shumë më i ulët se sa që pritej (meqë martesat tradicionale ende konsiderohen të zakonshme).

Në të njëjtën kohë, është raportuar edhe gabimi i kundërt, d.m.th. disa regjistruar ishin të prirur që të “kalojnë” pyetjen mbi gjendjen martesore, duke arritur në një konkludim të tillë nga marrëdhënia me personin referues, e cila mund të ishte regjistruar edhe gjatë pyetjeve mbi statusin familjar.

Me qëllim të përmirësimit të saktësisë së përgjigjeve, është me rëndësi që gjatë trajnimit të sqarohet qëllimi i pyetjes mbi gjendjen martesore (d.m.th. të mblidhen informata mbi gjendjen martesore të ligjshme, dhe jo gjendjen martesore *de facto*); së dyti, për raportet ndërmjet gjendjes martesore dhe kategorive të dhëna të variableve të marrëdhënies me personin referues dhe gjendjen familjare, e cila përndryshe edhe mund të nënvlerësohet. Për më tepër, mundësia e shtimit të kategorive tjera për klasifikimin e gjendjes martesore, vetëm për qëllim të regjistrimit (p.sh. i/e martuar – nuk ka certifikatë), mund të mirret parasysh, në mënyrë që të shmanget regjistrimi i tyre si persona të martuar ligjshëm, e të cilët duhet të klasifikohen si persona që nuk janë martuar kurrë dhe kështu të mblidhen përgjigje më të sakta.

Informatat për fëmijët e lindur nga gratë (gratë e moshës 15 vjet e më shumë) janë të dobishme për shtetet që llogarisin vlerat e fertilitetit (kohëzgjatjen e tij) dhe merren përmes metodave indirekte. Përveç pyetjes mbi numrin e fëmijëve të lindur të gjallë (temë jo kryesore sipas rekomandimeve ndërkombëtare të UNECE-së), janë shtuar edhe tri pyetje tjera me qëllim të vlerësimit të vlerave të nënvlerësuara të mortalitetit të foshnjave në Regjistrat civilë. Për secilën nga këto pyetje, një numër i caktuar i përgjigjeve që mungojnë ose që nuk janë të lexueshme (ndërmjet 25 dhe 40 raste) janë regjistruar, të cilat me sa duket janë raste kur regjistruerit nuk kanë shkruar “zero-n”. Meqë, në përmasa të mëdha këto raste do të mund të shkaktonin probleme gjatë fazës së përpunimit, është me rëndësi që të qartësohet rëndësia e tyre. Kurdo që kjo paraqitet si pyetje e hapur, përgjigja e dhënë nga respondentit



duhet të shkruhet, edhe nëse është e barabartë me zero (për sa i përket shembullit të fëmijëve të lindur nga nëna e intervistuar). Mund të ketë raste kur regjistruerit i kanë konsideruar këto pyetje si tepër të ndjeshme (p.sh. lidhur me gratë e reja të pa martuara), dhe kështu nuk i kanë pyetur fare. Edhe njëherë do theksuar rëndësinë e saktësisë.

Numri i përgjithshëm i fëmijëve të lindur të gjallë nga 2,326 gra të moshës prej 15 vjeç e më shumë është 5,909. Gati një e treta (32.5%) e grave të intervistuar nuk kanë pasur fëmijë (Tabela 11), të pa martuara ishin (83.8%) ndërsa nën moshën 30 vjeç (78.0%).

Grupi tjetër më i madh sipas kategorisë është ai i grave që kanë lindur nga tre fëmijë të gjallë (15.7%), pasojnë ato me dy fëmijë (12.6%), pastaj ato me një fëmijë (8.1%), me nga 7.5% që kanë lindur pesë fëmijë të gjallë dhe 4.6% e grave që kanë lindur gjashtë fëmijë të gjallë (Tabela 11). 31.4% e 1546 grave që kanë lindur së paku një fëmijë të gjallë pas vitit 2000, me një numër prej 741 fëmijëve. Prej këtyre të fundit, 2% kishin vdekur ende pa e mbushur një vjet.

Tabela 11 – Fem. e moshës 15 vjeç sipas numrit të fëmijëve të lindur të gjallë

Numri i fëmijëve të lindur të gjallë	V.A.	%
0	756	30.0
1	188	7.4
2	293	11.6
3	365	14.5
4	223	8.8
5	174	6.9
6	106	4.2
7 e më shumë	197	7.8
Mungon pr.	25	1.0
Gjithsej	2,327	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Karakteristikat Etno-kulturore

Pyetjet për karakteristikat etno-kulturore përgjithësisht konsiderohen si politikisht të ndjeshme. Duke marrë parasysh këtë cilësim, sipas Kornizës Kushtetuese të Kosovës, respondentët mund edhe të mos përgjigjeshin. Neni përkatës i Kornizës Kushtetuese përmendëj përfunditë tekstit të pyetjeve mbi përkatësinë etnike dhe atë fetare dhe për të dyja rastet ishte paraparë përgjigja e parakoduar ku thuhej "Preferon të mos përgjigjet". Klasifikimi i përgjigjeve të parakoduara ishte bërë në bazë të shpërndarjeve të njohura të këtyre variabileve dhe të kategorisë nën "tjera" dhe ishin përfshirë për të regjistruar përgjigjet e parakoduara shtesë për pyetëtorin e Regjistrimit të përgjithshëm.

Sipas shpërndarjeve kryesore, të cilat nuk i tregojnë përgjigjet që mungojnë dhe vetëm disa raste të respondentëve të cilët nuk duan të përgjigjen, asnjëra prej këtyre pyetjeve nuk rezultoi si veçanërisht e ndjeshme gjatë punës në terren. Nga ana tjetër, një pasaktësi e caktuar nga ana e regjistruerit mund të konstatohet në bazë të disa (rasteve ekzistuese) të mungesës ose jo lexueshmërisë së përgjigjeve kur është fjala për specifikat e kërkuara për grupin etnik, gjuhën amtare dhe shtetësinë e dyfishtë.



Përkundër përqindjes së vogël të rasteve të regjistruara, që nuk klasifikoheshin sipas përgjigjeve të parakoduara ekzistuese, duhet të shtohet një pyetje e hapur, në mënyrë që përgjigjet e dhëna të jenë të bazuara sipas deklaramit të lirshëm, duke pasur parasysh natyrën e tyre të ndjeshme. Prandaj, regjistruesit duhet ta kenë të qartë rëndësinë e saktësisë gjatë parashtrimit të pyetjeve të tilla, duke përfshirë këtu edhe specifikën e kategorisë "tjera".

Siç ishte pritur dhe duke pasur parasysh karakteristikat e QR të përzgjedhura për Regjistrim testues, pothuajse shumica e respondentëve janë deklaruar shqiptarë (94.7%), boshnjakët përbënin 4.3% të numrit të përgjithshëm (të gjithë të regjistruar në Pejë) ndërsa egjiptasit, ashkanlinjtë dhe goranët, të gjithë së bashku përbënin 0.8% (të gjithë të regjistruar në Pejë). Në këtë pyetje të parashtruar nuk ka munguar asnjë përgjigje dhe asnjë prej respondentëve nuk është deklaruar se nuk dëshiron të përgjigjet në këtë pyetje.

Në bazë të deklarameve feja islame përbënte 98.6% prej numrit të përgjithshëm të respondentëve, ndërsa feja katolike ishte me vetëm 1.2% (shqiptarë etnik që jetojnë në Pejë). Edhe për këtë pyetje nuk munguan përgjigjet, kurse tre persona u deklaruan se nuk dëshirojnë të përgjigjen.

Gjuha shqipe si gjuhë amtare ishte deklaruar prej 95% të të gjithë respondentëve dhe gjuha boshnjake nga (4.3%). 29 persona kanë deklaruar gjuhë tjera përveç shqipes, serbishtes, boshnjakishtes, turqishtes dhe gjuhës rome (të parakoduara), mirëpo vetëm prej 9 sish është regjistruar një specifikë (gjuha gorane).

Lidhur me gjuhët e tjera të folura, 56.4% e respondentëve kanë deklaruar se nuk flasin ndonjë gjuhë tjetër përveç asaj amtare; 23.3% flet serbishten, 8.7% anglishten, 4.1% shqipen, 2.9% gjermanishten dhe 2.8% gjuhën boshnjake.

Lidhur me shtetësinë, gati të gjithë respondentët (99.2%) janë deklaruar kosovarë dhe vetëm dy persona janë deklaruar shtetas të Serbisë dhe 16 të Malit të Zi. Arsyeja për pyetjen e hapur mbi shtetësinë lidhet me çështjen e Statusit të Kosovës. Nëse çështja e statusit zgjidhet para organizimit të Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, atëherë shpërndarja e frekuencës së distribuimit do të sugjeronte një mënyrë më efikase të parashtrimit të pyetjes, me përgjigje të parakoduara për të gjithë shtetasit si dhe një pyetje të hapur të specifikuar për banorët e huaj.

Po ashtu, 200 respondentë të cilët deklaruan se kanë shtetësi të dyfishtë, mirëpo gjysma prej tyre janë deklaruar si kosovar, prap (vetëm në disa raste përgjigja "Kosovar" si shtetësi e dyfishtë ndryshonte nga shtetësia e parë e specifikuar). Ishte interesante se ishin vetëm 58 raste të respondentëve që kanë deklaruar se kanë shtetësi të dyfishtë, të Kosovës dhe të Malit të Zi. Nga ana tjetër, numri i madh i përgjigjeve të pa lexueshme (327) konfirmon pasaktësinë e regjistruesit lidhur me këto pyetje.

Migrimi i brendshëm dhe ndërkombëtar

95.6% e respondentëve ishin prezent në venbanimin e tyre të zakonshëm në datën që i referohet Regjistrimit testues. Studentët përbënin përqindjen më të madhe të personave që nuk ishin prezent në venbanimin e tyre të zakonshëm (31.9%), pasonin të tjerët që mungonin për shkak të punës (28.6%) dhe për arsye tjera (25.3%) (Tabela 12).



Tabela 12 – Individët që në ditën e regjistrimit mungonin nga vendbanimi i tyre i zakonshëm sipas arsyes

Arsyeja e mungesës nga vendbanimi i zakonshëm	V.A.	%
Punësimi	78	28.6
Studimet	87	31.9
Familja	29	10.6
Të tjera	69	25.3
Mungon pr.	10	3.7
Gjithsej	273	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Lidhur me migrimet e brendshme që i referohen vitit të shkuar para datës së Regjistrimit testues, vetëm 1.3% e popullatës së përgjithshme para një viti kishte jetuar në një vendbanim tjetër të zakonshëm, gjysma prej tyre në ndonjë vend tjetër në Kosovë dhe gjysma tjetër jashtë Kosovës. Lidhur me këta të fundit, vendi më i frekuentuar i vendbanimit të mëparshëm ishte Gjermania (32.5%).

Përkitazi me migruesit e brendshëm dhe ndërkombëtarë në tërësi, arsyet familjare janë shkaqet më të shpeshta të ardhjes në vendbanimin e zakonshëm aktual (37.2%), pas kësaj vie arsyeja e punësimit (23.3%) dhe studimet (9.3%).

Përqindja e ish migrantëve ndërkombëtarë ishte më e lartë nëse personat që kishin qëndruar ndonjëherë në botën e jashtme (për një periudhë të vazhdueshme prej 1 viti ose më shumë) dhe janë marrë parasysh si: 14.2% e popullatës që ka jetuar në Kosovë, e të cilët një vit para Regjistrimit testues kanë jetuar jashtë, raportohen si persona që jetojnë jashtë. Shpërndarja sipas vitit të fundit të vendbanimit në Kosovë tregon se pothuajse 2/3 popullatës në fjalë kanë ardhur në Kosovë gjatë 10 vjetëve të fundit, para Regjistrimit testues, me koncentrimet më të mëdha të ardhjeve gjatë vitit 2000 (30%). Përsëri Gjermania ishte vendi me më së shumti emigrant që kishin ardhur në Kosovë (35.5%), pasonte Zvicërra (22.2%) dhe Serbia, e deklaruar si vend i huaj i vendbanimit të mëparshëm nga 11.5% e respondentëve.

Karakteristikat arsimore

Pjesa mbi karakteristikat arsimore përmbante 5 pyetje. Për personat 6 vjeç e tutje, informacioni është marrë për vijimin e shkollimit aktual. Për të kontrolluar saktësinë e informacionit të dhënë nga respondentët (meqë sistemi arsimor për disa vite i është nënshtruar reformave të ndryshme) janë marrë të gjitha vitet e shkollimit të përfunduar. Për personat 10 vjeç e më shumë, informacioni është marrë për nivelin më të lartë të shkollimit të përfunduar, ndërsa për respondentët të cilët kanë të përfunduar së paku shkollimin e mesëm janë marrë shënime mbi llojin dhe profilet. Në fund, për personat e moshës 10 vjeç e më shumë ishte paraqitur edhe pyetja për shkrim-leximin dhe nëse nuk kanë të përfunduar asnjë nivel të shkollimit.

Lidhur me vijimin e shkollimit aktual (Tabela 13), më shumë se 2/3 e personave të moshës 6 vjeç e më shumë nuk janë duke vijuar mësimin, ndërsa 20.2% vijojnë shkollimin fillor (klasa prej 1 deri 5) dhe 7.5% vijojnë shkollimin e mesëm (klasa 6 deri 13). Vetëm 0.2% është duke vijuar shkollimin e lartë.



Tabela 13 – Individët e moshës 6 vjeç e më shumë që aktualisht vijojnë shkollimin

Mësimi i vijuar	V.A.	%
Arsimi fillor (cikli i ulët – klasa 1 deri 5)	1,154	20.2
Arsimi i mesëm (klasa 6 deri 13)	431	7.5
Shkolla e lartë (përfshirë drejtime profesionale)	11	0.2
Fakulteti, akademia	229	4.0
Studime Master	14	0.2
Doktoraturë	3	0.1
Nuk vijon shkollimin	3,856	67.4
Mungojnë pr.	20	0.3
Gjithsej	5,718	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Për sa i përket viteve të shkollimit të përfunduar, 21.8% e individëve prej moshës 6 vjeç e më shumë nuk kanë përfunduar 5 vite të shkollimit (numri i viteve i barabartë me shkollimin fillor). Kjo përqindje është e barabartë me 14.4% nëse marrim parasysh vetëm individët e moshës 10 vjeç e më shumë.

Frekuenca më e lartë (26.4%) përputhet me 12 vjet të shkollimit të përfunduar. Numri i dytë për nga madhësia është për personat që kanë përfunduar 8 vjet të shkollimit (21%).

Tabela 14 – Individët e moshës 6 vjeç e më shumë sipas viteve të shkollimit të përfunduar

Vitet e shkollimit të përfunduar	V.A.	%
0	417	7.3
1	133	2.3
2	150	2.6
3	139	2.4
4	406	7.1
5	169	3.0
6	192	3.4
7	153	2.7
8	1,200	21.0
9	176	3.1
10	150	2.6
11	155	2.7
12	1,511	26.4
13	93	1.6
14	248	4.3
15	94	1.6
16	229	4.0
17	33	0.6
18	20	0.3



19	7	0.1
20	3	0.1
21	2	0.0
22	1	0.0
Mungojnë pr.	38	0.7
Gjithsej	5,719	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Lidhur me nivelin më të lartë të shkollimit të përfunduar (Tabela 15), 25.9% e popullatës nga moshë 10 vjeç e më shumë nuk kanë certifikatë (prej të cilëve 80.7% dinë shkrim-lexim, sipas përgjigjes së dhënë në pyetjen për shkrim-leximin), ndërsa 30.5% kanë të përfunduar shkollimin fillor dhe 33.2% atë të mesëm, 5.8% kanë diplomë të universitetit dhe 0.4% janë magjistër ose doktor shkence.

Tabela 15 – Individët e moshës 10 vjeç e më shumë sipas nivelit më të lartë të shkollimit të përfunduar

Niveli më i lartë i arsimit të përfunduar	A.V.	%
Nuk kanë të kryer nivel arsimor	1,354	25.9
Arsimi fillor (cikli i ulët – klasa 1 deri 5)	1,594	30.5
Arsimi i mesëm (klasa 6 deri 13)	1,733	33.2
Shkolla e lartë (përfshirë drejtime profesionale)	201	3.8
Fakulteti, akademia	303	5.8
Studime Master	17	0.3
Doktoraturë	3	0.1
Nuk vijon shkollimin	22	0.4
Gjithsej	5,227	100.0

Regjistrimi testues 2006, Kosovë

Në fakt seksioni për arsim rezulton të jetë më problematik nga të gjithë duke shënuar paraqitjen e lartë të mospërputhjeve (98.6%). Numri më i madh mospërputhjeve lidhet me deklaratat e numrit të viteve të arsimit të përfunduar dhe nivelin më të lartë të përfunduar të shkollimit (54.8% të mospërputhjeve totale për 1,013 raste). Për disa nga këto raste supozohet një kuptimi gabueshëm i pyetjes mbi vitet e përfunduara të shkollimit. Në të vërtetë numri total i viteve të përfunduara mund të jenë raportuar (duke përfshirë edhe vitet e përsëritura) në vend të viteve të përfunduara me sukses. Megjithatë, duket se gjithë ky numër i mospërputhjeve në këto dy pyetje është për shkak të këtij gabimi. Për më tepër, shumica e problemeve u krijuan nga ndryshimet e fundit të ndërmarra në sistemin e arsimit (p.sh., shkolla fillore mund të kuptohet si në cikël i kohëzgjatjeve të ndryshme sipas moshës së përgjegjësit).

Një pjesë e mirë e mospërputhjeve janë për shkak deklarimit të numrit të viteve të shkollimit që nuk përputhen me sistemin aktual të arsimit (624 raste baras me 33.8% të gjithsej mospërputhjeve). Shtojmë se një numër i caktuar i fëmijëve nën moshën 6 vjeç (169 raste baras me to 9.1% të mospërputhjeve totale) u raportuan se aktualisht vijon shkollimin fillor.

Në fund, për pyetjen mbi shkrim-leximin u raportuan një numër i lartë i rasteve që mungojnë (3.5%) dhe një numër shumë më i lartë i përgjigjeve të dhëna nga



personat të cilët nuk është dashur të përgjigjen (gati 600 raste, kryesisht për shkak të personave të moshës 10 vjeç e më shumë kanë deklaruar se kanë përfunduar shkollimin fillor por edhe disa raste të personave të moshës nën 10 vjeç).

Në anën tjetër, nëse analizohet tabela e tërthortë (kryqe) mes vijimit aktual të shkollimit dhe shkollimit më i lartë i përfunduar për personat e moshës 10 vjeç e më shumë (të cilët janë supozuar të përgjigjen në të dy pyetjet), shumica e përgjigjeve të dhëna janë të sakta (*tabela 16*): shumica e atyre që aktualisht vijojnë shkollimin fillor deklarojnë se nuk kanë përfunduar asnjë nivel shkollor; shumica e atyre që vijon shkollimin e mesëm deklarojnë se kanë përfunduar shkollën fillore dhe kështu me radhë. Edhe pse nuk është e mundur të kuptohet se nëse kjo ndodh për shkak se ishte më e lehtë për regjistruarit (siç mund të imagjinohet) për të kontrolluar lidhjen logjike mes dy (edhe në rastin e përgjigjeve kryesisht të gabuara) ose në të kundërtën për shkak dy pyetjet e para-koduara kanë funksionuar shumë më mirë se sa pyetja e hapur.

Tabela 16 – Individët sipas vijimit aktual të shkollimit dhe nivelit më të lartë të përfunduar të shkollimit

Niveli më i lartë përfunduar i shkollimit	Vijimi aktual i shkollimit								
	Fillor	I mesëm	Shkoll. e lartë	Fakultet, akademi	Master.	Dr	Nuk vijon	Mungon	Total
Niveli shkollor i papërpunduar	647	10				1	693	2	1,353
Shk. fillore (cikli i ulët – klasa 1 deri 5)	42	398		2			1,150	2	1,594
Shk. E mesme (klasa 6 deri 13)	1	18	9	219			1,483	3	1,733
Shkolla e lartë (përfshirë dhe shk. profesionale)	1		2	4			194		201
Fakulteti, akademia				4	12		285	2	303
Magjistratura					2	1	14		17
Dr						1	2		3
Mungon	10	3					8	1	22
Totali	701	429	11	229	14	3	3,829	10	5,226

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Për të përfunduar, nëse përqindja e mospërpunuesve mes viteve të përfunduar të shkollimit dhe nivelit më të lartë të përfunduar të shkollimit mund të shpjegohet



përmes një numri ndryshimesh të ndërmarra në sistemin arsimor (jo gjithmonë të njohura nga përgjegjësit të cilët edhe kanë klasifikuar gabimisht nivelin e tyre të përfunduar arsimorë), e njëjta nuk vlen për vijimin aktual të shkollimit pas që kjo informatë duhet të jetë e njohur nga përgjegjësit pavarësisht nga çfarëdo ndryshimi i mundshëm në sistemin arsimor (natyrisht nëse përgjigjja jepet drejtpërdrejtë nga personi i duhur, por gjithmonë nuk qëndron kështu). Në përgjithësi është pse numri i mospërputhjeve së bashku me përqindjen e lartë të përgjigjeve që mungojnë, dhe posaçërisht të përgjigjeve të dhëna nga përgjegjësit të cilët nuk është dashur të përgjigjen sipas moshës së tyre ose për shkak të nivelit të tyre arsimor (dhe ky lloj i gabimeve është veçanërisht i lartë sa i përket këtyre pyetjeve), sugjerohet se përveç nevojës së përgjithshme për theksim më të mirë të mënyrave të ndryshme në pyetësorë po ashtu nevojitet një trajnim më i thellë për regjistruerit posaçërisht në sistemin arsimor në mënyrë që t'u mundësohet atyre t'i ndihmojnë përgjegjësve të japin përgjigje të sakta. Natyrisht se për t'i ndihmuar regjistruerit në terren do të ishte e dobishme që në pyetësorë brenda kllapave të shkruhet numri i viteve të nevojshme për të përfunduar nivelin e caktuar arsimor (psh. Shkolla fillore – 5 vite). Kjo do të ishte e domosdoshme për pyetjen mbi nivelin e përfunduar arsimor mund të jetë e nevojshme me shume së një kategori për nivelin e caktuar (psh. fillore – 4 vite dhe fillore – 5 vite), në mënyrë që të mundësohet regjistrimit i situatave përkatëse të studentëve të gjeneratave të ndryshme; por po ashtu për pyetjen mbi vijim aktual të shkollimit, nëse në të njëjtën kohë ekzistojnë dy sisteme të ndryshme arsimore.

Për më tepër nëse analizat më të hollësishme lidhur me të dhënat e arsimit do të sugjerojnë të mbahet pyetja për vitet e përfunduara të shkollimit, me siguri do të ishte më mirë të pyeten vetëm personat e moshës 10 vjeç e më shumë kështu që t'i shmangen fëmijët të cilët janë ende në arsimin fillor dhe kështu duke thjeshtësuar punën e regjistruerit dhe më pastaj për kontrollimin dhe përmirësimin e të dhënave. Tutje, nëse qëllimi i pyetjes është klasifikimi i personave jo vetëm sipas nivelit të përfunduar arsimor por po ashtu sipas viteve të përfunduara të shkollimit, prapë duket se të jetë mjaft e kotë të pyeten fëmijët e moshës 6 deri 10 vjeç (të cilët nuk e kanë e kanë të përfunduar asnjë nivel shkollor)). Në të kundërtën, informatat mbi vitet e përfunduara të arsimit është e interesit vetëm për ata të cilët mund të kenë përfunduar së paku shkollën fillore (duke qenë të moshës 10 vjeç e më shumë) por nuk e kanë përfunduar asnjë nivel shkollor e posaçërisht për të rriturit. Në të dy rastet (si në rastin e parashtrimit të pyetjes personave të moshës 6 vjeç e më shumë, ose në rastin e parashtrimit të pyetjes vetëm atyre të moshës 10 vjeç e më shumë) formulimi duhet të ndryshohet në "vitet e përfundimit me sukses të shkollimit" kështu që të sigurohemi se vitet e përsëritura nuk do të numërohen.

Së fundi, do të mund të merrej parasysh ndryshimi i plotë i pyetjes në "vitet e nevojshme të shkollimit (sipas sistemit arsimor) për të përfunduar nivelin e caktuar arsimor që personi deklaron se ka përfunduar"; dhe në këtë mënyrë pyetja do të lejonte kontrollin për keq-klasifikimet e mundshme të nivelit më të lartë për të përfunduar të shkollimit nga përgjegjësit. Edhe pse kjo mund të ndryshojë plotësisht qëllimin e pyetjes pasi që më nuk do të ishte e mundshme klasifikimi i personave të cilët nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimor sipas viteve të shkollimit. Megjithatë kjo e fundit mund të klasifikohet sipas

shkrim-leximit (siç edhe janë tashmë).



Karakteristikat ekonomike

Sektori i karakteristikave ekonomike ishte mjaft i gjatë dhe përfshinë 15 pyetje. Një numër i pyetjeve ishte i domosdoshëm në mënyrë që të mblidheshin informata për punësimin dhe papunësinë sipas standardeve ndërkombëtare (kryesisht sipas kriterit të ashtuquajtur një-orë për definimin e punësimit; definimi i papunësisë jo vetëm në bazë të vetë-deklaratës por po ashtu edhe sipas kërkimit të tyre aktiv për punë dhe mundësisë për të filluar punën brenda dy javëve pas regjistrimit). Disa pyetje të tjera janë vënë për t'i plotësuar me informata nevojat specifike lokale. Ndryshe nga sektori i arsimit këto pyetje nuk kanë shënuar paraqitjen e shumë mospërputhjeve e as numër të lartë të përgjigjeve të "kaluara" (përveç për pyetjen për mungesën e përkohshme nga puna, ku janë shënuar 6.8% të përgjigjeve të "pa-kaluara"). Megjithatë është shënuar përqindje e lartë e mungesës së përgjigjeve (e sidomos për disa pyetje specifike) prandaj ka nevojë që të thjeshtëzohet i tërë sektori.

Vetëm 28.2% të personave në fjalë (dmth të moshës 15 vjeç e më shumë) kanë punuar një orë apo më shumë gjatë javës para ditës së regjistrimit testues. Në fakt një kësi shkalle e ultë e punësimit fsheh një dallim të madh gjinor: përqindja e meshkujve që punojnë është gati tri herë më e lartë se sa femrat punonjëse (42.2% ndaj 14.5%).

Deri në 28% e njerëzve kanë punuar gjatë javës paraprake të regjistrimit testues dhe si shtesë 1.5% duhet të shtohen për personat të cilët përkohësisht kanë munguar nga vendi i tyre i zakonshëm i punës.

Numri mesatar i orëve të punës është baras me 38.8 (39.4 për meshkuj dhe 36.3 për femra). Shpërndarja sipas numrit të orëve të punës (për ata të cilët kanë deklaruar se kanë punuar për së paku një orë) tregon se pak më shumë se gjysma kanë punuar mes 36 dhe 42 orë, 19.0% mes 20 dhe 35 orë dhe 18.7% mes 43 dhe 69 orë. Numri mesatar i orëve të punuara në javë përgjatë 12 muajve para regjistrimit janë pak më të ultë se sa mesatarja e orëve të punës të punuara një javë para regjistrimit (38.3 ndaj 38.8).

Tabela 17 – Punësimi sipas numrit të orëve të punuara një javë para regjistrimit

Numri i orëve të punuara në javën para regjistrimiti	Mes.	%
1-9	34	2.6
10-19	49	3.7
20-35	251	19.0
36-42	675	51.1
43-69	247	18.7
70 e më shumë	46	3.5
Mungojnë	22	1.7
Gjithsej	1,324	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006



Më shumë se 2/3 të punësuarve janë të punësuar. Të vetëpunësuar pa asnjë punëtorë janë 17.4%, të pasuar me punëtorët familjarë (8.5%) dhe të vetëpunësuar pa asnjë punëtorë (6.0%).

Tabela 18– Punësimi sipas statusit të punësimit

Statusi i punësimit	Mes.	%
Punësimi	901	66.8
Vetëpunësimi me punëtorë	81	6.0
Vetëpunësimi pa punëtorë	234	17.4
Punëtorë familjarë	114	8.5
Mungon	18	1.3
Gjithsej	1,348	100,0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Në sektorin e punësimit, 57.0% veprojnë në sektorin privat. Përqindja e përgjigjeve që mungojnë për këtë pyetje në veçanti edhe mjaftë i lartë (2.2% i rasteve).

Sipas natyrës së punës përkohësisht është shumica e rasteve (82.9%), sezonale më 11.1% dhe e rastit për përqindjen tjetër të punësimit (3.9%). Madje dhe kjo pyetje shënon një përqindje të lartë të përgjigjeve që mungojnë (2.2%).

Gati tri të katërtat e punësimit kanë vend fiks të punës jashtë shtëpive (73.8%), përderisa 13.6% punojnë kryesisht në/ose nga shtëpia dhe 10.2% nuk kanë vend fiks të punës. Përqindja e rasteve që mungojnë prapë është mjaft e lartë dhe është e barabartë me 2.5%. Përqindje e njëjtë është shënuar për përgjigjet që mungojnë për profesionin në punën kryesore (nuk ka përkrahim të punës për punën që bënë), përderisa për mallrat apo shërbimet kryesore të prodhuara përgjigjet që mungojnë janë baras me 1.5%.

Sa i përket njerëzve të cilët nuk kanë bërë asnjë orë pune gjatë javës para regjistrimit e as nuk kanë munguar përkohësisht nga puna (tabela 19), përqindja me e lartë është për shkak të personave të cilët përkujdesen për shtëpi /familje (29.6%) duke u pasuar nga studentët/nxënësit (21.5%) dhe nga personat të cilët kanë deklaruar veten si të papunë dhe nuk kanë punuar kurrë më parë janë 13.9%, ndërsa marrësit e pensionit nga aktiviteti i mëparshëm i punës janë 8.5%. Së fundi personat të cilët nuk kanë mundësi të punojnë për shkak të sëmundjeve të përhershme/ aftësive të kufizuara janë 5.5%. Një numër i caktuar i përgjigjeve të "pa-kaluara" poashtu janë shënuar kryesisht për shkak të përgjigjesve nën moshën 15 vjeçare të cilët kanë deklaruar studentë/nxënës.

\



Tabela 19 – Personat e papunë sipas arsyes

o	Arsyeja e mos punës		Mes hkuj		Femra		M es.							
	o	%	o	%	o	%	o	%						
o	Papunë dhe asnjëherë më parë nuk ka punuar		o	299	o	23.5	o	33	o	6	o	1		
o	Papunë por ka punuar më parë		o	314	o	24.7	o	13	o	4	o	1		
o	Student		o	375	o	29.5	o	32	o	7	o	2		
o	Pensionist nga aktiviteti i mëparshëm punës		o	179	o	14.1	o	6	o	01	o	1.5		
o	Kujdeset për shtëpi/familje		o	2	o	0.2	o	96	o	2	o	8		
o	Nuk ka mundësi të punoj për shkak të sëmundjes së përhershme/ paaftësive		o	74	o	5.8	o	97	o	76	o	.5		
o	Pranon të ardhura nga kapitali (qira, interes, etj.)		o	4	o	0.3	o	2	o	9	o	2		
o	Tjetër (jeton nga ndihma sociale, etj.)		o	21	o	1.7	o	10	o	1	o	5		
o	Mungon		o	3	o	0.2	o	5	o	79	o	.5		
o	Total		o	1,271	o	100.0	o	1,984	o	100.0	o	3,255	o	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Gati 70% e personave që nuk punojnë (duke përfshirë personat që nuk kanë mundësi të punojnë) nuk kanë kërkuar punë gjatë javës para regjistrimit. Po ashtu vlen të ceket se përqindja e përgjigjeve që mungojnë të shënuara për këtë pyetje (5.3%) është nga më të lartat ndër të gjitha por jo edhe më e lartë se pyetja vijuese (mbi gatishmërinë të fillojë punën brenda 2 javëve) që iu ka parashtruar personave të papunë të cilët kërkonin punë një muaj para regjistrimit. Gati 80% e personave në fjalë janë përgjigjur se ata do të jenë të gatshëm të fillojnë punën brenda dy javëve



nëse ata do të gjenin punë ndërsa për gati 19.2% nuk është raportuar asnjë përgjegjje.

Së fundi, për udhëtimin ditor deri në vendin e punës apo studimit, 95.6% e popullsisë përkatëse (studentët e moshës 15 vjeç e më shumë plus punëtorët, e që se bashku janë pothuajse një e treta e gjithë popullatës) punojnë ose vijojnë shkollimin në Kosovë. Në shumë se gjysma në Pejë (52.9%), 25% në Kamenicë, 8.6% në Prishtinë. Për 1.6% e mbetur punojnë/studiojnë jashtë vendit, vendet më të shpeshta të destinimit janë Zvicra dhe Shqipëria.

Është shënuar një përqindje e lartë e përgjigjeve që mungojnë (2.9% e personave të cilët ish dashur të përgjigjen) dhe në të njëjtën kohë një numër i caktuar i përgjigjeve të pa kaluara (5% e përgjigjeve të pa kaluara). Të dy gabimet duhet shpjeguar me pozitën e “pakënaqshme” të pyetjes e cila qëndron në fund në mënyrë mjaft komplekse. Në të vërtetë, pasi që supozohet të jenë përgjigjur studentët dhe punëtorët, dhe nga fakti se disa persona mund të studiojnë ndërkohë dhe të punojnë, regjistruarit mund t’iu duket e vështirë të kontrollojnë kombinimin për moshën dhe statusin e aktivitetit të përgjigjesit.

Pothuajse dy të tretat e studentëve. Punëtorëve udhëtojnë çdo ditë (63.9%); 4.9% udhëtojnë një herë në javë dhe 4.1% më pak se një herë në javë. 27% e përgjigjeve që mungojnë të shënuara për këtë pyetje shpjegohen me faktin se në të shumtën e kohës për përgjigjesit të cilët studiojnë dhe punojnë në të njëjtën komunë dhe vendbanim me vendbanimin e zakonshëm regjistruarit e kanë parë si të panevojshme të bëjnë pyetjen duke e marrë si të sigurt se përgjigja do të jetë “çdo ditë”.

Aftësitë e kufizuara

Sa i përket aftësive të kufizuara (tabela 20), përqindja më e lartë e personave që kanë raportuar për ndonjë aftësi të kufizuar është shënuar me 8.7% të përgjigjesve që kanë raportuar *disa* vështirësi dhe 1.2% *shumë* vështirësi. Përqindja më e lartë e personave që kanë deklaruar për shumë vështirësi është shënuar për “në të ecur ose ngjitur shkallëve”, aktivitet për të cilët po ashtu nja 5% e personave kanë raportuar për *disa* vështirësi. 1.1% e përgjigjesve kanë raportuar vështirësi në të mbajturit në mend/ përqendrim dhe 0.8% në të dëgjuar.

Tabela 20 – Individët sipas vështirësive në realizimin e aktiviteteve të përditshmërisë

Aktivitetet	Aspak	Disa	Shumë	Nuk mundet hiq	Mungon	Total
Në të parë	89.9	8.7	1.2	0.2	0.0	6,370
Në të ecur ose ngjitje shkallësh	92.4	5.0	1.8	0.7	0.1	6,370
Në të dëgjuar	95.4	3.5	0.8	0.2	0.0	6,370



o Kujtesë/ 0. o 6,3
 përqendrim 95.5 o 3.0 o 1.1 3 o 0.1 70
Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Burimet e jetesës

Sa për burimet e jetesës (tabela 21), mbështetja nga personi tjetër është raportuar si burimi i parë dhe kryesorë nga më shumë se 60% e përgjegjësve, i pasuar me një dallim të madh nga puna (20.7%). Pensionet e të gjitha llojeve llogariten 5.8% nga të gjitha përgjigjet, ndihma sociale me 4.3% dhe paratë e dërguara nga jashtë me 40%. Kjo e fundit është më së shumti e raportuar si burim sekondar i jetesës me 28.4% e përgjegjësve për të cilët është shënuar burimi sekondar i jetesës (vetëm 10.7% nga përgjigjësit total) përdërisa burimet e tjera të raportuara si burim kryesorë sekondarë nga 28.8%. Mbështetje nga personi tjetër numërohet me 19.3%, duke pasuar me ndihmë sociale (9.2%), pronësi (5.8%) dhe pensione (5.2%).

Tabela 21 – Individët sipas burimeve kryesore të jetesës

Burimet e jetesës	Parë	Dytë
o Puna	o 20,7	o 3,2
o Pronësi ose investime të tjera (qira, etj.)	o 0,7	o 5,8
o Pensione të të gjitha llojeve	o 5,8	o 5,2
o Para të dërguara nga jashtë	o 4,0	o 28,4
o Ndihma dhe benifite sociale	o 4,3	o 9,2
o Mbështetje nga ndonjë person tjetër (duke përjashtuar paratë e dërguara nga jashtë)	o 61,3	o 19,3
o Burime tjera	o 2,9	o 28,8
o Mungon	o 0,4	o 0,0
o Total	o 6,370	o 683

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Banesat

Gjithsej 1,611 banesa janë regjistruar në tri komuna. Siç mund të pritej, shpërndarja sipas komunave pasqyron deri në një masë të madhe shtrirjen e një proporcioni të ngjashëm të ekonomive familjare dhe të individëve. Në Pejë u regjistruan 54.6% e popullsisë dhe 57.5% e banesave u regjistrua nga numri total i tyre (926 banesa).



Tabela 22. Banesat sipas komunave dhe vendbanimeve

Komuna	Vendbanim	Total
Kamenicë	1,165	61
	1,505	294
	1,571	51
	2,087	82
	2,245	52
<i>Gjithsej</i>		<i>540</i>
Pejë	1,687	59
	1,872	111
	1,919	499
	2,019	134
	2,376	123
<i>Gjithsej</i>		<i>926</i>
Shtërpçë	1,137	77
	1,322	68
<i>Gjithsej</i>		<i>145</i>
Total		1,611

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Pyetësori për banesa (Formulari R1) përmbante 14 pyetje; 2 pyetjet e para ishin rreth llojit të njësisë banesore dhe statusit të zënies së banesës së zakonshme duke vazhduar me 6 pyetje që u janë adresuar banesave të zakonshme (4 pyetje për karakteristikat e ndërtesës dhe 2 pyetje për sipërfaqen e banesës dhe numrin e dhomave) dhe 9 pyetje janë mbi karakteristikat e njësisë banesore të cilat i adresohen banesave të zakonshme dhe jo të zakonshme (sistemit të furnizimit me ujë, tualetit, pajisjeve të banjës, kuzhinës, llojit të ngrohjes, energjisë së shfrytëzuar për ngrohje).

Sa i përket llojit të banimit, gati çdo banesë (99.2%) ishte e zakonshme (tradicionale). Nuk është gjetur asnjë i pastrehë në QR përkatëse dhe vetëm 6 njësi banesore jo të zakonshme (ish dyqane, tende, etj) janë gjetur (nga të cilat 4 në Kamenicë).

Në pyetjen 7 të pyetësorit kur përgjigjja ka munguar, informata është shënuar lidhur me pyetjet që i janë adresuar banesës së zakonshme; kështu që ato janë supozuar të jenë banesa të zakonshme.

Tabela 23. Banesat sipas llojit të banimit

Lloji i njësisë banesore		%
Banesa të zakonshme	1,598	99.2
Njësi tjetër banimi	6	0.4
Mungon	7	0.4
Total	1,611	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006



Në anën tjetër një numër i përgjigjeve të pakaluar (dmth lidhur me banesat jo të zakonshme) janë shënuar në pyetjen 2 deri në 7 prandaj tregojnë se disa raste definimi i banesës së zakonshme nuk ishte mjetë i qartë.

Tabela 24. Banesat sipas statusit të banimit dhe komunës

Komuna	Banesa e zakonshme me një apo më shumë banorë	Banesat për shfrytëzim sezonal apo sekondarë	Banesat e lira	Mungojnë	Total
Kamenicë	423	5	110	2	540
Pejë	672		250	1	926
Shtërpcë	116		29		145
Total	1,211	5	389	3	1,611

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Në regjistrim nuk është gjetur asnjë banesë me banorë të cilët nuk përfshihen në regjistrim (personel diplomatikë, etj) dhe janë gjetur vetëm 5 banesa të shfrytëzuara për shfrytëzim sezonal apo sekondar. Për të këtë pak dhe të gjitha banesat e lira janë shënuar mos-përgjigjet për pyetjet vijuese, siç edhe do të duhej.

Tabela 25. Banesat sipas llojit të ndërtesës

Lloji i ndërtesës	%	
Banesa për banim	1,204	99.2
Shtëpi të ndara veç	952	78.4
Shtëpi gjysmë të ndara	96	7.9
Ndërtesë apartmanesh, ose bllok ndërtesash	144	11.9
Varg apo terracë shtëpish	9	0.7
Tjetër	3	0.2
Ndërtesë jo për banim	1	0.1
Mungon	9	0.7
Total	1,214	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Shumica e ndërtesave (78.4%) janë shtëpi të ndara. Ndërtesa apartmanesh janë 11.9%. Shpërndarja sipas vitit të ndërtimeve tregon një koncentrim në 40 vitet e fundit. 82.6% të ndërtesave janë ndërtuar nga viti 1971 e më vonë (posaçërisht gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe në 5 vitet e fundit). Një përqindje shumë e vogël e ndërtesave aktualisht të banuara janë ndërtuar para Luftës së Dytë Botërore (1.4%). Vlerat që mungojnë bëhet disi më relevante (14, dmth. 1.2%) që tregojnë se në disa raste informatat për vitin e ndërtimit mund të mos jetë e njohur për përgjigjësit.

Tabela 26. Banesat sipas vitit të ndërtimit të ndërtesës

Viti	%
------	---



1850-1945	18	1.4
1946-1960	43	3.5
1961-1970	137	11.3
1971-1980	267	22.0
1981-1990	200	16.5
1991-2000	240	19.8
2001-2006	295	24.3
Mungon	14	1.2
Total	1,214	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Përqindja e përgjigjeve që mungojnë rritet tek pyetja 5 (numri i kateve) ku përkundrazi vështirë mund të mendohet se informata nuk ishte e lehtë për tu marrë nga regjistruerit.

Numri maksimal i kateve është 6, përderisa në 2 QR të Shtërpcës janë gjetur ndërtesa me më së shumti me 3 kate. Mesatarisht numri i kateve është 2.2 (por 2.3 në Kamenicë, 2.1 në Pejë dhe 1.8 në Shtërpcë).

Tabela 27. Numri i kateve në ndërtesë

Numri i kateve		%
1	380	31.3
2	566	46.6
3	102	8.4
4	29	2.4
5	45	3.7
6	71	5.8
Mungon	21	1.7
Total	1,214	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Sa i përket materialit nga të cilët janë ndërtuar ndërtesat vlen të ceket se përderisa në Shtërpcë dhe në Pejë materialet më së shpeshti të shfrytëzuara janë tullat dhe gurrat, në Kamenicë kategoria modale është betoni (dhe betoni i përforcuar).

Në anën tjetër vetëm një ndërtesë është e ndërtuar nga druri; nëse këto qarqe të testimit do të ishin përfaqësues të tërë territorit të Kosovës, do të ishte korrekte të përjashtohet "druri" si përgjigje e para-koduar (kështu që shtëpitë prej druri do të përfshiheshin nën "të tjera").

Tabela 28. Materialet nga të cilat janë ndërtuar muret e jashtme të ndërtesës

Materialet e mureve të jashtme	Kamenicë	Pejë	Shtërpcë	Total	Kamenicë	Pejë	Shtërpcë	Total
	Mes.				%			
Beton dhe beton i përforcuar	193	13	3	209	45.6	1.9	2.6	17.2
Bloqe betoni	42	88	2	132	9.9	13.0	1.7	10.9
Tulla dhe gurë të tjerë	136	482	103	721	32.2	71.4	88.8	59.4
Dru	1	1		2	0.2	0.1	0.0	0.2
Njësi tjera të parafabrikua	3	34		37	0.7	5.0	0.0	3.0
Materiale të përziera	36	43	7	86	8.5	6.4	6.0	7.1
tjetër	10	10		20	2.4	1.5	0.0	1.6
Mungon	2	4	1	7	0.5	0.6	0.9	0.6
Total	423	675	116	1,214	100.0	100.0	100.0	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Nuk ka vlera që mungojnë për pyetjen për numrin e dhomave përderisa 15 nga to paraqesin gjithsej sipërfaqen e tërë njësisë banesore. sipërfaqja mesatare e (duke përfshirë banesat që mungojnë) është 90.9 m², ndërsa numri mesatar i dhomave për njësi banesore është 4.1.

Tabela 29. Dhomat e njësive banesore sipas sipërfaqes totale (m²)

Sipërfaqja	Numri i dhomave								Total
	1	2	3	4	5	6	7	8+	
0-50	11	94	67	5					177
51-75	3	70	204	96	20	6	2	1	402
76-100	1	7	80	107	71	38	8	4	316
101+		1	10	60	73	74	33	53	304
Mungon	4	2	3		2	1		3	15
Total	19	174	364	268	166	119	43	61	1214

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Më pak se 15% e njësive banesore kanë sipërfaqe të vogël (nën 50 m²).

Tabela 30. Sipërfaqja totale e njësive banesore (m²)

Sipërfaqja (m ²)	mes.	%
0-50	177	14.6
51-75	402	33.1



76-100	316	26.0
100+	304	25.0
Mungon	15	1.2
Total	1,214	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Një numër i madh i vlerave që mungojnë janë shënuar tek pyetja 8 (dhomat që shfrytëzohen për biznes ose qëllime profesionale dhe sipërfaqja totale). Për shumicën e mungesës së këtyre përgjigjeve (16.3% nga banesat totale) logjikisht mund të supozohet se regjistruerit në vend se të shkruajnë "0", thjeshtë e kanë kaluar pyetjen. Në të vërtetë numër i njëjtë (196) i vlerave që mungojnë janë shënuar edhe në pjesën e dytë të pyetjes 8 (sipërfaqja totale për biznes apo qëllime profesionale). Si edhe për shumë pyetje tjera, nevoja është më se e evidente të përkujtojmë regjistruerit dallimin mes "0" dhe përgjigjeve të zbrazëta.

Tabela 31. Dhomat e shfrytëzuara kryesisht për biznes apo qëllime profesionale

Dhoma	mes.	%
0	949	78.8
1	34	2.8
2	21	1.7
3	2	0.2
4	2	0.2
Mungon	196	16.3
Total	1,204	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Në anën tjetër vlen të përmendet se nuk ka mospërputhje mes pyetjes së mëparshme (numri i dhomave) dhe të kësaj pyetje, dmth nuk ka raste ku është shënuar numër më i madh i dhomave të shfrytëzuara për biznes se sa numri total i dhomave në njësinë banesore. Sa i përket pjesës së dytë, është vetëm një rast i mospërputhjeve mes sipërfaqes totale të njësisë banesore me sipërfaqen totale për biznes (kjo e fundit është më e madhe se sa jo totale).

Sidoqoftë vetëm 63 njësi banesore kanë raportuar se kanë dhoma të shfrytëzuara për qëllime profesionale.

Pyetja rreth pajisjeve (nga 9 deri 14) kanë një numër të vogël të vlerave që mungojnë (pyetja lidhur me tualetet nuk ka asnjë). Shumica e njësisë banesore kanë ujë të instaluar brenda njësisë banesore (83.3%), tualet me ujë brenda shtëpisë (75.1%), vaskë të fiksuar brenda shtëpisë (83.6%) dhe një kuzhinë (68.5%). Shumica e njësisë banesore ngrohen me stufë (88.9%) dhe e dru (95%).

Tabela 32. Pajisjet shtëpiake

Furnizimi me ujë	Mes.	%
Ujë i instaluar në shtëpi	1011	83.3



Ujësjet jashtë shtëpisë	12	1.0
Ujësjet jashtë ndërtesës	26	2.1
Pus	156	12.9
Pa ujësjet, pa pus	9	0.7
<i>Mungon</i>	3	0.2
Total	1214	100.0
Tualeti		
Tualet me ujë në shtëpi	914	75.1
Tualet tjetre brenda shtëpisë	10	0.8
Tualet me ujë jashtë shtëpisë	55	4.5
Tualet me ujë jashtë ndërtesës	130	10.7
Tualet tjetër jashtë shtëpisë	108	8.9
Total	1217	100.0
Pajisjet e banjës		
Të fiksuara në njësinë banesore	1017	83.6
Të pafiksuara ose jashtë shtëpisë	194	15.9
<i>Mungojnë</i>	6	0.5
Total	1217	100.0
Kuzhina		
Me kuzhinë	827	68.5
Me kthinë kuzhine	216	17.9
Pajisje për përgatitje të ushqimit në dhomë tjetër të njësisë banesore	68	5.6
Me kuzhinë orë kthinë kuzhine jashtë njësisë banesore	9	0.7
Pa kuzhinë ose kthinë kuzhine	87	7.2
<i>Mungon</i>	10	0.8
Total	1207	100.0
Lloji i ngrohjes		
Ngrohje qendrore e qytetit	7	0.6
Ngrohje qendrore në ndërtesë apo njësi banesore	40	3.3
Stufë	1081	88.9
Oxhak	50	4.1
Ngrohëse elektrike	30	2.5
Tjetër	7	0.6
Nuk ka kurrfarë ngrohje	1	0.1
<i>Mungon</i>	1	0.1
Total	1216	100.0
Lloji i energjisë së shfrytëzuar për ngrohje		
Dru	1154	95.0



Thëngjill	2	0.2
Vaj	9	0.7
Gas	5	0.4
Rrymë	44	3.6
Tjetër	1	0.1
<i>Mungon</i>	2	0.2
Total	1215	100.0

Regjistrimi testues, Kosovë 2006

Sa i përket mospërputhjeve mes variablave këtu janë vetëm disa. Shumica prej tyre janë tek pyetja për tualet dhe furnizim me ujë.

Në fakt në shumë raste më të papërshtatshme janë përgjigjet se sa gabimet e vërteta (psh. duke pasur sistemin e ujësjellësit për furnizim me ujë por kanë tualetin jashtë shtëpisë mund të jetë në fakt e pamundur kjo në teori nuk është e pamundshme).

Mospërputhje tjera të vogla (vetëm 3 raste) kanë të bëjnë me vitet shumë të hershme të ndërtimit (para vitit 1955) për materialet nga të cilat janë të ndërtuara muret e jashtme të ndërtesës (njësi parafabrikuara).

Të përmbledhim se mënyra e plotësimit të saktë është ndjekur në shumicën e pyetësorëve me përqindje të lartë të përgjigjeve që mungojnë për pyetjen 8 dhe një numër të vogël të mospërputhjeve dhe raste të kalimit.

Pyetjet për ekonomi familjare

Shumica e ekonomive të regjistruara familjare kanë raportuar se jetojnë në banesën e tyre (90.7%). 3.7% të rasteve të ekonomive familjare jetojnë në banesat e poseduara nga të afërmit dhe po ashtu paraqesin 2.9% të shtëpive me qira.

Për më shumë se gjysma e ekonomive të regjistruara familjare kanë vetëm një telefon celularë përderisa 23.8% kanë edhe linjën fikse dhe një telefon celularë dhe 10.5% kanë vetëm linjën fikse. Përqindja e ekonomive familjare që nuk kanë kurrfarë telefoni është baras me 7.3% (por dallimi mes komunave është shumë i lartë, 20.7% të ekonomive familjare pa telefon janë shënuar në 2 QR shqiptare në Shtërpcë dhe 4.5% të shënuar në Kamenica). Më shuam se tri të katërtat e ekonomive familjare nuk kanë kompjuter personal (77.5%), prapë me përqindje të lartë të mesatares në Shtërpcë (90.5%). Vetëm 57 ekonomi familjare nga të gjitha kanë qasje në internet në njësinë familjare, ku gjysma e tyre jetojnë në Pejë dhe gjysma tjetër në Kamenicë (asnjë nga ta nuk jeton në Shtërpcë).

Bujqësia

Më shumë se dy të tretat (67.8%) e ekonomive të regjistruara kanë raportuar se kanë tokë në pronësi ose në shfrytëzim. Gati të gjithë deklarojnë se kanë tokë në pronësi por 75.7% kanë më pak se 1 hektarë (dhe gati gjysma e tyre posedojnë më pak se 10 ari). Më pak se 10 ekonomi familjare nga të gjitha raportojnë se kanë tokë



apo kanë marrë tokë me qira ose shfrytëzohet nga të tjerët dhe rreth 15 prej tyre shfrytëzojnë tokën e poseduar nga të tjerët pa pagesë. Në fund me pak se 10 ekonomi familjare posedojnë tokë që iu kanë dhënë të tjerëve.

Për shfrytëzimin e tokës totale, shfrytëzimin kryesor, kanë deklaruar 90.7% e ekonomive familjare të cilët shifrën totale të tokës e kanë raportuar nën "të tjera" (siç janë oborret e shtëpive, pellgje etj.). Numri i ekonomive familjare të cilët kanë deklaruar për shfrytëzimin e pjesërisht të tokës është i lartë (873 ndaj 824) se sa numri i atyre të cilët janë përgjigjur po në pyetjen e parë të sektorit të bujqësisë (pyetja 5 – a ka ekonomia familjare tokë në pronësi apo në shfrytëzim?). Frekuenca më e lartë sipas kategorisë "të tjera" (dhe me 35.7% të rasteve totale është shënuar vetëm kategoria të tjera) e cila shpjegon se pse në disa raste përgjigja ishte "jo" në pyetjen për pronësinë e tokës ose tokës në shfrytëzim por përgjigja është shënuar në pyetjen mbi përdorimin në vazhdim. Me siguri se toka në pronësi ose në shfrytëzim është menduar për tokën e kultivar dhe vetëm më vonë regjistruesi/familjari ka kuptuar se edhe oborret e shtëpive duhet të përfshihen në sipërfaqen totale të tokës (specifikimi i tillë lidhur me pyetjen 5, filtri i parë mund të jetë i dobishëm për të shmangur gabimet e tilla).

Livadhe kanë raportuar 45.7% të ekonomive familjare (duke përfshirë 77 raste të cilat kanë në shfrytëzim livadhe së paku një hektar të sipërfaqes së tokës totale), ara dhe djerrina me 33.6% (76 raste me së paku nga 1 hektarë), 146 ekonomi familjare me pyje (32 kanë së paku nga 1 hektarë) dhe fusha të pa kultivuara kanë 120 ekonomi familjare (40 prej të cilave kanë më së paku nga 1 hektarë). Për fund vetëm disa ekonomi familjare kanë raportuar shfrytëzimin e tokës si pemishte (68, prej tyre 2 kanë nga 1 hektarë); serra (38, prej tyre 3 kanë së paku nga 1 hektarë); kullosa (38, prej tyre 4 me 1 hektarë). Vreshtat janë raportuar vetëm në 5 raste (prej të cilave 1 për më së paku 1 hektarë).

Lista 2

Vetëm 65 persona (28 meshkuj dhe 37 femra) janë regjistruar në Listën 2, përkohësisht të pranishëm në ditën e regjistrimit, nga të cilët 4 në Kamenicë, 36 në Pejë dhe 25 në Shtërpce. 20 prej tyre ishin fëmijë ndërsa shumica e rasteve të tjera ishin mes moshës 20 dhe 30 vjeçare. 43 prej tyre ishin banorë me vendbanim të përhershëm në Kosovë përdërisa 19 të tjerët jetojnë jashtë Kosovës. Në 52 rastet që përkohësisht ishin të pranishëm në banesa në ditën e regjistrimit ishte për shkak të arsyeve familjare.

Formularët plotësues

S1 (tabela plotësuese e cila liston anëtarët e ekonomive familjare që jetojnë jashtë Kosovës) u sigurua në mënyrë që të regjistrojë anëtarët e tjerë të ekonomive familjare (dmth. personat të cilët i takonin ekonomive familjare e të cilët më parë ishin banorë me vendbanim të zakonshëm në banesë) e të cilët kanë emigruar jashtë Kosovës. Ky formularë u shtua me kërkesë nga bashkëpunëtorët lokal (vendor) me qëllim që të përmirësohet regjistrimi dhe të thjeshtësohet puna e regjistruësve. Këto ishin argumentet të cilat janë marrë parasysh: a) definicioni i vendbanimit të zakonshëm i përdorur ë regjistrimet e mëhershme (kur kombëtarët jetojnë/punojnë jashtë vendit dhe llogariten si pjesë e popullsisë së vendit me vendbanim të



zakonshëm); b) refuzimi i supozuar për të marrë pjesë në regjistrim nga familjarët anëtarët e të cilëve janë duke jetuar jashtë vendit (të cilët në mënyrë aktive i mbështesin ë afërmit e tyre në Kosovë duke iu dërguar të holla dhe në fakt në shumë raste konsiderohen si anëtarë të familjes). Në bazë të kësaj dhe në mënyrë që të mos ndikojë në cilësinë e regjistrimit zyrtar u morr vendimi për të shtuar këtë formularë të ndarë. Edhe pse qëllimi kryesor shite rritja e cilësisë, mbledhja e disa të dhënave (gjinia, moshë, viti i largimit nga Kosova, arsyeja e largimit nga Kosova) u shtuan për një numërim të thjeshtë.

Në fakt, shfrytëzimi i tabelës plotësuese u ka lejuar regjistruesve të regjistrojnë çdo anëtarë të ekonomive familjare (në kuptim të gjerë) përderisa në fakt duke i regjistruar si banorë me vendbanim të zakonshëm vetëm anëtarët të cilët në realitet i plotësojnë kriteret ndërkombëtare (që jetojnë në banesë për më së paku 12 muaj ose synon që të jetojë së paku 12 muaj). Në anën tjetër informatat e mbledhura përmes S1 nuk mund të konsiderohet si gjithëpërfshirëse e as të sakta nëse është menduar të plotësojë nevojat informative për emigrantët të cilët jetojnë jashtë vendit. Në të vërtetë rreziku për të mos regjistruar ose regjistrimit të dyfishtë të popullsisë në fjalë është shumë i lartë dhe mezi i realizueshëm. E njëjta është si për saktësinë e të dhënave të mbledhura nga fakti se të dhënat rrallë do të jepeshin drejtpërdrejtë nga vetë peronat.

Gjithsej numri i anëtarëve të ekonomive familjare të cilët aktualisht jetojnë jashtë vendit ishte 1,058. Më shumë se gjysma e tyre janë shënuar në Pejë (56.7%), gati një e treta në Kamenicë dhe pjesa e mbetur 11.0% në Shtërpcë. Sipas numrit të formularëve S1 të plotësuar, vetëm 274 ekonomi familjare (4.3% e totalit) kanë raportuar se kanë anëtarë të familjes që jetojnë jashtë vendit.

57.9% anëtarëve të ekonomive familjare të cilët jetojnë jashtë vendit janë meshkuj dhe gati të gjithë janë nën moshën 65 (26.8% nën moshën 15 vjeçare). Viti më frekuent i emigrimit është 1999 (9.6%), më shumë se gjysma (55.9%) kanë lënë Kosovën mes viteve 1990 dhe 1999 dhe 23.5% të cilët u larguan nga viti 2000 e tutje. Përgjigjet që mungojnë janë baras me 7.4%. 42.2% kanë lënë Kosovën për arsye familjare dhe 31.0% për punësim. Po ashtu edhe për këtë pyetje përqindja e përgjegjeve që mungojnë është mjaft e lartë (5.4%).

2.1 Analiza e gabimeve sipas llojit

Formulari i vendbanimit (r1)

Përgjigjet e mangëta

Lloji më i shpeshtë i gjithsej 32 gabimeve është aktivizuar nga 192 pyetësorë (prej numrit të përgjithshëm të llojeve të gabimeve). Ky i përfshinte dy pyetje rreth numrit të dhomave që kryesisht shfrytëzohen për biznes apo arsye profesionale dhe hapësirës përkatëse. Siç u përmend më herët, në shumë raste nuk është regjistruar asnjë përgjigje për këto pyetje; me siguri për shkak se në vend që regjistruesi të vendosë "0" ai/ajo vetëm i ka kapërcyer këto pyetje. Sa ju përket pyetjeve tjera të formularit individual, këto rezultate kërkojnë theks më të madh në udhëzimet e regjistruesve për rëndësinë moslënies së përgjigjeve të zbrazëta kurdo që një përgjigje është kërkuar qartë nga pyetësi.



Lloji tjetër më i shpeshtë i gabimeve (13 pyetësorë) ka të bëjë me pyetjen 5 (numrin e kateve) kështu duke konfirmuar se pyetjet e hapura, në krahasim me ato të parakoduara, janë më vështirë që të përgjigjen.

Përgjigjet e pakapërcyera

Vetëm katër lloje të ndryshme të gabimeve janë evidentuar, siç shihet në tabelë. Numri i përgjithshëm i gabimeve është 21, dhe 14 prej tyre janë përgjigje në pyetjet prej 3 deri në 8, të plotësuara për njësitet e amvisërisë të klasifikuara si vendbanime jokonvencionale (për çfarë arsye është dashur të kapërcehen).

Mospërputhshmëritë

Mospërputhshmëritë në mes të ndryshoreve "Furnizimi me Ujë" dhe "Tualeti" rrisin numrin në gjithsej 240 gabime (në numrin e përgjithshëm prej 328 gabimeve). Edhe pse disa nga këto mospërputhshmëri mund të jenë në fakt përgjigje të pazakonta (si "uji me gypa përbrenda njësitit të amvisërisë" dhe "Tualet me presion të ujit jashtë ndërtesës", kombinim i cili u gjet në 96 raste). Mospërputhshmëritë tjera kanë të bëjnë me llojin e nxehjes dhe llojin e energjisë së përdorur për nxehje.

Formulari i amvisërisë (r2)

Përgjigjet e mangëta

Gjithsej 76 lloje të gabimeve janë evidentuar por vetëm 7 sosh kanë qenë të aktivizuar prej më tepër se 1 pyetësori. Lloji kryesor i gabimeve është ai që ka të bëjë me numrin rendor të individit të familjes që ju takojnë (27 raste). Në fakt, një detyrë e ndryshme i është caktuar regjistruarëve sa i përket rikrijimit të bërthamës familjare. Në mënyrë që të mund të plotësohen shtyllat 5 – numri rendor i bërthamës së cilës i takon personi – dhe shtyllës 6 – statusi familjar i personit përbrenda bërthamës – e Listës 1, regjistruarët është dashur ta zbulojnë numrin e bërthamave familjare në një amvisëri dhe, pas përcaktimit të duhur të kodit për secilin prej tyre dhe vlerësimit se në cilën bërthamë bën pjesë secili prej anëtarëve të amvisërisë, është dashur të që secilit anëtarë të amvisërisë t'i përcaktohet "bërthama familjare" e tij/saj dhe kodi i "statusit në bërthamë" të tij/saj. Duke pasur parasysh vështirësinë e kësaj detyre, numri i pyetësorëve që kanë aktivizuar këtë lloj gabimi mund të konsiderohet që është relativisht i ulët. Sidoqoftë, ky flet për domosdoshmërinë e zhvillimit të trajnimit (po ashtu me anë të shembujve dhe studimeve të rasteve) lidhur me konceptin e bërthamës familjare dhe dallimit në mes të ndryshoreve "marrëdhënia me personin e përmendur" dhe "statusit familjar". Njëmend, numri i gabimeve të evidentuara do të kishte qenë shumë më i lartë pa mbikëqyrjen intensive të koordinatorëve që ishte e nevojshme në terren.

Lloji tjetër më i shpeshtë i gabimeve është aktivizuar nga 11 pyetësorë, ku asnjë përgjigje nuk është dhënë në flet-pyetjen mbi bagëtinë/kafshët që posedon një amvisëri. Sa ju përket shumë pyetjeve tjera për formularin e vendbanimit dhe atij individual, përgjigja që mungon me siguri ishte "jo" por regjistruarët nuk e kanë shënuar në vendin e përcaktuar. Dallimi në mes të "jo" dhe 0, përgjigjes së zbrazët



dhe pasojave negative të përgjigjeve të zbrazëta për fazën proceduese duhet t'ju bëhen të qarta regjistruësve, duke ju nënvizuar rëndësinë e moslënies së përgjigjeve të zbrazëta sa herë që një përgjigje kërkohet qartas nga pyetëtori.

Përgjigjet e pakapërcyera

Sa ju përket përgjigjeve të pakapërcyera, lloji i vetëm i gabimeve që është aktivizuar nga numri përkatës i pyetësorëve (34 pyetësorë në gjithsej 8 lloje gabimesh) është ai që ka të bëjë me pjesën e bujqësisë në pyetësin e amvisërisë. Në këto raste, përgjigjet janë dhënë për të gjitha pyetjet lidhur me shfrytëzimin dhe hapësirën e tokës në pronësi/shfrytëzim nga amvisëria, duke mos e anashkaluar përgjigjen në filtër-pyetjen (*A ka amvisëria ndonjë tokë në pronësi apo në shfrytëzim?*) që do të nënkuptonte mungesë të përgjigjeve në pyetjet vijuese.

Një shpjegim i mundur, në bazë të shpeshtësisë së lartë të raportuar nga kategoria "tjetër" (në 35.7% të gjithsej rasteve ishte shfrytëzimi i vetëm i tokës i raportuar) mund të gjendet në keqkuptimin e mundshëm të filtër-pyetjes ku "toka në pronësi apo në shfrytëzim" ka mundur të ketë për qëllim tokën e kultivuar; vetëm në momentin e dytë regjistruësi/kryeshtëpiaku ka mundur të kuptojë se edhe oborret e shtëpive është dashur të përfshihen gjatë vlerësimit të tokës së përgjithshme, por regjistruësit nuk e kanë korrigjuar përgjigjen e parë të dhënë. Një detajizim i tillë lidhur me filtër-pyetjen (*oborri i përfshirë* apo diçka të ngjashme) ka mundur të jetë i dobishëm në shmangien e një gabimi të tillë. Në aspekt më të gjerë, duhet të theksohet përsëri rëndësia e trajnimit të regjistruësve mbi dallimin në mes të "jo" apo 0 dhe përgjigjes së zbrazët duke nënvizuar rëndësinë e posaçme të moslënies së përgjigjeve të zbrazëta sa herë që kjo të kërkohet qartas nga pyetëtori.

Mospërputhshmëritë

Vetëm disa raste (12) të mospërputhshmërive janë evidentuar në mes të gjinisë së individëve dhe statusit familjar.

Formularët individual (r3)

Përgjigjet e mangëta

Sa ju përket mungesës së llojeve të gabimeve, në këtu do të analizojmë vetëm ato lloje (24) që janë aktivizuar nga 20 apo më tepër pyetësorë (në gjithsej 198 lloje të aktivizuara të gabimeve). Lloji më i shpeshtë, i aktivizuar nga 899 pyetësorë, ka të bëjë vetëm me pyetjen mbi shkrim-lexim (P25) që ka vlejtur vetëm për ata të cilët nuk kanë fare certifikatë të shkollës. Pra, ka qenë plotësisht e drejtë që të intervistuarit të cilët e kanë përfunduar shkollën fillore, të mos përgjigjen në pyetjen P25. Edhe pse një *filtr* eksplisit ka munguar në pyetësorë dhe këto përgjigje që mungonin ishin formalisht të gabuara dhe kësaj janë llogaritur si gabime nga sistemi.

Lloji tjetër më i shpeshtë (i aktivizuar nga 318 pyetësorë) ka të bëjë me pyetjen 41 për udhëtimin në mes të shtëpisë dhe vendit të punës/studimit. Siç shihet nga analiza e distribucioneve, shumica e përgjigjeve që mungojnë për këtë pyetje janë për shkak të faktit se të intervistuarit studiojnë apo punojnë në të njëjtën komunë dhe



vendbanim si ai ku ata jetojnë. Në fakt, kjo pyetje është bërë me qëllim t'ju parashtrohet vetëm atyre që studiojnë/punojnë në komune tjetër nga ajo ku këta jetojnë, siç është paraparë edhe në doracak; kështu shumë regjistruar nuk e kanë plotësuar rutinë që korrespondon me përgjigjen "për çdo ditë". Sidoqoftë, pasi që ky *filtr* nuk ishte shkruar në pyetësorë, këto raste janë llogaritur nga sistemi si mungesa të përgjigjeve. Edhe këtu këta pyetësorë mund të konsiderohen thelbësisht të saktë edhe nëse formalisht janë të gabuar. E njëjta vlen edhe për 127 pyetësorët që kanë aktivizuar llojin e tretë më të shpeshtë të gabimeve që ka të bëjë me kombinimin e këtyre dy gabimeve (që mungon për pyetjet 25 dhe 41).

Lloji tjetër i shpeshtë është aktivizuar nga pyetësorët 97 dhe ka të bëjë me mungesën e përgjigjes për pyetjen mbi statusin martesor (P5). Mungesa e këtyre përgjigjeve kryesisht ka të bëjë me fëmijët nën moshën 10 vjeçare që sugjerojnë për nevojën e këshillimit të regjistruarëve që kjo pyetje duhet të përgjigjet nga secili i intervistuar, duke përfshirë fëmijët.

Edhe një lloj tjetër i shpeshtë i gabimeve i aktivizuar në 97 raste ka të bëjë me kapërcimin e pyetjeve 38 dhe 39. Këto pyetje, të parashtruara njerëzve pa punë, janë të nevojshme për t'i identifikuar të papunësuarit sipas definicionit ndërkombëtar (personat të cilët nuk kanë kryer asnjë orë pune gjatë javës para regjistrimit e as që nuk kanë një punë ku mungonin përkohësisht **dhe** të cilët në mënyrë aktive kërkojnë punë **dhe** të cilët janë në gjendje t'ia fillojnë punën brenda 2 javëve pas regjistrimit). Një shpjegim i mundshëm për mungesën e këtyre përgjigjeve mund të gjendet në shenjat e kapërcimit të cilat janë dedikuar vetëm për një nga kategoritë për respektivisht pyetjen 37 dhe pyetjen 38, por ndoshta janë keqinterpretuar nga regjistruarët të cilët kanë menduar se këto vlejën për të gjitha kategoritë.

Një tjetër lloj i gabimit (44 raste) është ai i aktivizuar nga mos-shënimi i vendlindjes. Gabimi tjetër i shpeshtë (36) ka të bëjë me kombinim të pyetjeve tashmë të cekura 25, 38 dhe 39.

Lloji tjetër vijues i gabimeve (i aktivizuar në 28 raste) ka të bëjë me pyetjet mbi vendin e punës/studimit dhe shpeshësisë së udhëtimit prej shtëpisë në vendin e punës/studimit (P40 dhe P41). Këto pyetje është dashur të përgjigjen edhe nga studentët edhe nga punëtorët e disa prej regjistruarëve ju është dukur vështirë ta verifikojnë kombinimin e moshës dhe statusin e aktivitetit të të intervistuarëve, kështu duke dështuar ta paraqesin pyetjen në rastet më pak evidente. Së fundi, në 20 raste ka munguar vetëm një përgjigje lidhur me vitet e shkollimit të përfunduar (P22).

Në përmbledhje, pyetjet që kanë gjeneruar llojet më të shpeshta të gabimeve janë (përpos pyetjeve 25 dhe 41):

- pyetjet mbi statusin martesor (P5)
- pyetjet mbi kërkimin aktiv të punës dhe mbi aftësinë e të filluarit të punës (P38 dhe P39)
- pyetjet mbi vendin e punës/studimit (P40)
- pyetjet mbi vitet e shkollimit të përfunduar (P22).

Përgjigjet e pakapërcyera



Sa ju përket gabimeve të llojit të *pakapërcyer*, 6 lloje të ndryshme janë aktivizuar nga më shumë se 10 pyetësorët (në gjithsej 70 lloje). Rasti më i shpeshtë (81 pyetësorë) është prapë ai i aktivizuar nga pyetja mbi shkrim-lexim. Këtë herë përgjigja është dhënë nga të intervistuarit që nuk është dashur të përgjigjen. Lloji i dytë më i shpeshtë (24 pyetësorë) është ai i aktivizuar nga pyetja 27, që i është parashtruar vetëm personave që nuk kanë punuar një javë para ditës së regjistrimit. Në vend të kësaj, në një numër rastesh, kjo pyetje i është parashtruar edhe personave të cilët kanë qenë duke punuar, dhe kësajsoj janë përgjigjur që nuk kanë munguar përkohësisht nga puna e tyre. Lloji i tretë (prapë 24 pyetësorë) është ai i aktivizuar nga definimi i shtetit të vendit të punës/studimit i dhënë nga të intervistuarit të cilët punojnë/studiojnë në Kosovë (ku përpos komunës dhe vendbanimit është shkruar edhe Kosova). Lloji i katërt (19 pyetësorë) ka të bëjë me konkretizimin e llojit dhe profilit të paraqitur nga të intervistuarit të cilët, sipas përgjigjeve në pyetjet mbi nivelin më të lartë të shkollimit të përfunduar, nuk është dashur të përgjigjen. Lloji i pestë (11 pyetësorë) është aktivizuar nga të intervistuarit nën moshën 10 vjeçare për të cilët janë dhënë përgjigje për pyetjen 23 (niveli më i lartë i shkollimit të përfunduar) dhe pyetjen 25 (shkrim-leximi). Lloji i fundit (10 pyetësorët) prapë ishte aktivizuar nga të intervistuarit të cilët, sipas moshës (nën 15 vjeçare), nuk është dashur të përgjigjen në pyetjen mbi vendin e punës/studimit dhe mbi shpeshtësinë e udhëtimit prej shtëpisë në vendin e punës/studimit.

Numri i përgjithshëm i pyetësorëve që kanë aktivizuar llojin e pakapërcyer të gabimeve është 311 për një numër relativisht të ulët i gabimeve të pakapërcyera (705). Llojet më problematike janë me sa vijon:

- pyetjet mbi arsimim – niveli më i lartë i shkollimit të përfunduar, përcaktimi i llojit dhe profilit, shkrim-leximi (P23 dhe P25);
- pyetjet mbi mungesën e përkohshme nga puna (P27);
- pyetjet mbi vendin e punës/studimit dhe shpeshtësinë e udhëtimit prej shtëpisë deri në vendin e punës/studimit (P40 deri P41).

Mospërputhshmëritë

Sa ju përket mospërputhshmërive, pothuajse të gjithat (98.6%) kanë të bëjnë me pjesën e arsimimit dhe më saktësisht konfliktit në mes të viteve të deklaruara të shkollimit të përfunduar dhe dy pyetjeve tjera kryesore të pjesës së arsimimit (88.6% prej mospërputhshmërive të përgjithshme).

Numri më i madh i mospërputhshmërive ka të bëjë me numrin e deklaruar të viteve të shkollimit të përfunduar dhe nivelit më të lartë të përfunduar të shkollimit (54.8% prej numrit të përgjithshëm të mospërputhshmërive prej 1,013 rasteve). Për disa nga këto raste, keqkuptimi i pyetjes mbi vitet e përfunduara të shkollimit ka mundur të supozohet. Njëmend, numri i përgjithshëm i viteve të përfunduara ka mundur të raportohet (duke përfshirë numrin e viteve të përsëritura) në vend të viteve të përfunduara me sukses. Sidoqoftë, nuk është e pamundur që të gjitha mospërputhshmëritë e gjeneruara nga këto dy pyetje janë për shkak të këtij lloji të gabimit. Më e mundshme është që shumica e problemeve janë krijuar nga ndryshimi që së voni ka pësuar sistemi shkollor (p.sh., shkolla fillore mund të kuptohet si cikël i kohëzgjatjeve të ndryshme sipas moshës të së intervistuarit). Pothuajse një e treta e



mospërputhshmërive të përgjithshme (601) ka të bëjë me të intervistuarit të cilët kanë deklaruar se nuk kanë certifikatë shkollimi por një numër vitesh të përfunduara të shkollimit që do të mundësonte së paku përfundimin e shkollimit fillor dhe në një numër simbolik rastesh edhe shkollimin e mesëm. Një mospërputhshmëri tjetër e shpeshtë (292 raste) është ajo në mes të shkollës fillore si shkollimit më të lartë të përfunduar dhe numrit të deklaruar të viteve të shkollimit për të cilat do të supozohej se shkolla e mesme është përfunduar përpos në rastin e disa viteve të përsëritura. Pasi që hipoteza e fundit duket pothuajse e pamundur (si shembull, nëse mospërputhshmëritë e dyta të përmendura merren si të arsyeshme, do të duhej të supozonim se rreth 200 persona prej më shumë se 5,000 e kanë përsëritur jo vetëm një por disa klasë), këto mospërputhshmëri me siguri mund t'i atribuohen klasifikimit të gabuar të nivelit të përfunduar të shkollimit të një personi.

Një numër tjetër i mospërputhshmërive kanë të bëjnë me numrin e deklaruar të shkollimit të përfunduar në mospërputhshmëri me shkollimin e vijuar aktualisht (624 raste të barabarta me 33.8% prej mospërputhshmërive të përgjithshme). Kryesisht, këto mospërputhshmëri kanë të bëjnë me të intervistuar që aktualisht janë duke e vijuar shkollën fillore dhe të cilët deklarojnë numër më të madh të viteve të përfunduara se sa ato që duhen për përfundimin e shkollës fillore. Edhe një mospërputhshmëri tjetër (77 raste) është aktivizuar nga numri i deklaruar i viteve të përfunduara që është më i vogël se sa ai i nevojshëm për ta vijuar universitetin.

Për më tepër, janë evidentuar një numër rastesh ku numri i deklaruar i viteve të përfunduara do të nënkuptonte se i intervistuari ka filluar shkollimin para moshës 6 vjeçare (169 raste).

2.2 Analiza e gabimeve sipas numrit dhe komunës/vendbanimit

Siç u përmend më herët, në këtë paragraf paraqitet vlerësimi global i gabimeve të gjetura në një formular regjistruar. Gabimet tashmë të analizuar sipas llojit në paragrafin e mëparshëm (mungesa e përgjigjeve, përgjigjet e pakapërcyera, mospërputhshmëritë) janë shqyrtuar së bashku në mënyrë që të fitohet një pasqyrë globale e kualitetit të kompilimit për formularët e ndryshëm.

Duhet të theksohet se në analizën vijuese gabimet që janë shkaktuar si rezultat i mungesës së filterëve në pyetësorë apo udhëzimeve jo të qarta (shih rastet e përmendura më lartë lidhur me arsimimin – sidomos pyetjen 25 – dhe vendin e punës/studimit – pyetja 41) nuk do të merren parasysh. Me të vërtetë, pyetjes 23 i ka munguar filtri eksplicit në përputhje me kategorinë 2 (shkolla fillore) dhe kjo mungesë ka gjeneruar shumë gabime në pyetjen 25. Shtuar kësaj, pyetjen 41, problemi qëndronte tek udhëzimet kontradiktore në mes të asaj që është shkruar në pyetësor dhe asaj të shkruar në doracak. Edhe një herë, kjo shumëkuptueshmëri ka gjeneruar shumë gabime. Për këtë arsye, në analizën vijuese, gabimet që rezultojnë nga pyetja 25 dhe pyetja 41 e formularit R3 nuk do të merren parasysh.

2.2.1 Gabimet në pyetësorin e vendbanimit

Tabela 2.1a tregon numrin e formularëve R1 të prekur nga së paku 1 gabim nga numri i gabimeve (prej 1 deri në 5 *apo më shumë gabime*) dhe komunës dhe ZR.

		Nr i pyetësorëve me gabime					%						
KOM	ZR	NUMRI I PËRGJITHS. I VENDBANIM	1	2	3	4	5 e më shumë	1	2	3	4	5 e më shumë	GJITH
10	19	61		54	1				88.5	1.6			90.2
10	65	18											0.0
10	70	92	7	1				7.6	1.1				8.7
10	73	106	10	7	1		2	9.4	6.6	0.9		1.9	18.9
10	74	78	3					3.8					3.8
10	92	51	2	3				3.9	5.9				9.8
10	141	82		35	3				42.7	3.7			46.3
10	155	52	3	4				5.8	7.7				13.5
17	62	59		42	1				71.2	1.7			72.9
17	85	111	2	11				1.8	9.9				11.7
17	126	88	7	3				8.0	3.4				11.4
17	139	168	7	22	5			4.2	13.1	3.0			20.2
17	173	125	2	3		1		1.6	2.4		0.8		4.8
17	194	118	6	12				5.1	10.2				15.3
17	202	134	4	1				3.0	0.7				3.7
17	231	123	3	8	1			2.4	6.5	0.8			9.8
23	13	77	4	2			1	5.2	2.6			1.3	9.1
23	16	68	6	2				8.8	2.9				11.8
		1611	66	210	12	1	3	4.1	13.0	0.7	0.1	0.2	18.1

Rezultati i parë i rëndësishëm është se 8.1% i numrit të përgjithshëm i formularëve të vendbanimit është prekur nga së paku një gabim. Kjo përqindje mund të konsiderohet si mjaft e lartë pasi që R1 ka qenë relativisht lehtë për t'u plotësuar dhe nuk ka përfshirë shumë drejtime të ndryshme.

Siç u cek edhe më lartë, kjo përqindje e lartë kryesisht është pasojë e dy arsyeve të ndryshme: mungesa e vlerës (me siguri 0) në pyetjen 5 ("dhomat e përdorura kryesisht për arsye biznesi") dhe sasia e madhe e mospërputhshmërive në mes të përgjigjeve në pyetjen 9 ("sistemi i furnizimit me ujë") dhe 10 ("tualetit") që në disa raste shfaqin kombinime më të pazakonshme se sa të pamundura.

Edhe një shifër që vlen të përmendet është përqindja e pyetësorëve me 1 apo 2 gabime që përbëjnë 17.0% e numrit të përgjithshëm të formularëve të vendbanimit.

Edhe një aspekt tjetër që duhet të vlerësohet ka të bëjë me variabilitetin e lartë të përqindjeve të pyetësorëve të prekur nga gabimet nga zonat e regjistrimit, me fjalë tjera dallimi në kualitetin e kompilimit nga regjistruerit e vetëm. Njëmend janë 3 ZR (19, 62, 141) me një sasi të lartë të pyetësorëve me gabime (më shumë se 40%); 4 ZR me përqindje mjaft të pranueshme të pyetësorëve të prekur nga gabimet (në mes 0% dhe 5%); 11 ZR ku përqindja e pyetësorëve me gabime është në mes 8% dhe 20%.

Këto rezultate janë paraqitur në tabelën 2.1b:

KOM	ZR	NUMRI I PËRGJITHSHËM I VENDBANIMEVE	Pyetësorët me gabime	% e pyetësorëve me gabime në numrin e përgjithshëm të pyetësorëve
10	19	61	55	90.16
17	62	59	43	72.88
10	141	82	38	46.34
17	139	168	34	20.24
10	73	106	20	18.87
17	194	118	18	15.25
10	155	52	7	13.46
23	16	68	8	11.76
17	85	111	13	11.71
17	126	88	10	11.36
10	92	51	5	9.80
17	231	123	12	9.76
23	13	77	7	9.09
10	70	92	8	8.70
17	173	125	6	4.80
10	74	78	3	3.85
17	202	134	5	3.73
10	65	18	0	0.00
		1,611	292	18.13

Këto dallime të mëdha në punën e regjistruësve duhet të merren parasysh për zhvillimin e trajnimit (dhe ndoshta edhe të efijencës së doracakëve).

2.2.2 Gabimet në formularët e amvisërive

Tabela 2.2a tregon numrin e formularëve R2 të prekur nga së paku 1 gabim nga numri i gabimeve (prej 1 deri në 5 apo më shumë gabime) dhe komuna dhe ZR:

		Nr i pyetësorëve me Gabime					%						
KOM	ZR	NUMRI I PËRGJITHSHËM I AMVISËRIVE	1	2	3	4	5 e më shumë	1	2	3	4	5 e më shumë	GJITH
10	19	55	7					12.7					12.7
10	65	13					11					84.6	84.6
10	70	63											0.0
10	73	79	8	6	4	1	19	10.1	7.6	5.1	1.3	24.1	48.1
10	74	57				1					1.8		1.8
10	92	42	5	1			3	11.9	2.4			7.1	21.4
10	141	71	1				2	1.4				2.8	4.2
10	155	44	2					4.5					4.5
17	62	44	2					4.5					4.5
17	85	86	2					2.3					2.3
17	126	61	5		1			8.2		1.6			9.8
17	139	135	8	1			7	5.9	0.7			5.2	11.9
17	173	76											0.0
17	194	98	4					4.1					4.1
17	202	97	13				1	13.4				1.0	14.4
17	231	79											0.0
23	13	57	2					3.5					3.5
23	16	59	3	1			1	5.1	1.7			1.7	8.5
		1,216	62	9	5	2	44	5.1	0.7	0.4	0.2	3.6	10.0

Sa i përket pyetësorit të amvisërisë, situata duket globalisht shumë më e mirë se sa në pyetësorin e vendbanimit (pavarësisht se e kundërta ka mundur të pritet në bazë të shkallëve të ndryshme të vështirësisë së 2 formularëve): përqindja e pyetësorëve me gabime është rreth 10.0% e totalit të formularëve R2.

Edhe pse gjithashtu duhet të theksohet se përqindja e dytë më e madhe e pyetësorëve me gabime është ajo me 5 apo më shumë sosh (3.6%). Siç u përmend më lartë, problemet ishin shkaktuar kryesisht nga keqinterpretimi i mundshëm i pyetjes 5 (pyetja e parë e pjesës së bujqësisë: "a ka amvisëria tokë?"). Me të vërtetë, shumë shpesh regjistruerit e shkruanin përgjigjen "jo" por pastaj regjistronin vlera tjera si përgjigje për pyetjet 6, 7 apo 8. Gjithashtu duhet të përmendet një përqindje e lartë e përgjigjeve të mangëta në pyetjen 5.

Edhe këtu ka dallime në mes të regjistruerëve edhe pse më të vogla se sa ato që kanë të bëjnë me rezultatet e pyetësorit të vendbanimit. Njëmend, ekzistojnë vetëm 2 ZR (65, 73) me më shumë se 40% të pyetësorëve me gabime, 6 ZR me përqindje në mes të 8% dhe 22% dhe 10 ZR e mbetura me përqindje pyetësorësh me gabime më pak se 5%.

Këto rezultate janë paraqitur në tabelën 2.2b:

MUN	ZR	NUMRI I PËRGJITHSHËM I AMVISËRIVE	Pyetësorët me gabime	% Pyetësorëve me gabime
10	65	13	11	84.6
10	73	79	38	48.1
10	92	42	9	21.4
17	202	97	14	14.4
10	19	55	7	12.7
17	139	135	16	11.9
17	126	61	6	9.8
23	16	59	5	8.5
10	155	44	2	4.5
17	62	44	2	4.5
10	141	71	3	4.2
17	194	98	4	4.1
23	13	57	2	3.5
17	85	86	2	2.3
10	74	57	1	1.8
10	70	63	0	0.0
17	173	76	0	0.0
17	231	79	0	0.0
		1,216	122	10.0

2.2.3 Gabimet në pyetësorët individualë

Tabela 2.3a tregon numrin e formularëve R3 të prekur nga së paku 1 gabime nga numri i gabimeve (prej 1 deri në 5 apo më shumë gabime) dhe komuna dhe ZR:

KOM	ZR	NR I PËRGJ. I PERSONAVE	Nr i pyetësorëve me gabime					%					TOT
			1	2	3	4	5 e më shumë	1	2	3	4	5 e më shumë	
10	19	329	14	17	4		5	4.3	5.2	1.2		1.5	12.2
10	65	54	1	2		4	1	1.9	3.7		7.4	1.9	14.8
10	70	264	21	6	6			8.0	2.3	2.3			12.5
10	73	348	44	4	6		7	12.6	1.1	1.7		2.0	17.5
10	74	271	8	1				3.0	0.4				3.3
10	92	236	13	4	3	2	3	5.5	1.7	1.3	0.8	1.3	10.6
10	141	407	17	7	1		3	4.2	1.7	0.2		0.7	6.9
10	155	267	16	10	6	1	2	6.0	3.7	2.2	0.4	0.7	13.1
17	62	296	16	10	4		2	5.4	3.4	1.4		0.7	10.8
17	85	497	19	11	2			3.8	2.2	0.4			6.4
17	126	227	7	15	3	1	2	3.1	6.6	1.3	0.4	0.9	12.3
17	139	688	78	32	11	2	15	11.3	4.7	1.6	0.3	2.2	20.1
17	173	368	11	7	2		3	3.0	1.9	0.5		0.8	6.3
17	194	459	47	39	8	1	15	10.2	8.5	1.7	0.2	3.3	24.0
17	202	576	84	67	16	2	23	14.6	11.6	2.8	0.3	4.0	33.3



17	231	368	51	20	12	7	7	13.9	5.4	3.3	1.9	1.9	26.4
23	13	361	32	9	2	2	4	8.9	2.5	0.6	0.6	1.1	13.6
23	16	354	30	7	13	2	14	8.5	2.0	3.7	0.6	4.0	18.6
		6,370	509	268	99	24	106	8.0	4.2	1.6	0.4	1.7	15.8

15.8% i numrit të përgjithshëm të pyetësorëve individualë ka së paku një gabim (shih tabelën 1.1a). Prapëseparapë, kjo është përqindje mjaft e lartë.

Siç është analizuar në hollësi në paragrafët e mëparshme, shumica e këtyre gabimeve kanë të bëjnë me pjesën mbi arsimimin ku ka shumë mospërputhshmëri në mes të përgjigjeve të dhëna për pyetjet 21, 22 dhe 23. Duket njëmend se ndryshimet e bëra së voni në sistemin arsimor të Kosovës krijojnë shumë huti edhe për regjistruarit edhe për të intervistuarit.

Përqindja e shquar e vlerave të mangëta për pyetjen 38 ("A keni kërkuar punë në katër javët e fundit?") dhe 39 ("A jeni gati t'ia filloni punës?") rezultojnë edhe në një burim tjetër të rëndësishëm gabimesh.

E njëjta vlen edhe për pyetjen 5 ("Cili është aktualisht statusi ligjor martesor?") ku regjistruarit kryesisht nuk janë përgjigjur për fëmijë të moshës nën 10 vjeçare.

Pyetjet 6, 7 dhe 8 ("Fëmijët e lindur gjallë") po ashtu ka numër të konsiderueshëm të vlerave të mangëta. Edhe këtu regjistruarit nuk janë përgjigjur ndoshta sepse këto ju janë dukur pyetje të ndjeshme për vajzat e reja të pamartuara mes moshës 15 dhe 20 vjeçare.

Së fundi, janë evidentuar edhe një numër i konsiderueshëm i rasteve të përgjigjeve të pakapërcyera për pyetjen 27 ("Edhe nëse nuk keni punuar javën e kaluar, a jeni të punësuar?") dhe për pyetjen 38 ("A keni kërkuar punë në katër javët e fundit?"). Kjo duket se e thekson problemin e keqkuptimit të drejtimit të duhur të pjesës së ekonomisë.

Edhe për formularët R3 dallimet mund të vërehen sipas regjistruarit. Me të vërtetë janë 3 ZR (202, 231, 194) me numër të madh pyetësorësh me gabime (mes 20% dhe 34%) dhe 14 me përqindje mes 5% dhe 20%. Së fundi, ZR-të e mbetura (74) kanë përqindje të pranueshme pyetësorësh me gabime (3.3%).

Përfundimisht, nëse krahasohet me R1 dhe R2 – kualitet më i dobët i kompilitimit është evidentuar mesatarisht për formularët R3. Njëmend, 14 ZR janë në klasën mesme (mes 5% dhe 20% e pyetësorëve me gabime) dhe vetëm 1 ZR ka më pak se 5% të pyetësorëve me gabime. Kjo me arsye mund t'i atribuohet një strukturë shumë më komplekse dhe, natyrisht, numrit më të madh të pyetjeve në R3.

Këto rezultate janë paraqitur në tabelën 2.3b:

KOM	ZR	NUMRI I PËRGJ. I PERSONAVE	Pyetësorët me gabime	% e pyetësorëve me gabime
17	202	576	192	33.3
17	231	368	97	26.4



17	194	459	110	24.0
17	139	688	138	20.1
23	16	354	66	18.6
10	73	348	61	17.5
10	65	54	8	14.8
23	13	361	49	13.6
10	155	267	35	13.1
10	70	264	33	12.5
17	126	227	28	12.3
10	19	329	40	12.2
17	62	296	32	10.8
10	92	236	25	10.6
10	141	407	28	6.9
17	85	497	32	6.4
17	173	368	23	6.3
10	74	271	9	3.3
		6370	1006	15.8

2.3 Propozime për përmirësime të mundshme të formularëve të regjistrimit

Formulari i amvisërisë dhe i vendbanimit

Sa i përket formularit të amvisërisë, dy vështirësi kryesore që janë hasur nga regjistruerit janë vërejtur edhe si gabime në pyetësorë. E para ka të bëjë me dallimin në mes të konceptit të marrëdhënies së personit në pyetje dhe statusit familjar (që nuk kuptohet gjithmonë aq lehtë nga regjistruerit) dhe, në aspekt më të përgjithshëm, detyra e caktuar për regjistruerit që ta rikrijimin bërthamën familjare në terren. Me qëllim që të lehtësohet puna e regjistruerëve dhe kësaj edhe të rritet saktësia e mbledhjes të së dhënave, më shumë kohë duhet t'i kushtohet trajnimit rreth shpjegimit të këtyre dy koncepteve sidomos me anë të shembujve dhe përfshirjes së regjistruerëve në simulimin e intervistave nëpër amvisëritë e mundshme ekzistuese.

Problemi tjetër i rëndësishëm ka buruar prej keqkuptimit të filtër-pyetjes rreth "tokës në pronësi apo në shfrytëzim" që me siguri ka pasur për qëllim tokën e kultivuar dhe kësaj ka çuar deri te shumë pyetje të pakapërcyera. Në këtë rast duhet të qartësohet edhe formulimi i pyetjes e edhe udhëzimet për regjistruerit.

Së fundi, e ky është një problem i përgjithshëm sa i përket jo vetëm amvisërisë por edhe për formularët e vendbanimit dhe individual, dallimi në mes "jo" apo 0 dhe përgjigjes së zbrazët duhet t'ju sqarohet mirë regjistruerëve, duke theksuar rëndësinë e posaçme të moslënies së përgjigjeve të zbrazëta kurdo që një përgjigje kërkohet qartas nga pyetësi. Kjo ishte në fakt problemi kryesor lidhur me pyetësin e vendbanimit ku është evidentuar një përqindje e lartë e përgjigjeve të mangëta për disa pyetje të hapura, ku regjistruerit kanë lënë hapësirën e zbrazët në vend se (me siguri) të shkruajnë vlerën e zeros.



Formulari individual

Siç shihet nga analiza e llojeve të ndryshme të gabimeve dhe nga analiza e distribucioneve⁴, fusha e vetme problematike e formularit individual është pjesa e arsimimit. Edhe pse është e nevojshme një analizë më e hollësishme e të dhënave mbi arsimimin (në mënyrë që të vlerësohet, përmes analizës së gërshetimit të mbledhjeve tabelore në mes të moshës dhe secilës pyetje përkatëse, cili prej tyre më së miri i përshtatet distribucionit të moshës të së intervistuarve këssoj duke qenë më e mundur të garantohet mbledhja e të dhënave të sakta), disa konkluzione të përgjithshme mund të formulohen edhe tash.

Shumica e problemeve lidhur me pyetjet mbi arsimimin me siguri janë për shkak të ndryshimeve të bëra së voni në sistemin arsimor që, duke shkaktuar klasifikim të gabuar të nivelit të shkollimit të përfunduar nga personi përkatës, rezultuan në të gjitha mospërputhshmëritë në mes të pyetjes mbi vitet e përfunduara të shkollimit dhe pyetjes mbi nivelin më të lartë të shkollimit të përfunduar. Shpjegimi i njëjtë nuk mund të ofrohet aq lehtë për mospërputhshmëritë në mes të pyetjes mbi vitet e përfunduara të shkollimit dhe pyetjes mbi vijimin e tanishëm të shkollimit pasi që në fakt ishte dashur të jetë shumë më lehtë të definohet saktë niveli i shkollimit që aktualisht vijohet. Sidoqoftë, sa ju përket të dy gabimeve, problemi mund të shfaqet me përgjigjet e autorizuara; vërtetë, nëse përgjigjet nuk janë dhënë drejtpërdrejtë nga vet të intervistuarit, kjo rrit mundësinë e pasaktësisë. Një pasaktësi e caktuar me siguri është pasojë e interpretimit të gabuar të pyetjes mbi vitet e përfunduara të shkollimit përgjigja për të cilën ka mundur të jepet numri i përgjithshëm i viteve të përfunduara (përfshirë edhe vitet e përsëritura) në vend të viteve të përfunduara me sukses.

Si sugjerim i përgjithshëm, të gjitha këto probleme së pari do të kërkonin korrespondencë më të qartë mbi vet pyetësin në mes të nivelin të tanishëm të vijimit të shkollimit apo shkollimit më të lartë të përfunduar dhe viteve që aktualisht korrespondojnë me nivelin e caktuar apo të përfundohet me sukses. Në mënyrë që t'ju ndihmohet regjistruar në terren, do të mund të ishte e dobishme që në kllapa të shkruhet në pyetësorë numri i viteve që duhen për përfundimin e një niveli të caktuar të shkollimit (p.sh. shkolla fillore – 5 vite). Kjo do të ishte e domosdoshme posaçërisht për pyetjen mbi nivelin e përfunduar të shkollimit, ku më shumë se një kategori do të ishte e nevojshme për një nivel të caktuar (p.sh. fillorja – 4 vite - dhe fillorja – 5 vite), në mënyrë që të mundësohet evidentimi i situatave që përputhen me gjeneratat e ndryshme të studentëve. Edhe pse do të ishte e nevojshme që kjo të bëhet edhe për pyetjen mbi shkollimin aktualisht të vijuar nëse do të verifikohet se sisteme të ndryshme arsimore ekzistojnë në të njëjtën kohë. Sidoqoftë, kjo duhet të bëhet në kombinim me një trajnim më të hollësishëm të regjistruarve lidhur me strukturën specifike arsimore në mënyrë që t'ju mundësojë atyre që të jenë në gjendje t'ju ndihmojnë të intervistuarve për të dhënë përgjigje të sakta.

Në anën tjetër, disa nga problemet lidhur me përgjigjet e mangëta dhe të pakapërcyera në pyetjen mbi shkrim-lexim (pyetja tjetër më problematike) janë ngritur nga përgatitja e gabueshme e pyetësorit. Sidoqoftë si vërejtje e përgjithshme, më shumë theks duhet të kushtohet gjatë trajnimit mbi drejtimet e ndryshme të pyetësorëve sipas moshës apo përgjigjeve të dhëna për pyetjet e mëparshme.

⁴ Shih pjesën 1 të këtij aneksi.



Duke arritur të pyetja, nëse mbahet pyetja mbi vitet e shkollimit të përfunduar, së pari formulimi duhet të ndryshohet në "vitet e përfundimit të shkollimit me sukses", në mënyrë që të jetë e qartë se vitet e përsëritura nuk do të llogariten. Së dyti, me siguri do të ishte më mirë që kjo pyetje t'ju bëhet personave prej moshës 10 vjeçare e tutje në mënyrë që të shmanget situata ku pyetja do t'i parashtrohej shumicës së fëmijëve të cilët ende janë duke e vijuar shkollën fillore, kështu duke thjeshtësuar edhe detyrën e regjistruarit si dhe kontrollimin dhe revidimin e mëvonshëm të të dhënave. Në të vërtetë, qëllimi kryesor i pyetjes është të klasifikohen personat jo vetëm në bazë të nivelit të shkollimit të përfunduar por edhe në bazë të viteve të shkollimit të përfunduar, duke qenë një gjë e tillë kështu e dobishme posaçërisht për ata të cilët kanë mundur ta përfundojnë së paku shkollën fillore po nuk kanë përfunduar asnjë nivel të shkollimit (personat e moshës 10 vjeçare e më shumë dhe mbi të gjitha të rriturit).

Në të kundërtën, nëse arsyeja për mbajtjen e pyetjes mbi vitet e shkollimit të përfunduar është të mblidhen "kontroll" informacione për të verifikuar kualitetin e informacioneve përmes pyetjeve tjera, mund të shqyrtohet mundësia e ndryshimit të pyetjes në "vitet e shkollimit të duhura (sipas sistemit arsimor) për përfundimin e nivelit më të lartë të shkollimit" (*raportuar nga të intervistuarit*). Në këtë mënyrë, pyetja do të mundësonte verifikimin e klasifikimeve të mundshme të gabuara mbi nivelin më të lartë të shkollimit të përfunduar nga të intervistuarit. Edhe pse nëse pyetja ndryshohet kështu nuk do të jetë më e mundur që të klasifikohen personat të cilët nuk kanë përfunduar ndonjë nivel shkollimi përmes viteve të shkollimit të përfunduar. Këto të fundit do të duhej të klasifikohen përmes shkrim-leximit (ashtu siç është).

Fusha tjetër problematike (edhe pse shumë më pak problematike se sa ajo për arsimim) është ajo e udhëtimit ditor për në studime/punë, që i është adresuar personave të moshës 15 vjeçare e tutje mbi atë se kush studiojnë dhe/ose punojnë, të cilët janë pyetur edhe për komunën dhe vendbanimin (apo shtetin e huaj) të studimit/punës dhe për shpeshësinë e udhëtimit prej shtëpisë në vendin e studimit/punës.

Gabimet lidhur me të parën prej dy pyetjeve kryesore të këtij seksioni me siguri mund t'ju atribuohen kombinimeve të filtrëve që kanë çuar deri aty pasi që është varur nga moshja dhe statusi i aktivitetit dhe pasi që i është adresuar edhe studentëve edhe punëtorëve. Disa regjistruar mund ta kenë pasur të vështirë ta verifikojnë kombinimin e moshës dhe statusit të aktivitetit të intervistuarve. Edhe këtu shfaqet nevoja për theks më të madh për trajnim mbi drejtimet e ndryshme të pyetësorit.

Sa për pyetësorë, ka pasur gabime lidhur me pyetjen e dytë prej dy pyetjeve (P41), ku shumica e gabimeve të përgjigjeve të mangëta/pakapërcyera ishin për shkak të disenjës së gabuar të pyetësorit, më saktësisht udhëzimeve kontradiktore në mes të pyetësorit dhe doracakut. Në këtë të fundit me të vërtetë thuhej se pyetja ju adresohet vetëm atyre që studiojnë/punojnë në komunë të ndryshme nga ajo e vendbanimit të përhershëm përderisa në pyetësorë thuhej se kjo vllente për të gjithë studentët/punëtorët. Shumë regjistruar kanë mundur t'i referohen doracakut por gabimet me të drejtë janë llogaritur nga sistemi në bazë të drejtimit të pyetësorit.

Sa ju përket disa pyetjeve të mbetura që kanë buruar një numër të konsiderueshëm gabimesh, është evidentuar një përqindje e lartë e përgjigjeve të mangëta lidhur me



statusin martesor. E njëjta vlen edhe për pyetjen për numrin e fëmijëve të lindur të gjallë dhe atyre të mëvonshëm, ku në një numër rastesh regjistruerit me siguri kanë harruar të shkruajnë 0 (por po ashtu është mundur të mos plotësohet pyetja pasi që këtë e kanë konsideruar si çështje të ndjeshme për gratë e pamartuara apo vajzat e reja); kjo sugjeron nevojën e theksimit të regjistruerit se drejtimit e pyetësorëve duhet të respektohen me përpikëri, drejtpërdrejt duke i adresuar të gjitha pyetjet të gjithë të intervistuarve dhe pa ja qëlluar vetë përgjigjes edhe kur kjo ndoshta duket e panevojshme (p.sh. në rastin e fëmijëve edhe pse ata mund të konsiderohen të pamartuar).

Pyetjet tjera ku është evidentuar përqindje e konsiderueshme gabimesh janë pyetjet e seksionit të ekonomisë, pjesa dërrmuese e pyetësorit. Në këtë rast duhet të nënvizohet nevoja për të punuar në këtë të fundit, edhe në formulimin e disa pyetjeve të vështira e edhe në thjeshtësimin e përgjithshëm me anë të zvogëlimit të numrit të pyetjeve, së bashku me kujdesin më të madh që duhet t'i kushtohet drejtimit të pyetësorëve gjatë trajnimit.

2. Mbulesa dhe krahasueshmëria ndërmjet formularëve dhe pyetësorëve shtesë

Duke marrur parasysh që momentalisht nuk ka të dhëna të besueshme në dispozicion për ekonominë familjare dhe individët, analizat e vetme të mbulesës që kanë qenë të mundshme të bëhen kanë pasur të bëjnë me krahasimin e të dhënave të grumbulluara përmes pilot pyetësorëve të regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave (formularët R1, R2, R3) me të dhënat e marrura nga formularët shtesë (BL1 dhe RS1).

Rëndësia e kësaj analize rrjedh gjithashtu nga fakti që, pasi që formularët shtesë janë dizajnuar posaçërisht me qëllim që të lehtësojnë shpërndarjen e menjëhershme të të dhënave preliminare (RS3 dhe RS4), është e rëndësishme së veçantë që të verifikohet saktësia e të dhënave që mund të prodhojë këta formular.

Përfundimisht, gjithashtu është marrur parasysh dizajni dhe efikasiteti i një kompleti shtesë të formularëve për raportim dhe monitorim të aktiviteteve të punës në terren.

3.1 Mbulesa e ndërtesave: krahasimi i BL dhe RS1 me R1

Në tabelën 3.1a të dhënat nga formularët shtesë BL1 dhe RS1 krahasohen me ato që vijnë nga pyetësorët R1, duke pasur për qëllim analizimin e mbulesës së ndërtesave.

Formulari BL ka qenë një listë e parakoduar e ndërtesave në nivel të QR-së siç ka rrjedhur nga baza e të dhënave e GIS regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave e përtërirë në 2004, e përdorur nga numëruesit që të listojnë zonat e tyre të caktuara, ndërtesë e re dhe ndërtesë që nuk ekziston më apo në gjendje të rrënim, dhe të klasifikon të gjitha ndërtesat.

Ndërtesat sipas QR (BL, RS1, R1)

Komuna	Kodi i QR	Ndërtesa për banim			Ndërtesa jo për banim
		BL	RS1	R1	BL
10R	19	60	61	61	71
10R	65	15	16	16	8
10U	70	5	7	7	49
10U	73	84	77	77	34
10U	74	70	70	70	33
10R	92	49	49	49	40
10R	141	81	80	81	72
10R	155	53	53	52	55
17R	62	58	58	58	32
17R	85	108	107	107	29
17U	126	7	7	7	0
17U	139	150	152	152	13
17U	173	69	70	69	21
17U	194	105	105	105	19
17R	202	132	133	133	52
17R	231	117	116	116	54
23R	13	75	74	74	51
23R	16	53	61	61	47
Gjithsejtë		1,291	1,296	1,295	680

Të dhënat tregojnë një dallim të vogël ndërmjet BL, RS1 dhe R1. Kjo ka ndodhur, sigurisht sepse në disa ndërtesa, të klasifikuara si ndërtesa jo të banimit gjatë aktivitetit të para-numërimit në terren janë regjistruar si ekonomi familjare gjatë numërimit.

Numri i ndërtesave jo të banimit të regjistruara gjithashtu ka qenë mjaft i lartë në të gjitha komunitat.

3.2 Mbulesa e banimit: krahasimi i RS1 me R1, R2 dhe R3

Me qëllim të analizimit të mbulesës së banimit, tabela 3.2a tregon krahasimin ndërmjet rezultateve që vijnë nga RS1 dhe ato që vijnë nga pyetësorët R1.

Vendbanimet sipas QR (RS1, R1)

Komuna	Kodi i QR	Numri total i vendbanimeve		Numri i vendbanimeve të pabanuara (të lira)	
		R1	RS1	R1	RS1
10R	19	61	61	5	6
10R	65	18	19	5	6
10U	70	92	92	28	29
10U	73	106	106	25	27
10U	74	78	78	21	22
10R	92	51	51	9	9
10R	141	82	81	9	10
10R	155	52	53	8	9
17R	62	59	59	15	15
17R	85	111	111	25	25
17U	126	88	87	27	27
17U	139	168	168	33	35
17U	173	125	125	49	50
17U	194	118	118	20	20
17R	202	134	134	37	37
17R	231	123	123	44	43
23R	13	77	77	20	21
23R	16	68	68	9	9
Gjithsejtë		1,611	1,611	389	400



Nga tabela 3.2a është lehtë të shihet që numri total i vendbanimeve që vijnë nga RS1 dhe R1 është thjesht e njëjtë. Vetëm në një QR (65) ky numër është ndryshe (1 vendbanim më shumë në RS1).

Gjithashtu ka pasur dallime të regjistruara ndërmjet R1 dhe RS1 në numrin e vendbanimeve të lira, por kjo duket të jetë e atributshme për ndonjë gabim të numëruesit në raportimin e të dhënave nga R1 në RS1.

Në tabelën 3.2b rezultatet që vijnë nga formularët shtesë RS1 janë të krahasuara me atë që vijnë nga pyetësorët R2 dhe R3.

Komuna	Kodi i QR	Numri i regjistruar i ekonomive familjare		Numri i regjistruar i personave		Numri i regjistruar i femrave		Numri i regjistruar i meshkujve	
		RS1	R2	RS1	R3	RS1	R3	RS1	R3
10R	19	55	55	328	329	154	156	174	173
10R	65	13	13	54	54	25	25	29	29
10U	70	63	63	264	264	140	140	124	124
10U	73	79	79	348	348	169	168	179	180
10U	74	56	57	266	271	124	126	142	145
10R	92	42	42	236	236	123	123	113	113
10R	141	71	71	407	407	187	185	220	222
10R	155	44	44	267	267	135	135	132	132
17R	62	44	44	296	296	154	154	142	142
17R	85	86	86	497	497	245	245	252	252
17U	126	60	61	227	227	132	131	95	96
17U	139	133	135	672	688	353	361	319	327
17U	173	75	76	362	368	180	183	182	185
17U	194	98	98	460	459	229	228	231	231
17R	202	97	97	576	576	291	291	285	285
17R	231	80	79	374	368	197	194	177	174
23R	13	56	57	352	361	167	170	185	191
23R	16	59	59	354	354	173	173	181	181
Total		1,211	1,216	6,340	6,370	3,178	3,188	3,162	3,182



Këtu, të njëjtat dallime janë gjetur në numrin e evidentuar të ekonomive shtëpiake dhe personave. Në të vërtetë, duke parë cifrat gjithsej, është lehtë për të parë që 5 ekonomi shtëpiake më shumë janë evidentuar në R2 dhe gjithsej 30 persona më shumë janë evidentuar në R3.

Analiza më të thella janë kryer për të provuar për të kuptuar se cilat janë arsyet e këtyre dallimeve. Në të vërtetë, Sistemi i Pranimit të të Dhënave mundëson për të përputhur për secilën banesë informatat që vijnë prej RS1 dhe R1, R2 dhe R3; prandaj është lehtë për të identifikuar cila banesë është evidentuar në R1, R2, R3 mirëpo jo në RS1, si dhe e kundërta.

Tabela 3.2c tregon banesa të ndara që janë evidentuar në R1, R2, R3 mirëpo jo në RS1.

Vendbanimet e regjistruara në R1/R2/R3 por jo në RS1

Komuna	Kodi i QR	Kodi i ndërtesës	Kodi i hyrjes	Kodi i katit	Kodi i vendbanimit	Kodi i ekonomisë familjare	Numri i personave	Numri i meshkujve	Numri i femrave
10	73	10	2	1	2	1	2	0	2
10	73	56	1	2	1	1	4	2	2
10	74	4	1	1	1	1	5	3	2
10	74	72	2	1	1	1	6	5	1
10	74	88	1	1	2	1	2	1	1
10	92	84	1	1	1	1	4	2	2
10	92	87	1	1	2	1	6	1	5
17	85	69	1	1	2	1	5	3	2
17	126	2	2	1	2	1	2	1	1
17	139	100	1	1	1	1	10	3	7
17	139	104	1	2	1	1	5	4	1
17	139	113	1	1	1	1	9	6	3
17	173	1	1	1	1	1	6	3	3
17	173	27	1	2	3	1	1	1	0
17	173	52	2	2	1	1	5	4	1
17	173	79	1	1	1	1	5	3	2
23	13	13	1	1	1	1	9	5	4
23	16	6	2	1	2	1	7	4	3
23	16	64	1	1	2	1	5	2	3

Rastet e gjetura në R1/R2/R3 por jo në RS1

Tabela 3.2d tregon vendbanimet individuale të regjistruara në RS1 por jo në R1, R2, R3.

Vendbanimet e regjistruara në RS1 por jo në R1/R2/R3

Komuna	Kodi i QR	Kodi i ndërtesës	Kodi i hyrjes	Kodi i katit	Kodi i vendbanimit	Kodi i ekonomisë familjare	Numri i personave	Numri i meshkujve	Numri i femrave
10	73	10	2	1	(2) 1	1	2	0	2
10	73	56	1	(2) 1	1	1	4	2	2
10	74	72	2	(1) 2	1	1	6	5	1
10	74	88	1	1	(2) 1	1	2	1	1
10	92	84	1	1	(1) 2	1	4	2	2
10	92	87	(1) 2	1	(2) 1	1	6	1	5
17	85	69	(1) 2	1	(2) 1	1	5	3	2
17	139	104	1	(2) 1	1	1	5	4	1
17	173	27	1	(2) 1	(3) 2	1	1	1	0
17	173	52	2	(2) 1	1	1	5	4	1
17	173	79	1	(1) 2	1	1	5	3	2
17	231	13	2	2	1	1	5	3	2
23	16	6	(2)	1	2	1	7	4	3



			1							
23	16	64	1	1	(2)	(1)		5	2	3

	Rastet në RS1 por jo në R1/R2/R3
(...)	Kodi i saktë nga R1/R2

Nga analizat paralele të tabelës 3.2c dhe 3.2d del se janë tri lloje të dallimeve ndërmjet pyetësorëve kryesor dhe RS1:

- (a) banesa në R1/R2/R3 mirëpo jo në RS1 (6 raste me ngjyrë të verdh)
- (b) banesat në RS1 mirëpo jo në R1/R2/R3 (1 rast me ngjyrë të verdhë)
- (c) banesa si në R1/R2/R3 dhe RS1 mirëpo me disa germa të shkruara gabimisht në kodet e id-së (13 raste).

Në tabelën 3.2d kodet në kllapa (ngjyra e kuqe) janë ato që janë identifikuar si kodet e shkruara me shkronja gabim. Është interesant që të ceket se nuk janë bërë gabimet në id-të e komunave, lagjeve apo ndërtesave dhe shumica e tyre janë në kodet e hyrjes, dyshemesë dhe banesës; kjo gjithashtu do të mund të nënkuptonte që kodet e hyrjes, dyshemesë dhe banesës janë tejte të ndërlikuara.

Sidoqoftë është me rëndësi për të cekur që ky grup i gabimeve nuk ka ndikuar në rezultatet preliminare, mirëpo do të mund të krijonte problemet në identifikimin e njësive gjatë futjes së të dhënave.

Duke shikuar tabelën 3.2c, janë gjetur 6 raste në të cilat banesa është evidentuar në R1/R2/R3, por jo në RS1. kontrollimi gjithashtu i RS1-ve origjinal ka qenë e qartë që disa regjistruer, posaçërisht në Pejë (EA-të 126, 139 dhe 173) kanë harruar për të plotësuar formular të RS1 për ata pyetësor. Në këtë situatë të dytë, duhet të nënvizohet që ky lloj gabimi ka ndikuar në rezultatet preliminare të Pilot Regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare dhe banesave me zvogëlim prej 41 personave (0.64% të tërë popullatës së evidentuar).

Në tabelën 3.2d, është gjetur 1 rast në RS1 por jo në R1/R2/R3 (një ndërtesë, një banesë, një ekonomi shtëpiake, 5 persona). Është kontrolluar gjithashtu me BL-të origjinale dhe është zbuluar që kjo ndërtesë ekziston në bazën e të dhënave të GIS-së, duke qenë e shënuar si ndërtesë banimi: ky pyetësor me siguri është humbur. Edhe nëse numri i evidentuar i pyetësorit të humbur gjatë Pilot Regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare ka qenë vetëm një, duhet të theksohet që ky lloj gabimi mund të ndikoj në mënyrë të rrezikshme rezultatet përfundimtare të Regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare; me qëllim që të shmangen kesi lloj gabimesh, duhet të përmirësohet kontrollimi i materialeve që kthehen nga puna në terren.

